


Tek po pritëshin aktivitetet për të shënuar 90-vjetorin e lindjes së tij, është ndarë nga jeta Profesori, vetëm pak muaj pa e kurorëzuar vitin e 90-të të lindjes. Profesor Rexhep Qosja (Vuthaj, 25 qershor 1936 – 23 prill 2026).

Rexhep Qosja – një epokë e mendimit shqiptar

Nga Begzad Baliu



Rexhep Qosja: një bisedë ende e pambaruar

Nga Feride Papeleka

SHËNIME MBI LIBRAT

Pse Ben Blushi është sot shkrimtari më i lexuar shqiptar

Nga Agim Vinca

(fq. 11)

Krijimtaria e Daut Dautit

Letërsia e kujtimeve dhe narrativa e përvojave

Nga Emin Azemi

(fq. 10)

Dhimitër Pojanaku, një poet bodlerian

Nga Bujar Plloshtani

(fq. 12)

Pashk Përvathi, poeti i peizazhit, virtuozi i ngjyrave të thella dhe dritës së vezullim të natyrës

Nga Albert Vataj

(fq. 8)

FJALA E MOHUAR ose fjalë për fjalën time

Nga Visar Zhiti

(fq. 14)

Kulturë gjuhe

KEQPËRDORIME FJALËSH

Nga Jani Thomai

(fq. 13)



Poezia “Një liqen dhe një fushë” e Natasha Lakos

Në vijën e brishtë të rërës

Nga Timo Mërkuri

Poezia “Një liqen dhe një fushë” e Natasha Lako është nga ato krijime poetike që nuk tregojnë një histori në kuptimin e zakonshëm të rrëfimit, por krijojnë një gjendje të thellë përjetimi. Lexuesi hyn në atë si në një peizazh të heshtur, ku natyra duket sikur merr frymë me ritmin e shpirtit njerëzor.

(fq. 6)

Ku na udhëheq Dantja

Nga Claudia Roth Pierpont

Përktheu nga anglishtja Kadia Dedja

“La Biennale di Venezia” Artisti italo-shqiptar

ALFRED MIRASHI MILOT prezantohet me veprën “Mjaft me çelësa”

Nga Ylli Drishti

(fq. 4)



BIBLIOTEKË

Daniel Leuwers

(fq. 16)

Dashuria heshtje

Përktheu nga origjinali: Besnik Mustafaj

Shqiptar Oseku

(fq. 17)

Radhët

Xhevair Lleshi

(fq. 18)

Qesëndisjet

Përparim Hysi

(fq. 19)

Krejt, rastësisht...

Arben Meksi

(fq. 19)

Karikatura e së shtunës

Anatomia e Intuitës: Leximi si një aftësi e të menduarit kritik

Nga Artan Nati

(fq. 15)

Octavio Paz bisedon me Josif Brodskin

(fq. 22)

Libri shqip në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta brenda SHBA-së

www.albblibris.al



DY FJALË

Tashmë më duket si aventurë e bukur leximi i Veprës QOSJA 2010, me XXIX vëllime, po ashtu leximi i disa librave, botuar para vitit 2010, përdorur për qëllime studimi. Duke marrë parasysh edhe leximin e shumë librave të tij të mëvonshëm, si dhe ata më të mëhershëm kur vinin në Bibliotekën Kombëtare nga Prishtina, apo kur ndonjëri kishte fatin të botohej në Tiranë dhe shitej nëpër librari para viteve '90, mund të them se prej kësaj pasurie intelektuale të paçmuar, jeta ime ka marrë një kuptim dhe dritë të veçantë.

Por kjo, në radhë të parë është një aventurë krijuese me përmasa kombëtare e Rexhep Qosjes, më e madhja deri më sot, më e realizuara, që përfshin në kozmosin e saj: ligjërime letrare dhe studime historiko-letrare, kritikë letrare, studimin në tri vëllime për letërsinë e Rilindjes Kombëtare të titulluar *Historia e Letërsisë shqipe, romantizmi*, me rreth 2000 faqe duke nisur nga poetika, rrethanat historike dhe kulturore, autorët dhe veprat e etapës së parë si dhe autorët dhe veprat e etapës së dytë, shoqëruar me analiza dhe përfundime « [...] në këtë vepër kam dhënë dashurinë më të madhe mendore dhe shumë vjet të punës kërkimore [...] » (QOSJA Vepra V : 13), vepër e pakrahasueshme, vepër jete që mund ta realizonte në një mënyrë të tillë, të gjerë, të thellë e të frymëzuar një studiues i rrallë, një krijues e atdhetar si Rexhep Qosja. [...] Në këtë kozmos krijimtarie të organizuar vijnë pastaj libra për sociologjinë historike të letërsisë, për krijuesit dhe institucionet kulturore, për nocionet e reja albanologjike, për udhëtimin e Kosovës drejt lirisë, për polemikën si dhe politologjinë, për Shqiptarizmin, për vonesat historike, për strategjinë e Bashkimit Shqiptar, për demokracinë në Shqipëri e në Kosovë, për gjuhën e njësuar; pastaj është krijimtaria e tij në prozë dhe dramaturgji, në një fiksjon si realitet i dytë. Në të gjithë veprën e Qosjes ndriçon një ideal i vetëm : Lartësimi i kulturës shqipe.

PARASHTRIM

Për një autor të lashtë japonez kanë thënë se ai u ngjante atyre valëve të detit që përplasen pa pushim në breg duke pranuar ligjin e ekzistencës së tyre. Të shkruash për Rexhep Qosjen, duhet të njohësh misterin e lëvizjes së valëve, të cilat duken sikur thyhen, por rinisin me vrull dhe bukuri të përgjeshme.

Historian i letërsisë shqipe dhe teoricien i saj, shkrimtar, kritik, dramaturg, eseist i kulturës, publicist, politolog dhe albanolog, vepra e tij përfaqëson një unitet ligjërimit, në të cilin idetë dhe motivet e ndryshme i shoqëron një filozofi që shkon drejt përsiatjes universale.

I plotpushtetshëm në atë që ka shkruar dhe i shndërruar tashmë në figurë referimi, Qosja është një nga penat më të fuqishme dhe një nga mendjet më të ndritura shqiptare për shumë arsye, por më kryesoret janë: shtjellimi i plotë i veprës së rilindësve, kuptimësia e thellë e realitetit shqiptar dhe interpretimi humanist i çdo problematike.

Qosja është një pasardhës i denjë i Naim Frashërit, në mënyrën si ta duash Shqipërinë dhe si ta ndriçosh kulturën e saj, një Volter i Shqiptarëve në mënyrën si të mos pajtohesh me të keqen dhe ta luftosh padrejtësinë nga cilido krah që të vijë. Librat e tij i lidh një frymë tërëkohësie e bashkëkohësie, e cila sillet rreth ligjërimit dhe kuptimit të tij, deri te parimet morale që përballesh me ekzistencën dhe identitetin: "[...] njerëzit s'është pyetje kur s'janë të nxitur prej dhembjes apo prej dashurisë [...]" (Vdekja më vjen prej syve të tillë, Vepra XII: 33).

Fuqia e stilit të tij qëndron në kërkimin e pareshtur estetik të vlerave simbolike të shprehjes si dhe në përdorimin e pasurisë së gjuhës shqipe, duke e rifikësuar ligjërimit gjithnjë në gurrën e saj. Falë pasionit të pasuar krijues që ka ushqyer gjithnjë shpirtin dhe mendjen e tij, ai na jep në dorë edhe çelësat e atij ligjërimit, i cili tashmë përbën epokë. "12.4.1966: Kam shumë dëshira. [...] Prej të gjitha këtyre dëshirave, njëra më rri më së shumti, ditën dhe natën, në zemër dhe në mendje: është dëshira që të merrem, së pari me studimin e letërsisë shqipe, me kritikën dhe me historinë e saj – të asaj të sotmes dhe të asaj të traditës dhe mandej, edhe me krijimin e letërsisë" (Ditari I).

Libri i tij i parë *Epizode letrare* (1967) përmban shkrime për autorë nga Shqipëria dhe Kosova, me qëllimin « të bashkojë një letërsi të copëzuar ». Ai e zgjeron këtë ide në disa ese, si: *Për traditën e kundër tradicionalizmit* (1967); *Prometeizmi në poezinë shqipe* (1968) dhe ndonjë tjetër, të cilat i boton te revista *Jeta e Re*² e më

1 Shembujt e këtij teksti janë marrë nga QOSJA Vepra, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës (2010); në raste të ndryshme do të citohej burimi.

2 Esetë e fillimit Qosja i botoi në revistën *Jeta e Re*, organi i parë letrar i Kosovës. Revista u themelua (1949) nga poeti Esad Mekuli, i cili që edhe kryeredaktor i saj deri në vitin 1972. Në këtë revistë kanë botuar krijimet e para ndër të tjerë edhe Adem Demaçi (Dema), Anton

Rexhep Qosja: Bisedë ende e pambaruar

Nga Feride Papeleka

"E vërteta është mënyra e dashurisë sime për popullin tim dhe për kulturën e tij".
Rexhep QOSJA, *Letërsia shqipe në perspektivën kombëtare*

"Ideja e bashkimit kombëtar është ide që e ka lëvizur historinë shqiptare dhe ne nuk guxojmë ta braktisim për qejf të askujt në këtë botë. Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë do të ndodhë, sepse ky bashkim është në interesin e përgjithshëm të popullit shqiptar dhe është në interesin e mirëkuptimit të popujve të Ballkanit".
Intelektualët, etika dhe politika, QOSJA Vepra XXVIII

"Njeriu është libër i madh që kurrë s'lexohet deri në fund".
Rexhep Qosja, *Tronditja e shekullit II*

"[...] asgjë nuk është e humbur përgjithmonë në qoftë se nuk e ke humbur besimin".
Rexhep Qosja, *Bijtë e askujt I*

"Një natë derisa në mendjen time vazhdon-te loja mes fytyrës së saj dhe jve të qiellit, papritmas Hana do të më thoshte: Dëshiroj të marthohemi [...]"
Një dashuri dhe shtatë faje, QOSJA Vepra XIV

« Oh, ti qenke Danjoll! Çfarë sysh! Vdekja më vjen prej syve të tillë! »
[...]

Nuk është thikë jo, është diçka më e rrezikshme. Çka është, atëherë? Penë, Danjoll, penë. Penë, pra. [...] plaga që të sjell pena dhemb shumëfish më tepër se plaga e thikës dhe nuk pushon kurrë dhe nuk harrohet kurrë. »
Vdekja më vjen prej syve të tillë, QOSJA Vepra XII

Vdekja më vjen prej syve të tillë, QOSJA Vepra XII

"Shkrimtari dhe intelektual i kanë mision e kjo do të thotë përgjegjësi e detyrime në jetën e një populli, në çdo kohë".
Rexhep Qosja (Nga një intervistë)

vonë edhe te *Fjala, Gjurmime albanologjike dhe Rilindja*. Ndërsa në esenë *Letërsia kombëtare dhe letërsia botërore ose afrimi përmes ndryshimeve* (1972), vërejmë se Europa që ishte atë "larg" Shqipërisë, po europianizonte mendimin shqiptar jashtë kufijve të saj shtetërorë.

Edhe në romanin e parë *Vdekja më vjen prej syve të tillë* (1974), kemi një ligjërimit ekzistencial, të shoqëruar me ankhin metafizik që shkakton pamundësia e të jetuarit nën mbikëqyrje. Tekstet e fillimeve letrare të shumë autorëve shpesh zbulojnë një forcë shkreptimtare, një talent që kapërcen traditën. Një ndër shkrimet kritike franceze e ka quajtur atë « pasqyrë të thyer », nisur nga pamja e fragmentuar e jetës. Kur botoi romanin, ai kishte pas vetes një të kaluar të pasur si krijues i interesuar për kulturën shqipe dhe për letërsinë e saj: *Epizode letrare* (1967), *Dialog me shkrimtarë* (1968), *Kritika letrare* (1969), *Antologjia e lirikës shqipe* (1970), *Kontinuitete* (1972), *Asdreni - jeta dhe vepra e tij* (1972), *Panteoni i rralluar* (1973), kështu që me emrin e tij po përvijohet edhe një figurë e re: shkrimtari intelektual.

Qosja i zotëron plotësisht subjektet e librave të vet, cilado qoftë tema, sepse jeton mes kuptimit absolut të krijimtarisë. Të shkruarit për të është një moment i mrekullshëm e i pakthyeshëm, në të cilin shkrihen aftësia shkencore ose përfytyruese me lirinë e fjalës. Kalimi mjeshtror në fusha të ndryshme të krijimit, ka ndërthurur përditë e më shumë një raport vazhdimësie në ligjërimitin e tij, duke mos e humbur asnjëherë vështrimin nga tërësia. Filozofi Vitgenshtajn³ në një ditar të

Pashku, Din Mehmeti, Rrahman Dedaj, Azem Shkreli, Nazmi Rrahmani, Ramiz Kelmendi, Ali Podrimja, Edi Shukriu, Flora Brovina, Mehmet Kraja e shumë të tjerë. Në vitet '80 e '90 ajo doli me pak numra dhe me pak faqe për shkak të vështirësive financiare, por u mbyll për fare në vitin 2006. *Jeta e Re* u rihap (2010) nga Demë Topalli, me kryeredaktor Agim Apollonin. Sot është kryeredaktor Agron Gashi.

3 Ludwig WITTEGSTEIN (1889-1951 - Filozof austriak dhe më vonë britanik që ka sjellë ndihmesë vendimtare në logjikë, në teorinë e bazave matematike

mbajtur gjatë Luftës së Parë botërore, kur ishte i angazhuar në front, flet ndër të tjera edhe për punën e tij si filozof i përcaktuar për të pasur një pamje të tërësisë që të mund ta shpinte punën më tej. Kërkimi i vazhdueshëm i lidhjes së pjesëve me të tërën e karakterizon edhe krijimtarinë e Qosjes, në të cilën janë përpunuar koncepte të përparuara për nocionet *letërsi shqipe, gjuhë e njësuar, estetikë, kulturë, poetikë, romantizëm, tipologji, stilistikë, roman, personazh, mit, etikë, pushtet, demokraci, identitet, komb*, të shoqëruara me vetëdijen e një ideali të fuqishëm intelektual që është një fill organizues *sui generis* i të gjitha teksteve të tij.

Në krijimtarinë shkencore, fillimisht me esetë dhe pastaj me studimet, ai ka dëshmuar **së pari, përvetësim krijues të teorive e metodave** kritike dhe së dyti, njohje konkrete të teksteve burimore për të bërë analiza, sinteza dhe krahasime mes autorësh, veprash a periudhash letrare. Kjo punë e thelluar i ka dhuruar atij më pas një konceptim objektiv e të gjithanshëm për të shkruar historinë e letërsisë shqipe, e cila i kapërcen mangësitë e mëparshme dhe kryen funksionin e saj themelor, rindërtimin e një historie letrare, e cila mbështetet në parimet ideoestetike dhe në vlerat stilistike të veprave.

Në krijimtarinë letrare, me romanet, ai përpikët të zbulojë të vërtetën e unit, duke e transformuar kohën në simbol dhe rrëfimin në një strukturë fragmentare si karakteristika të qenësishme të letërsisë moderne dhe postmoderne. Drama e tij i kundërvihet çdo miti të rremë dhe nxit për një qëndrim qytetar ndaj dukurive shoqërore. Tregimi është satirë dhe alegori e qeverisjes primitive në demokraci.

Në krijimtarinë politologjike e publicistike, e cila trajton probleme të aktualitetit apo edhe historike, ndihet ligjërimit sociopolitik i njërit prej mendimtarëve më të shquar të kohës sonë. Mënyra e parashitjes të problemit me një strukturë të organizuar, me mendime të thella e të qarta, me një stil të veçantë, të paimitueshëm dhe me përfundime logjike, janë një shkollë përherë e re për gazetarët e të gjitha fshave.

Marrëdhëniet e njeriut me unin e brendshëm e me jetën, si dhe dialogu me botën shqiptare do të mbeten një betejë e përhershme ideore dhe estetike në tekstet e tij, qofshin imagjinare, qofshin ato reale. Por edhe përjetimi i vazhdueshëm i historisë së kombit, i ka përpunuar lidhjet e tij me shkrimin, duke i kthyer ato përfundimisht në stil jete: "Ideja e bashkimit kombëtar është ide që e ka lëvizur historinë shqiptare dhe ne nuk guxojmë ta braktisim për qejf të askujt në këtë botë. Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë do të ndodhë, sepse ky bashkim është në interesin e përgjithshëm të popullit shqiptar dhe është në interesin e mirëkuptimit të popujve të Ballkanit" (*Intelektualët, etika dhe politika*, Vepra XXVIII: 499).

Qosja studiues dhe kritik letrar, romancier apo dramaturg dhe Qosja historian apo teoricien i letërsisë, polemist, politolog dhe gazetar i angazhuar për çështjen kombëtare, duhet të vështruhet veç e veç, doemos, se aty veprohet me mekanizma të ndryshëm gjuhësorë e rrëfimtari, por ata i bashkon një qëllim i vetëm drejt dritës së mendimit. Zotërimi i disa teknikave të shprehjes ka sjellë pastaj në mënyrë intuitive programimin dhe riprogramimin tematik të veprës, duke ia shtuar domethënien dhe duke e pasuruar edhe më tepër strukturën e saj. Për të njëjtin tekst nuk është kombinim fjalësh e fjalish, por çështje të vërtetash shkencore ose artistike, të lidhura ngushtë me kulturën, historinë dhe jetën shoqërore.

Nocioni i motivimit gjuhësor dhe estetik luan një rol qendror në ligjërimitin e tij. Përveç traditës shqiptare, të formësuar sidomos me veprat e Rilindjes Kombëtare, ai e ka gatuar tërë veprën me një brumë intelektual dhe estetik, të ardhur nga brezi i artë i Europës së gjysmës së dytë të shekullit XX, i cili solli teori të reja në shumë fusha, si: kritikë, teori letërsie, psikanalizë, sociologji, pikturë, skulpturë, kinematografi...

Do të ishte me vend të shtrohej pyetja se cila është vetvetishmëria nistore e krijimtarisë së Qosjes dhe si ka arritur ai që ta zgjerojë e ta begatojë atë, duke ruajtur njëkohësisht një unitet të brendshëm? Përgjigjja nuk është e

të mendimit dhe në filozofinë e gjuhës. Sa ishte gjallë, botoi në Londër vetëm një libër: *Tractatus logico-philosophicus* (Traktat logjiko-filozofik, 1921).

thjeshtë. Mund të jetë edhe se akti i ligjërimit te ky autor ka shpërthyer si njësi në krijim. Por, që të zbërthehet ligjërimiti i tij, duhet mësuar më parë se çfarë e ka frymëzuar drejt këtij udhëtimit të çuditshëm, në të cilin ndërthuren fati i tij si individ me fatin historik të kombit.

Lidhja e padukshme që thurin subjektet me njëri-tjetrin tregon edhe se vepra dhe jeta e autorit janë të lidhura ngushtë dhe pasqyrojnë të njëjtën kërkëse estetike dhe etike dhe të njëjtën fuqishmëri intelektuale. Megjithatë çështja nuk mbetet thjeshtë në termat që përdoren. Është me interes të dihet, gjithashtu, se krijimi i këtyre qendrave rrezatuese të ligjërimit, i ka shërbyer autorit edhe për të shkuar drejt së vërtetës. Në veprën e tij ndërshihen tema e subjekte të fushave të ndryshme të letërsisë, kulturës dhe jetës në demokraci si në një rrëfim të pandërprerë. Vepra e Qosjes i nënshtrohet një enigmatike thaujse të lindur te krijues të rrallë, të cilët kanë gjeninë të ndërtojnë marrëdhënie të thella me shumë objekte medimiti. Një qasje analitike e teksteve me natyra të ndryshme, shpërfaqe menjëherë indin e tyre të përbashkët krijues.

Ajo që duket fillimisht si kalim i rastësishëm ligjërimit nga një fushë në tjetër në veprën e tij, mund të shpjegohet edhe si e paracaktuar nga një thirrje e brendshme për të shprehur në mënyrë sa më të saktë e më të plotë individualitetin e tij. Për këtë cilësi krijuese, të shndërruar tashmë në vlerë ideoestetike, ndonjë studiues nuk ndan të njëjtin mendim.

*Ditari*⁴, e shtyn edhe më tej si kohë ligjërimitin e tij, duke realizuar kështu një *opus magnum* fatlum. Kjo prozë autobiografike, ku përzihen kujtime dhe analiza na njeh me një atmosferë historike, në të cilën autori është dëshmitar, me njerëz dhe ngjarje politike, shoqërore e letrare në Kosovë dhe në Shqipëri, por edhe në Jugosllavi e në botë. Aty shpalosen gjerësisht edhe shqetësimet e tij për identitetin shqiptar, për kulturën dhe shterimin e saj, për cenimet që i bëhen gjuhës shqipe, për gabimet pa fajtorë, për mungesën e frymës demokratike në shoqëri, për harresën ndaj traditës si dhe për konceptet teorike e praktike të krijimtarisë letrare në përgjithësi.

Pavarësisht nga zërat kundër, një fenomen tashmë i njohur në historinë e njerëzimit për figura që janë në pararojë të mendimit, Qosja nuk është ndikuar as nga ndjenja e humbjes dhe as nga ndjenja e mërisë, sepse vepra e tij është një realitet i jetuar me vetëdije e që mbështetet mbi të vërtetën të pakundërshtueshme. Jo gjithnjë, do të përgjigjet kori i atyre që e mohojnë. Sigurisht, edhe zotat, sipas mitologjisë greke, zbresin ndonjëherë nga Olimpi në tokë. Edhe ai trazohet nga një realitet i jetuar ndonjëherë me subjektivitet. Dhe si të mos ndodhë, kur duke u përpjekur ta pengojnë, e kanë shpërqendruar e ai është ndier i vetmuar? I vetmuar, por trim, i gatshëm për t'u sakrifikuar duke mbrojtur të vërtetën. Me një kusht: që të ndriçojë!

Ligjërimiti i Qosjes që ndërton botë, i ka dhënë edhe tekstist një natyrë heteroklitike me vështrimin jetë/vepër si marrëdhënie mes letërsisë, kulturës dhe historisë.

Pjesa e parë ndalet në disa momente të rëndësishme të jetës, të cilat hedhin dritë mbi veprën, ajo vjen e shoqëruar me një analizë të përgjithësuar për karakteristikat e ligjërimit si dhe për disa aspekte të krijimtarisë letrare, shkencore dhe politologjike të tij, ndërsa pjesa e dytë është kryesisht një hapësirë me pyetje e përgjigje. Pjesa e dytë, në të cilën është e pranishme fjala e autorit, kryen një funksion të dyfishtë; ajo jo vetëm është një vetëzbulim, por edhe një lloj *guri filozofik*, që i jep tonin krejt punimit.

Tematika e pyetjeve mbështetet në simbolikën e numrit dymbëdhjetë, i shfaqur qysh në mitologjinë antike me dymbëdhjetë perënditë greke e pastaj me ato romake, me dymbëdhjetë apostujt e Krishterimit apo me dymbëdhjetë muajt e vitit. Ky numër gjithsesi është zgjedhur edhe për të vendosur një kufi, sepse pyetjet rreth një krijimtarie më shumë se gjysmëshekullore mund të ishin të pafundme. Krejt teksti është një përpjekje për të theksuar disa ide të veprës e disa fakte të jetës, të cilat kanë bashkëvepruar, duke

4 Botimin e librit e ka filluar Shtëpia botuese Toena më 2014 me disa vëllime *Dëshmitar në kohë historike*, ditar i nisur nga autori qysh në janar të vitit 1966.

ndikuar në formimin e unit të tij krijues. Kështu ndoshta i jemi afruar sadopak kuptimit të një veprë si dhe zhvillimit intelektual dhe humanist të një personaliteti të madh.

Ky tekst, ushtrim njëherësh shqyrtues dhe zbulues, vjen edhe me risinë për të shtruar ndonjë pyetje e për të formuluar ndonjë ide që zgjon vepra e tij. Për shembull, te cilët mendimtarë është mbështetur Qosja? Si është shfaqur në imagjinatën e tij gjesti i parë krijues? Cilat janë lidhjet e dukshme dhe të padukshme të veprës së tij me idetë e Sami Frashërit e të mendimtarëve evropianë? Çfarë e frymëzon dialogun e tij të përhershëm me botën shqiptare? Përse vepra e Naim Frashërit quhet *Porosia e madhe* në penën e tij? Çfarë të reje ka sjellë vepra e tij në kulturën shqipe? Debatit shkencor në këtë hulli mund të vijojë edhe më tej.

Fryma kritike është një cilësi themeltare, një aksiomë e artit të gjykimin estetik që i ka dhënë jetëgjatësi mendimit të tij e që ka përcaktuar etikën e tij shkencore: "Më së pari kam botuar një punim kritik për letërsinë shqipe. Kulturën e përparuar në Evropë dhe në botë që prej Greqisë antike janë zhvilluar me frymë kritike. Vetëm modeli i kulturës kritike çon përpara".

Stili me fraza të gdhendura dëshmon një prani të fuqishme autoriale në ligjërimin e tij. Prandaj, takimi me veprën e Qosjes është një festë intelektuale. Librat e tij janë libra për pasurimin e mendjes ose si thoshte Gëte, "libra për zgjimin e shpirtit".

Ka një moment historik në jetën dhe veprën e tij. Dhe ky është viti 1981, bartës i një vije ndarëse në ligjërim, pas së cilës subjekti bëhet më i dukshëm. Ai përjetoi kohëra ndryshimesh të mëdha për Kosovën: fillimisht, protestat e rinisë mbi të cilat kaloi pa mëshirë makina e dhunës së përgjakshme të Beogradit, ngushtimin e hapësirave të lirisë së shqiptarëve si dhe trysinë e vazhdueshme të politikës serbo-kosovare, më vonë, edhe luftën në Kosovë me masakra e përndjekje masive si dhe çlirimin e saj. Njëkohësisht ai është dëshmitar i kohërave të trazuara të ndërtimit të demokracisë në Shqipëri dhe në Kosovë, dy bashkësi të tronditura, të cilat ecin mes vështirësive e pengesave historike e psikologjike të një populli të ndarë padrejtësisht nga historia.

Qosja ka një shquarsi në ligjërim që rrallë vihet re te ndonjë autor tjetër shqiptar. Duke shkruar si në "luftë" ashtu edhe në "paqe", në një botë shqiptare që ka vuajtur dhe vuan shpesh nga dhuna verbale e nga mediokriteti, ai ka sendërtuar vlerat shekullore të shqiptarizmit që ka përshkuar shekujt dhe ka mbërritur në kohët e reja i plagosur e i copëtuar, por i patjetërsuar. Vepra e tij përbën një etapë të rëndësishme të zhvillimit të identitetit tonë si pjesë e pandarë e identitetit të njerëzimit.

Çdo qasje studimore për një vepër të madhe është e vështirë, por vështirësia më e madhe qëndron në gjetjen dhe veçimin e faktorit kryesor që e fton lexuesin të hyjë në brendësi të teksteve apo ta ndjekë bisedën si të ishte edhe vetë i pranishëm. Mes kësaj dysie ka qenë e detyrueshme të vendosej edhe një hierarki temash. Nga kjo pikëpamje, çështjet e shtruara, analiza dhe disa përfundime, të bashkuara me përgjigjet e autorit, mbase do të plotësojnë ndonjë zbrazëti në fushën studimore për veprën e tij. Teksti ka synuar edhe që të vëzhgojë nga afër se me çfarë vuajtjesh, mrekullish e brengash është përballur ky studiues dhe historian i letërsisë shqipe, ky shkrimtar, vërejtës i hollë i karaktereve dhe i kohërave, sjellës i postmodernizmit në letrat shqipe, ky atdhetar i madhërishtëm. Të tregohet, më së fundi, si e bën ai të qartë ç'është identiteti kombëtar dhe ai evropian, ç'janë gjuha e njësuar shqipe dhe demokracia e vërtetë, duke i zbritur këto koncepte nga qiejt e arsytimit abstrakt në trojet konkrete të realitetit historik, me një ligjërim të paepur drejt esencës sonë shpirtërore e morale.

* *Shkrimi është pjesë e shkëputur nga libri Rexhep Qosja: Bisedë e pambaruar, cili u botua më 2018 në Prishtinë (me mangësi). Për t'ia bërë të njohur edhe publikut shqiptar të këndej kufirit, ai u plotësua me të gjithë kapitujt dhe u paraqit disa Shtëpive Botuese (për këtë përvojë flas disi më gjatë në tekst), të cilat nuk u treguan të gatshme. Doli Agora një shtëpi botuese që drejtohet nga një shkrimtare, Majlinda Rama, që pranoi. Njëkohësisht u dërgua edhe një letër Ministrisë së Kulturës për financim. Ministria e Kulturës ia transferoi kërkesën Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Agora botoi disa kopje me shpenzimet e veta për panairin e librit 2024, duke pritur financimin që ta botonte me tirazh të mjaftueshëm më 2025. Kështu kaluan vitet 2024, 2025 dhe kjo pjesë e 2026-s me e-maile dhe takime të lodhshme në QKLL, në mënyrë që të paktën të botohej për 90 vjetorin e tij, por asgjë nuk u bë gjermë tani, kur ka ardhur lajmi i hidhur i ndarjes së Rexhep Qosjes nga jeta.*

Rexhep Qosja – një epokë e mendimit shqiptar

Nga Begzad Balio

Është ndarë nga jeta Profesor Rexhep Qosja: shqiptarët në zi. Tek po priteshin aktivitetet për të shënuar 90-vjetorin e lindjes së tij, është ndarë nga jeta Profesi, vetëm pak muaj pa e kurorëzuar vitin e 90-të të lindjes. Profesor Rexhep Qosja (Vuthaj, 26 qershor 1938 – 23 prill 2026) ishte njëri prej personaliteteve më të mëdha të dy shekujve të fundit, i cili në të gjitha periudhat e mëdha historike të gjysmëshekullit të fundit u ka folur shqiptarëve pa kufij si një zë i vetëm, me gjuhën, me veprën dhe me mendimin e pavarur prej intelektualit me vetëdije të lartë historike, i vetëdijshëm se gabimet për çështjet e vogla të kohës janë të përkohshme, ndërsa qëndrimet e mbështetura në vetëdijen historike janë të përhershme.

Autor i më shumë se pesëdhjetë veprave letrare, historiko-letrare, dokumentare dhe publicistike, ai shquhet për veprat me të cilat ka krijuar një jysë kombëtare në botën shqiptare: romanin *Vdekja më vjen prej syve të tillë* (1972–1974); *Anatomia e kulturës* (1976); *Mite të zhveshura* (1978); *Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I–*

III) (1984–1986); *Porosia e madhe (Naim Frashëri)* (1986); *Populli i ndaluar* (1978); *Çështja shqiptare – historia dhe politika* (1994); *Tri mënyra të shkrimit shqip* (2004); *Bijtë e askujt I–II* (2010; 2013); *Dëshmitar në kohë historike I–IX* (2014–2023) etj.

Profesor Rexhep Qosja ishte intelektual i fjalës dhe veprës e tij asnjëherë nuk i ndau nga përgjegjësia kombëtare; prandaj vepra e tij nuk ishte thjesht ide personale e çliruar nga bota, por ndërgjegje kritike dhe protestë ndaj trashëgimisë historike, artikulum racional për kohën dhe përgjegjësi për të ardhmen e shoqërisë shqiptare.

Profesor Rexhep Qosja ishte shkrimtari që krijoi universin e tij letrar: përndjekjen e intelektualit, demonstratat e vitit 1981, kapërcimin e madh nga sistemi komunist në demokracinë evropiane, postkomunizmin – historinë më tipike të botës materiale dhe shpirtërore të hapësirës së popullit shqiptar.

Profesor Rexhep Qosja ishte kritiku i letërsisë dhe jo vetëm i saj, i cili depërtoi në thellësinë e mendimit gjuhësor, kulturor, letrar e historik, duke e rindërtuar atë, duke e ridimensionuar, duke e pastruar

nga iluzionet, nga folklorizmi, nga gjykimi sipërfaqësor, nga pasioni i një brezi që, duke përjashtuar trashëgiminë kombëtare, mendonte se mund të krijonte historinë e re, dhe që, duke e hedhur pas shpine hapësirën etnike, besonte se mund ta ndërtonte atë në një provincë të saj.

Profesor Rexhep Qosja ishte historiani i letërsisë që ridimensionoi konceptin për historinë kombëtare si një lëvizje nacionale, që kishte jo vetëm luftëtarët e armës, por edhe bardët e mendimit. Ai, duke kurorëzuar veprën unike në kulturën shqiptare (*Romantizmi I–III*), i dha popullit shqiptar burimet e krijimit të vetëdijes kombëtare në vend të një kronologjie të thjeshtë të kryengritjeve dhe heronjve.

Profesor Rexhep Qosja ishte publicisti dhe polemisti i betejave të mëdha, i vetëdijshëm se polemika nuk është përplasje, por dialog i sinqertë dhe i vërtetë. Prandaj, aty ku ishte ai – në rrethet kulturore e shkencore në Prishtinë, në polemikat me shkrimtarët serbë në Novi Sad, në diskutimet në shtypin jugosllav të viteve '80–'90, në debatet e tranzicionit nga komunizmi në demokraci, në qëndrimet për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare dhe mbrojtjen e saj në Rambuje – aty zhvillohej beteja e madhe e lirisë së mendimit intelektual.

Profesor Rexhep Qosja ishte autori i veprës më të madhe në kulturën shqiptare, ditarit *Dëshmitar në kohë historike*, në shumë vëllime, prej të cilave deri më tash janë botuar nëntë vëllimet e para për periudhën 1968–2008. Ditarin kishte filluar ta mbante që në vitin 1956. Në dorëshkrim mbeten edhe vëllimet që mbulojnë periudhën 2008–2026. Si askund tjetër në tekstet e historisë bashkëkohore, në dokumentet shtetërore e qeveritare apo në shtypin ditor e shkencor, në këtë ditar prej disa mijë faqesh bota shqiptare shfaqet e dokumentuar, e sistemuar, e zhveshur katërçipërisht, pa maska dhe pa ndërmjetësim – e vërtetë.

Në këtë vepër ai është dëshmitari i parë, shpesh i vetëm dhe gjithmonë i saktë, që lufton me fjalën si Muhameti dhe e pranon peshën e kryqëzimit si Krishti. Me këtë vepër, Profesor Qosja i ka ngritur vetes dhe kulturës shqiptare një monument, për të cilin brezat e ardhshëm do ta kenë të vështirë të gjejnë vendin; prandaj, më parë se në një shesh, ai ka më shumë gjasa të qëndrojë në ndërgjegjen tonë dhe të brezave që vijnë.

Rexhep Qosja ishte nga ata njerëz për të cilët koha nuk gjen fjalë të mjaftueshme, sepse ata nuk i përkasin vetëm një epoke, por vetë bëhen një epokë. Ai është një nga ata mendimtarë që zhvendosin vëmendjen e një shoqërie nga kokat që sundojnë te kokat që mendojnë, dhe kur një mendje e tillë hesht, vendi e ndien si një tronditje të thellë – një boshllëk që nuk mbushet me zhurmë, por vetëm me kujtesë.

Ai ishte intelektual i cili nuk pranoi rehati, shkrimtari që nuk u mjaftua me rrëfim, kritiku që nuk kurseu të vërtetën, historiani që nuk e trajtoi traditën si relike, por si energji, polemisti që e bëri mendimin fushë beteje, publicisti që e ktheu fjalën në akt dhe politikani që e pa përgjegjësinë si barrë dhe jo si privilegj. Ai mbetet një ndërgjegje që e ndërtoi vetë piedestalin e saj.



Skulptori italo-shqiptar që po hap botën me art

E themeluar në vitin 1895, "La Biennale di Venezia" në edicionin e saj të 61-të mbetet një nga platformat më të rëndësishme ndërkombëtare për artin pamor bashkëkohor. Përmes Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit, ajo ka ndikuar drejtpërdrejt në formësimin e tendencave artistike dhe në legjitimimin e praktikave të reja kuratoriale. E strukturuar mbi sistemin e pavjoneve kombëtare dhe ekspozitën qendrore të kuruar, Bialja funksionon si një hapësirë ku ndërthuren kërkimi artistik, diskursi kritik dhe përfaqësimi kulturor. Në këtë kontekst, arti pamor nuk paraqitet vetëm si formë estetike, por si një mjet reflektimi mbi realitetet politike, sociale dhe identitare të kohës. Sot, Bialja operon si një laborator i artit bashkëkohor, ku prodhohen narrativa dhe përcaktohen drejtimet e zhvillimit të tij në shkallë globale. Në këtë edicion të "La Biennale di Venezia", Shqipëria përfaqësohet në pavijonin e saj zyrtar nga artisti Genti Korini me veprën "A Place in the Sun", një instalacion me imazh lëvizës, kuruar nga kritikja dhe kuratorja polake Malgorzata Ludwisiak. Projekti vendos në qendër një qasje ndërdisiplinore, ku narrativa vizuale ndërtohet përmes një gjuhe hibride mes teatrit, animacionit dhe strukturës filmike. Në të njëjtën kohë, në këtë ngjarje madhore të artit pamor ndërkombëtar merr pjesë edhe artisti italo-shqiptar **Alfred Mirashi - MILOT**, i cili prezantohet me instalacionin "Mjaft me çelësa". Vepra, e konceptuar si një reflektim i gjatë personal, artikulon një diskurs mbi kufijtë, kontrollin dhe lirinë, duke u zhvilluar ndër vite deri në formën e saj aktuale. Siç shprehet vetë artisti, projekti ka qenë menduar që në fillim për t'u prezantuar pikërisht në kontekstin e Bienales, si një hapësirë ideale për ndarjen e një përvojë artistike intime dhe universale njëkohësisht. Instalacioni do të ekspozohet në Pallatin "Donna delle Rose" në Venecia, në kuadër të pavijonit zyrtar të Republikës së Guinesë Ekuatoriale, ku Alfred Mirashi Milot është i ftuar nga kuratori spanjoll Joan Abelló. Kjo pjesëmarrje e pozicionon artistin në një dialog ndërkulturor, duke e zgjeruar praninë shqiptare përtej përfaqësimit kombëtar dhe duke e vendosur atë në një kontekst më të gjerë global.

"La Biennale di Venezia" Artisti italo-shqiptar **Alfred Mirashi Milot** prezantohet me veprën "Mjaft me çelësa"

Nga Ylli Drishti

Historian & Kurator Arti

"Ne duam një botë më të mirë, të hapur për të gjithë, pa çelësa."
MILOT

Po kush është artisti Alfred Mirashi - MILOT dhe si arriti ai të hyjë me sukses në artin bashkëkohor – cila është "gjuha monumentale e veçantë" e suksesit të MILOT?

Në peizazhin e skulpturës bashkëkohore europiane, figura e Alfred Mirashi Milot shquhet për një gjuhë artistike të qartë dhe universale. I lindur në Laç, Shqipëri (1969) dhe i formuar në Itali, ai mishëron një identitet italo-shqiptar që tejkalon biografinë, duke u shndërruar në substancë konceptuale të veprës së tij. Me bazë në Firence, ku tradita dhe bashkëkohorja bashkëjetojnë në mënyrë organike, Milot ka ndërtuar një praktikë që lëviz mes skulpturës monumentale, instalacionit dhe artit publik. I diplomuar në "Accademia di Belle Arti", në Milano, ai e vendos veprën në një dialog të drejtpërdrejtë me hapësirën dhe publikun.

Që nga fillimi i viteve 2000, prania e tij ndërkombëtare konsolidohet përmes ekspozitave në institucione të rëndësishme italiane. Momente kyçe si "The Venuses of Milot" në Maschio Angioino dhe "Believe" në Firence dëshmojnë një pjekuri të hershme konceptuale dhe një profil të artikulluar kuratorial. Në qendër të praktikës së tij qëndron një simbol i vetëm: "ÇELESIT" - "KEY", i transformuar nga objekt funksional në formë monumentale, ai bëhet metaforë e hapjes, unitetit dhe mundësisë. Vepra si "Key of Cervinara" (Itali, 2017), një strukturë

madhështore në **çelik Corten** - me lartësi 20 metra, apo "Key of Montevergine" - 50 metra, instalacion monumental i porositur në Avellino, shndërrohen në shenja urbane dhe filozofike-akte që sfidojnë ndarjen dhe propozojnë një etikë të hapjes.

Ky motiv zhvillohet në instalime të tjera si "Key of Unity" në Napoli, "Albanian Key" në **Shkodër**, Shqipëri (2024), dhe "Key of Wuhan", R.P.Kinë (2024), duke konfirmuar një shtrirje të gjerë gjeografike dhe simbolike. Në Kinë, ku ai ushtron veprimtarinë si pedagog dhe drejtues artistik, Milot ndërton një urë të qëndrueshme mes Lindjes dhe Perëndimit, duke u pozicionuar si një ndërmjetës kulturor i kohës sonë. Ky angazhim kulmon me pjesëmarrjen e tij në "**Chengdu Biennale-2026**", ku do të prezantojë një veprë të re monumentale në formë diptiku - një vijim i kërkimit të tij mbi simbolin dhe hapësirën. Arti i Milotit artikullohet si një qëndrim etik po aq sa estetik. "Çelësat" e tij nuk mbyllin, por hapin: jo hapësira fizike, por horizonte mendimi. Në një botë të fragmentuar, ato propozojnë dialogun si formë rezistence dhe hapjen si mundësi.

Gjatë karrierës së tij, MILOT është vlerësuar me çmime dhe nderime të rëndësishme ndërkombëtare. Ndër më prestigjiozet janë Medalja e Artë në Pikturë në Barbican Centre Museum, Olympic Fine Art London (2012), Çmimi Ndërkombëtar i Pikturës në Water Cube Museum në Pekin (2012), si dhe çmimi për arritje jetësore "Artis Suavitas Civitas 2022" në Pallatin Mbretëror të Napolit. Kontributi i tij në kulturën publike është vlerësuar edhe me



titullin Qytetar Nderi i Cervinarës, për dhurimin e skulpturës së tij monumentale. Vepra e tij është mbështetur dhe analizuar nga kritikë të njohur, drejtorë muzeumesh, historianë arti dhe institucione kulturore në Itali, Shqipëri dhe Kinë, përfshirë Wu Weishan (Drejtor i Muzeut Kombëtar të Kinës), Francesco Poli, Eduardo Cicelyn dhe shumë kuratorë e studiues të rëndësishëm. Arti i MILOTIT qëndron si një gjuhë bashkëkohore e identitetit dhe hapjes, ku forma, simbolika dhe monumentaliteti ndërthuren për të krijuar vepra që lidhin histori, popuj dhe kombe - përmes një vizioni që eksploron vazhdimisht dialogun mes kulturave, kujtesës dhe së ardhmes.

Në vijim, për një lexim më të thelluar të veprës së Alfred Mirashi Milot në Bienale, paraqesim intervistën me artistin.

Y.D. - Me cilën veprë merrni pjesë në këtë edicion të Bienales së Venecias dhe si lindi ideja e saj?

Alfred Mirashi - MILOTI: Puna me të cilën po marr pjesë në këtë edicion të Bienales së Venecias titullohet "**Mjaft me çelësa**". Është një ide që e kam pasur me vete për shumë vite: ajo rrjedh nga një reflektim që u pjek me kalimin e kohës dhe u zhvillua ngadalë derisa gjeti formën e tij përfundimtare. Gjithmonë kam dashur ta paraqes atë pikërisht në këtë kontekst, sepse besoj se Bialja është vendi ideal për të ndarë një veprë kaq personale dhe kuptimplotë.

Y.D. - Çfarë përfaqëson kjo veprë në thelb dhe cilat janë shtresat konceptuale që mbart?

MILOTI: - Në këtë kuptim, "No More Keys" nuk është thjesht një veprë, por një thirrje: është koha të ndalojmë së jetuari "të mbyllur" dhe të fillojmë të imagjinojmë një botë pa barriera, ku të gjithë mund ta shprehin plotësisht fatin e tyre.

Y.D. - Cilat materiale dhe teknika keni përdorur në realizimin e saj dhe pse i zgjodhët pikërisht ato?

MILOTI: - Përdora materiale dhe teknika të ndryshme për të rritur kuptimin



e veprës. Pjatat janë bërë nga terrakota, një material tradicional i përdorur për shekuj me radhë. E zgjedha për lidhjen e saj me historinë dhe artizanatin, por edhe për aftësinë e saj për të përcjellë ngrohtësi dhe autenticitet. Telekomandat, nga ana tjetër, u projektuan dhe u krijuan në 3D: çdo telekomandat është unik, i shtypur në rrëshirë dhe më pas i pikturuar me dorë. Zgjodha këtë teknikë për të krijuar forma të sakta dhe të personalizuar. Së fundmi, i dekorova telekomandat me elementë të frymëzuar nga lulet e pyllit dhe detajet e maskave. Kjo zgjedhje rrjedh nga dëshira për të kombinuar natyrën dhe simbolikën, duke shtuar një shtresë ekspresive dhe narrative në vepër.

Y.D. - Në cilin pavijon apo hapësirë ekspozuese do të prezantohet vepra juaj?

MILOTI: Instalacioni im do të prezantohet në Pallatin "Donna delle Rose" në Venecia, në pavijonin zyrtar të Republikës së Guinesë Ekuatoriale. Në eficionin 61-të Bienales së Venecias. Kjo hapësirë, e vendosur në një nga qendrat më të rëndësishme të artit bashkëkohor, krijon një dialog të hapur mes kulturave, identiteteve dhe gjuhëve artistike të ndryshme. Brenda këtij konteksti ndërkombëtar, vepra ime synon të ndërthurë traditën me teknologjinë, duke ofruar një përvojë vizuale dhe simbolike që fton vizitorin në reflektim dhe interpretim personal.

Y.D. - Pjesëmarrja juaj në Bienale vjen si artist i ftuar, përmes një përzgjedhjeje kuratoriale apo përfaqësoni një institucion/shtet?

MILOTI: - Pjesëmarrja ime në Bienale vjen si artist i ftuar nga kuratori spanjoll Joan Abelló, i cili është zgjedhur të prezantojë pavijonin e Republikës së Guinesë Ekuatoriale. Kjo ftesë përfaqëson një mundësi të rëndësishme për mua për të ndarë punën time në një kontekst ndërkombëtar dhe për të qenë pjesë e një dialogu artistik mes kulturave të ndryshme.

Y.D. - Si e përjetoni pjesëmarrjen në një nga ngjarjet më të rëndësishme të artit bashkëkohor në botë?

MILOTI: - Pjesëmarrja në një nga ngjarjet më të rëndësishme të artit bashkëkohor në botë është një përjetim i vështirë për t'u përkufizuar me një fjalë të vetme. Është një ndjesi që ndërthur emocionin, krenarinë dhe një lloj përmbushjeje të brendshme që vjen pas një rrugëtimi të gjatë. Pas shumë vitesh pune, përkushtimi dhe sakrificash, të

arrish në një pikë të tillë është si të prekësh një ëndërr që shumica e artistëve e mbajnë brenda vetes. Është një moment që jo vetëm vlerëson punën tënde, por edhe të bën të reflektosh mbi gjithë rrugën që ke kaluar për të arritur deri aty. Në të njëjtën kohë, kjo përvojë nuk është vetëm një kulm, por edhe një fillim i ri - një hapje drejt mundësive të tjera, bashkëpunimeve dhe sfidave të reja në botën e artit bashkëkohor.

Y.D. - A ka një vazhdimësi mes kësaj vepre dhe ciklit tuaj të njohur të "Çelësave"?

MILOTI: - Po, ka një vazhdimësi të natyrshme me ciklin e "Çelësave". Kjo vepër duket më e përpunuar dhe e rafinuar, duke ruajtur idetë bazë por me një shprehje dhe harmoni më të përfortuar.

Y.D. - Si ndikon përvoja juaj ndërkulturore mes Shqipërisë, Italisë dhe Kinës në këtë projekt të ri?

MILOTI: - Përvoja ime ndërkulturore ka qenë vendimtare për këtë projekt. Pas shumë vitesh duke jetuar dhe punuar në Shqipëri, Itali dhe Kinë, kam marrë një gamë të gjerë ndikimesh vizuale dhe kulturore. Kjo udhëtim dhe ekspozim i vazhdueshëm ndaj kulturave të ndryshme më ka frymëzuar thellësisht dhe ka pasuruar gjuhën time artistike, duke sjellë nuanca dhe perspektiva të reja në këtë vepër.

Y.D. - Çfarë dialogu shpresoni të krijohet vepra juaj me publikun ndërkombëtar të Bienales?

MILOTI: - Shpresoj që vepra të krijojë një dialog të hapur dhe reflektues me publikun ndërkombëtar. Ky është momenti më i duhur, jo vetëm për mua, por për çdo artist që merr pjesë në Bienale - një mundësi për të ndarë eksperiencën, emocionet dhe vizionet, dhe për të lidhur kulturat përmes artit bashkëkohor.

Y.D. - Në një kohë kur arti shpesh përballet me sfida globale, cili është roli i artistit sot sipas jush?

MILOTI: - Artistët sot janë si një "gjimnastikë shpirtërore": praktikojnë çdo ditë, reflektojnë kohën, shprehin emocionet dhe sfidojnë perceptimet, ndërsa ndikimi i tyre shpesh duket vetëm me kalimin e kohës.

Y.D. - Duke parë rrugëtimin tuaj artistik, cili moment ka qenë më përcaktues në karrierën tuaj?

MILOTI: - Çdo ditë është një pjesë e bagazhit tim artistik; studimet në Breda



dhe Angli, jeta në Firence dhe eksperiencia në Kinë bashkëformojnë rrugëtimin tim dhe krijojnë diçka më të madhe se secili moment "veç e veç".

Y.D. - Si ka evoluar simbolika e "çelësit" në veprën tuaj ndër vite?

MILOTI: Simbolika e "çelësit" në veprën time ka evoluar ndjeshëm gjatë viteve. Fillimisht ishte një lojë artistike, një eksperiment formash dhe ideje, por me kalimin e kohës mori përmasa më të mëdha, duke u shndërruar në skulptura monumentale të vendosura në sheshe dhe hapësira publike në mbarë botën. Çelësi nuk është thjesht një objekt; ai është simbol i mundësive të pakufishme, i hyrjeve në botëra të reja dhe i lidhjes mes njerëzve dhe kulturave. Ky hap shpesh ka kërkuar guxim - një guxim i ushqyer nga besimi në mesazhin tim bashkëkohor dhe dëshira për të krijuar një dialog të hapur me publikun, duke i dhënë secilit mundësinë të zgjidhë "çelësin" e tij dhe të hapë derën e interpretimit dhe imagjinatës.

Y.D. - Çfarë ju frymëzon sot, pas një karriere tashmë të konsoliduar ndërkombëtarisht?

MILOTI: - Sot, pas një karriere tashmë të konsoliduar ndërkombëtarisht, ajo që më frymëzon më shumë është të ëndërroj më tej. Nuk kënaqem me pak; ëndërroj të mbush disa qytete dhe muze me skulpturat dhe pikturat e Milotit, duke krijuar hapësira ku arti bëhet pjesë e përditshmërisë dhe dialogut mes njerëzve. Çelësi, i cili ka shoqëruar rrugëtimin tim artistik, mbetet simbol i mundësive të pakufishme - një ftesë për çdo shikues që të hapë derën e imagjinatës dhe të lidhet me veprën në mënyrën e tij. Ëndërrat e mia sot janë një thirrje për hapje: hapje hapësirash, mendjesh dhe zemrash për të ndërthurë, interpretuar dhe bashkëjetuar me artin në çdo kënd të botës.

Y.D. - A ka ende "dyer" që kërkon t'i hapni përmes artit tuaj?

MILOTI: - Ahahah, ndoshta ende ka "dyer" për t'u hapur, por unë nuk i mendoj shumë. Burokracia është kudo, por idetë dhe vizioni janë çelësi ynë për t'i sfiduar ato. Shpresoj që një ditë të mos ketë më dyer të mbyllura, dhe çdo hapësirë - qytet, muze apo shesh - të jetë mundësi për art, dialog dhe kreativitet. Çelësi nuk është thjesht simbol; ai është ftesa për të hapur mendjet dhe zemrat e njerëzve, për të bërë artin të prekë jetën në çdo formë dhe vend.

Y.D. - Çfarë këshille do t'u jepnit artistëve të rinj shqiptarë që ëndërrojnë një karrierë ndërkombëtare?

MILOTI: - Mos u ndaloni nga këshillat e të tjerëve; shumë prej tyre shpesh bazohen në paragjykime ose frikë. Qëndroni kuriozë ndaj botës dhe kulturave të reja. Çdo udhëtim, çdo përvojë e re është një burim frymëzimi. Keni guximin të provoni, të udhëtoni dhe të shprehni veten lirshëm - pa frikë nga dështimi. Punoni vazhdimisht në artin tuaj, por mos harroni të mësoni nga njerëzit dhe vendet që takoni gjatë rrugës. Pra, suksesin ndërkombëtar nuk vjen vetëm nga teknikë apo talent, por nga guximi për të eksploruar dhe hapësira për të mësuar nga bota.

Y.D. - Sa e rëndësishme është këmbëngulja përballë refuzimit dhe vështirësive në art?

MILOTI: - Çdo refuzim është një hap drejt botës që pret të njohë artin tënd - mos u ndal, vazhdo të krijosh. Vështirësitë dhe refuzimet janë pjesë e natyrshme e rrugës artistike. Ato shpesh janë provat që na forcojnë dhe na mësojnë të përmirësohemi. Por ajo që i bën artistët të dallohen është këmbëngulja - të mos dorëzohesh për idetë dhe ëndërrat e tua, pavarësisht sfidave. Çdo projekt, çdo vizion që realizohet me durim dhe përkushtim, mund të hapë rrugë të reja dhe mundësi që në fillim duken të paarrtshme.

Y.D. - Si mund të ndërtohet një identiteti artistik autentik në një botë gjithnjë e më globale?

MILOTI: - Ndërtimi i një identiteti artistik autentik në një botë globale: Në një botë ku kultura dhe stilet artistike bashkohen dhe përzihen, sfida më e madhe për çdo artist është të ruajë individualitetin e tij. Identiteti autentik nuk është vetëm mënyra se si duket apo tingëllon arti yt, por si pasqyron historinë, emocionet dhe perspektivën unike të artistit. Çdo fushë e artit kërkon që të gesh zërin tënd, stilin tënd dhe mënyrën tënde të shprehjes, në mënyrë që të dallohesh dhe të bëhesh i njohur.

Y.D. - Çfarë duhet të ruajë një artist i ri me çdo kusht në rrugëtimin e tij?

MILOTI: - Një artist i ri ka nevojë të ruajë disa gjëra thelbësore në rrugëtimin e tij, veçanërisht në mënyrë që të qëndrojë i përlulur dhe të mos ndalet nga sfidat. Përlësia - Të kujtojë gjithmonë që ka gjithmonë diçka për të mësuar, pavarësisht sukseseve që arrin. Përlësia e mban të hapur ndaj kritikës dhe eksperiencës së të tjerëve. Në thelb, një artist i suksesshëm është ai që kombinon përlësinë me durimin dhe pasionin, duke ecur përpara pavarësisht pengesave.



Poezia "Një liqen dhe një fushë" e Natasha Lakos është nga ato krijime poetike që nuk tregojnë një histori në kuptimin e zakonshëm të rrëfimit, por krijojnë një gjendje të thellë përjetimi. Lexuesi hyn në atë si në një peizazh të heshtur, ku natyra duket sikur merr frymë me ritmin e shpirtit njerëzor. Liqeni dhe fusha nuk janë vetëm hapësira të natyrës; ato qëndrojnë përballë si dy qenie që kanë jetuar shumë, që kanë parë shumë dhe tani mbajnë mbi vete një lodhje jete të thellë.

Në këtë poezi, natyra nuk është vetëm sfond i mendimit poetik, por bëhet një trup i gjallë i përjetimit njerëzor; liqeni dhe fusha duken si dy shpirta të heshtur që mbajnë mbi vete kujtesën e një historie, që nuk rrëfëhet me ngjarje, por me gjendje. Kjo mënyrë të shprehuri e afron poezinë me frymën moderniste, ku figura, simboli dhe gjendja shpirtërore kanë më shumë peshë se rrëfimi i drejtpërdrejtë. Peizazhi bëhet një metaforë e qenies njerëzore dhe e historisë së saj të brendshme.

Vlera dhe ndikimi i Lakos në letërsinë bashkëkohore shqiptare janë të njohura edhe ndërkombehtarit. Më 12 mars 2026, në Sallën e Senatit Italian në Romë, ajo u nderua me Çmimin "Divinamente Donna", për "zërin e shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare, ndjeshmërinë kulturore dhe guximin intelektual me të cilat ka pasqyruar gjendjen njerëzore, sfidat shoqërore dhe transformimet e vendit të saj." Ky çmim vlerëson aftësinë e saj për të ndërthurur fuqinë narrative me ndjeshmërinë, për të dhënë një historive të grave, kujtesës dhe qëndresës, dhe për të promovuar kulturën dhe identitetin shqiptar në skenën ndërkombëtare.

Kështu, analiza që pason mund të shihet jo vetëm si një lexim artistiko-filozofik i poezisë "Një liqen dhe një fushë", por edhe si një reflektim mbi ndikimin dhe rëndësinë e poezisë së Lakos në kontekstin kulturor shqiptar dhe ndërkombëtar.

1. Poezia hapet me një tablo të thjeshtë në dukje, por shumë të ngarkuar në kuptim; dy hapësira që qëndrojnë përballë si dy qenie të lodhura nga jeta dhe nga kujtesa
*"Përballë njeri tjetrit qëndrojnë
 Të lodhur, të kapitur, kokëulur"*
 Dy hapësira të natyrës vendosen përballë si dy njerëz. Fjala "qëndrojnë" krijon menjëherë një ndjenjë pritjeje, por të shpirtit njerëzor. Pikërisht këtu fillon personifikimi që përshkon gjithë poezinë.

Pastaj vijnë tri fjalë të rënda: *të lodhur, të kapitur, kokëulur*. Sigurisht që këto nuk janë cilësi të peizazhit, por të shpirtit njerëzor. Pikërisht këtu fillon personifikimi që përshkon gjithë poezinë.

Liqeni dhe fusha duken si dy qenie që kanë kaluar një përplasje mes tyre, një histori, ndoshta një dramë. Ata nuk shikojnë njëri-tjetrin me krenari, por me kokë të ulur, si pas një beteje të brendshme. Në këtë pamje të parë të poezisë duket sikur dy hapësira janë kthyer në dy ndërgjegje të lodhura. Ato nuk janë më vetëm pjesë e natyrës, por dy qenie që mbajnë mbi shpinë peshën e një kohe të gjatë dhe të një historie që nuk thuhet me fjalë. Kjo përballje e heshtur i ngjan dy njerëzve që kanë kaluar shumë së bashku dhe tani qëndrojnë përballë pa mundur të gjejnë më fjalë për njëri-tjetrin.

2. Nga thellësia e ujit dhe e tokës shpërthen e njëjtë energji e jetës, por në forma të ndryshme
*"Një liqen që gufon valët mbi shpinë
 Dhe një fushë që gufon në shpinë lulëkuqet."*
 Folia "gufon" është shumë e fortë. Ajo sjell idenë e një shpërthimi të brendshëm. Por kjo energji del në dy forma të ndryshme. Në liqen ajo shfaqet si valë, si një trazim i thellë i ujit. Në fushë ajo del si lulëkuqe, si një shpërthim ngjyrash mbi tokë. Këtu poezia krijon një kontrast të bukur. Uji dhe toka përgjigjen ndryshe ndaj së njëjtës energji të brendshme. Valët janë lëvizje dhe trazim, ndërsa lulëkuqet janë një shpërthim i qetë i jetës dhe i ngjyrës. Në këtë çast duket sikur natyra flet përmes dy gjuhëve të ndryshme: uji flet me lëvizje dhe zhurmë të brendshme, ndërsa toka flet me heshtjen e ngjyrës.

Në shumë poezi lulëkuqja lidhet edhe me gjakun dhe me kujtesën e plagëve. Kështu fusha duket sikur mban mbi shpinë historinë e saj të kuqe. Lulëkuqet në këtë poezi nuk janë vetëm lule pranvere; ato duken si kujtime të shpërndara mbi tokë, si shenja të një jete që ka kaluar dhe që vazhdon të mbijetojë në formën e ngjyrës.

3. Ndodh që lodhja e shpirtit bëhet aq e madhe sa shuhet edhe dashuria edhe urrejtja. Kjo shfaqet në mes të poezisë si një mendim i thellë ekzistencial:
*"E kanë të pamundur edhe urrejtjen edhe zemërimin
 Nuk mund të piqen më as për luftë as për dashuri."*
 Këtu ndodh një kthesë e fortë kuptimore. Zakonisht urrejtja dhe dashuria janë dy ndjenjat më të fuqishme njerëzore. Por këto dy hapësira janë aq të lodhura sa nuk mund të mbajnë më as njëri dhe as tjetrin. Kjo është një gjendje e rrallë shpirtërore: jo mungesa e ndjenjave, por shuarja e tyre nga lodhja e gjatë e jetës. Është momenti kur pas një përplasjeje të gjatë njeriu nuk ka më fuqi as të urrejë dhe as të dashurojë. Në këtë pikë

Poezia "Një liqen dhe një fushë" e Natasha Lakos

NË VIJËN E BRISHTË TË RËRËS

Nga Timo Mërkuri

poezia prek një të vërtetë të thellë njerëzore: pas betejeve të mëdha të jetës vjen një çast kur shpirti nuk kërkon më fitore, por vetëm qetësi.

Kështu peizazhi i Lakos bëhet një metaforë e një gjendjeje të thellë njerëzore, ku historia e brendshme e qenies shuhet në një lodhje të qetë.

4. Në vijim heshtja e përjetshme bëhet mënyra e vetme e komunikimit mes dy botëve.

Kjo shfaqet te imazhi i qetë i peizazhit:
*"Të shtrirë përballë në një përgjim të përjetshëm
 një liqen dhe një fushë."*

Fjala "përgjim" është shumë domethënëse. Ajo nuk është thjesht vëzhgim; ajo mbart një tension të fshehtë. Është sikur këto dy hapësira përgjojnë njëra-tjetrën në heshtje, sikur dy qenie që presin një lëvizje të vogël, një shenjë të padukshme. Në këtë përgjimje të përjetshme ka diçka nga pritja e një kohe që nuk vjen më, si dy roje që të heshtur qëndrojnë përballë njëri-tjetrit në kufirin e kujtesës. Ata nuk mund të largohen, por as të bashkohen. Prandaj mbeten në një gjendje të ndërmjetme, në një heshtje që zgjat pa fund. Pikërisht kjo heshtje bëhet një formë e çuditshme komunikimi: një komunikim pa fjalë, ku prania e tjetrit është e mjaftueshme për të mbajtur gjallë kujtesën.

5. Një vijë e brishtë rëre mban në ekuilibër ndarjen dhe afërsinë, në fund, kur poezia përqendrohet në një figurë të vetme: *"Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan."* Kjo vijë rëre është një kufi shumë i brishtë. Nuk është mur, nuk është shkëmb. Është diçka që mund të prishet nga era ose nga një valë e vogël. Megjithatë, pikërisht kjo vijë e thjeshtë mban në ekuilibër dy botë të tëra. Ajo është njëkohësisht lidhje dhe ndarje.

Në këtë mënyrë poezia flet për atë kufi të hollë që shpesh ekziston mes njerëzve: mes dashurisë dhe largësisë, mes kujtesës dhe harrësës. Është ai kufi i padukshëm që i mban njerëzit pranë njëri-tjetrit edhe kur nuk mund të bashkohen plotësisht.

6. Figura tronditëse që e shndërron peizazhin në një dramë njerëzore shfaqet me vargun: *"Si dy koka të bëra copë e çikë."*

Befas peizazhi merr një dimension tragjik. Liqeni dhe fusha nuk janë më vetëm hapësira të natyrës, ata duken si dy qenie të plagosura rëndë. Ky krahasim i fundit e çon gjithë poezinë drejt një kuptimi shumë më të thellë: peizazhi ka qenë gjatë gjithë kohës një figurë e një drame njerëzore.

Dy botë që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës, të lodhura nga historia e tyre, të lidhura vetëm nga një vijë e brishtë. Dhe pikërisht në këtë çast lexuesi e ndien peshën e plotë të vargjeve: *"Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan/Si dy koka të bëra copë e çikë."* Në këtë mbyllje poezia mbetet si peizazh i thyer, ku natyra dhe njeriu bashkohen në të njëjtën plagë të heshtur. Ky lexim i figurave të

poezisë na çon natyrshëm drejt një këndvështrimi tjetër interpretimi, që e ndriçon më thellë marrëdhënien mes natyrës dhe shpirtit njerëzor në këtë krijim.


II- Realizmi magjik i peizazhit në poezinë e Natasha Lakos

Nëse leximit që i keni bërë poezisë i shtojmë edhe këndvështrimin e realizmit magjik, atëherë krijimi i Natasha Lakos hap një shtresë tjetër të heshtur kuptimi. Kjo shtresë nuk e prish realitetin e peizazhit; përkundrazi, e thellon atë. Është sikur në sipërfaqen e dukshme të natyrës të rrahë një zemër e padukshme e botës, që poezia e Lakos di ta dëgjojë. Magjika nuk vjen si një mrekulli e jashtëzakonshme, por si një dridhje e padukshme e realitetit, si një çast kur natyra dhe shpirti njerëzor ndërrojnë vendet dhe bëhen një.

Kemi thënë se në letërsinë shqipe, realizmi magjik nuk ka lindur si një imitimi i botës latino-amerikane. Ai ka një burim shumë më të hershëm dhe më të afërt me kujtesën tonë kulturore: mitet, legendat, përrallat dhe këngët autoktone. Ndër të tjera, në këto rrëfime të vjetra, natyra nuk është vetëm sfond i jetës njerëzore; ajo është një qenie që merr pjesë në të. Mali dëgjon, lumi flet, toka ruan kujtesë. Në këtë botë të lashtë imagjinare njeriu nuk jeton përballë natyrës, por brenda saj, si një mendim i vogël në ndërgjegjen e madhe të tokës. Në shumë rite të vjetra popullore, nënat që shkojnë te varret e bijve u drejtohen tokës sikur ajo të ishte një qenie e gjallë. Ato i luten tokës ta mbajë mirë djalin, ta ruajë dhe ta mbulojë me butësi. Në këtë mënyrë toka shihet si një nënë e madhe e heshtur, që mban në gjirin e saj jetën dhe vdekjen. Po kështu edhe uji në imagjinatën popullore shqiptare flet me gjëmimin e valëve, shikon dhe dëgjon. Në shumë këngë e legjenda, uji bëhet dëshmitar i historive njerëzore; jo rrallë dhe një shkak për gjëmash, të cilat nënat gjithashtu u luteshin: "O lumë të keqen-o/Nxirma djalin bregut-o/Se e kam të vetëm-o"

Kur e lexojmë poezinë e Natasha Lakos në këtë dritë kulturore, disa nga figurat e saj bëhen edhe më të qarta. Realizmi magjik që ndiejmë në vargjet e saj nuk është një zbulim stilistik; ai duket si një jehonë e kësaj mënyre të lashtë shqiptare të të parëit të natyrës.

1. Një nga shenjat më të qarta të realizmit magjik në këtë poezi është mënyra se si natyra sillet si një qenie njerëzore. Liqeni dhe fusha nuk shfaqen thjesht si elemente të peizazhit; ato marrin tipare të shpirtit njerëzor. Kjo shfaqet menjëherë në vargjet hyrëse: *"Përballë njeri tjetrit qëndrojnë/Të lodhur, të kapitur, kokëulur."* Këtu ndodh një transformim i qetë poetik. Realiteti është krejt i zakonshëm: një liqen dhe një fushë përballë njëra-tjetrës. Por mbi këtë realitet bie një dritë tjetër kuptimi: ato janë "të



lodhur, të kapitur, kokëulur", si dy njerëz pas një përplasjeje të gjatë.

Pikërisht këtu lind realizmi magjik: peizazhi real (liqeni dhe fusha) ndërthuret me gjendjen shpirtërore njerëzore (lodhja, përrulla, kapitja). Kjo është edhe aftësia poetike e Lakos: ajo nuk e shpjegon këtë shndërrim, por e bën të duket krejt të natyrshëm. Natyra mbetet natyrë, por njëkohësisht bëhet edhe një pasqyrë e shpirtit njerëzor. Në këtë pasqyrë të qetë, njeriu sheh jo vetëm botën, por edhe plagët e heshtura të vetes.

2. Një tjetër moment ku realia dhe magjika ndërthuren është në vargjet: *"Një liqen që gufon valët mbi shpinë/Dhe një fushë që gufon në shpinë lulëkuqet."* Folia "gufon" krijon ndjesinë e një energjie të brendshme që shpërthen nga natyra. Në planin real kemi valët e liqenit dhe lulëkuqet e fushës. Por mënyra si paraqiten i jep pamjes një dimension tjetër. Liqeni duket si një trup i gjallë që mban mbi shpinë valët. Fusha duket si një trup i gjallë që lind lulëkuqe mbi shpinë. Këtu ndërthuren dy plane: a. realia - valët e liqenit dhe lulëkuqet e fushës. b. magjika - ideja se natyra ka një trup dhe një puls të brendshëm. Edhe këtu ndihet tradita e imagjinatës shqiptare ku toka lind dhe mban jetën mbi vete. Aftësia e Lakos qëndron në atë se ajo e shndërron një pamje krejt të zakonshme të natyrës në një gjest të gjallë të botës.

3. Një nga momentet më të bukura të kësaj poezie është vargu: *"Të shtrirë përballë në një përgjim të përjetshëm/një liqen dhe një fushë."* Këtu ndodh një tjetër ndërthurje shumë e bukur mes reales dhe magjikes: a. realia - liqeni dhe fusha që qëndrojnë përballë. b. magjika - ideja se ata (liqeni dhe fusha) janë në "përgjim të përjetshëm".

Fjala "përgjim" i jep natyrës vetëdije dhe dëgjim. Kjo lidhet edhe me besimin e vjetër kulturor shqiptar se toka dhe uji dëgjojnë dhe mbajnë mend (kujtesë). Në këtë kuptim liqeni dhe fusha duken si dy qenie që dëgjojnë njëra-tjetrën dhe dëgjojnë botën.

Kjo është një nga aftësitë më të holla poetike të Lakos: ajo e bën heshtjen e peizazhit të duket si mendim.

4. Figura më e qartë e realia dhe magjika takohen është në fund të poezisë: *"Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan."* Në planin real kjo është kufiri i rërës mes ujit dhe tokës, por në planin poetik kjo vijë bëhet një kufi simbolik mes dy botëve. Pra kemi:

a. realia - vijë rëre mes liqenit dhe fushës. b. magjika - ideja se ajo bashkon dhe ndan dy botë njëkohësisht. Kjo është një figurë shumë e fuqishme poetike. Një element i vogël i natyrës bëhet një ekuilibër i brishtë mes dy ekzistencave. Edhe këtu shfaqet mjeshtëria e Lakos: ajo krijon një metaforë të madhe me një figurë shumë të vogël.

5. Në vargun e fundit ndodh transformimi më i fortë: *"Si dy koka të bëra copë e çikë."* Në këtë çast ndodh shndërrimi përfundimtar: a. realia - liqeni dhe fusha përballë njëra-tjetrës, b. magjika - ato shndërrohen në dy koka të plagosura. Këtu është kulmi i realizmit magjik: peizazhi nuk është vetëm natyrë, ai shndërron në dramë njerëzore.

Kjo është një nga aftësitë më të mëdha të Lakos: ajo e çon peizazhin nga pamja natyrore drejt tragjedisë njerëzore, pa e prishur natyrshmërinë e figurës.

Realizmi magjik në këtë poezi nuk është një element fantastik që prish realitetin. Ai lind nga një mënyrë shumë e lashtë e të parit të botës, e pranishme në mitet, legendat dhe këngët shqiptare, ku natyra është një qenie e gjallë që ndien dhe dëgjon. Prandaj liqeni dhe fusha mund të qëndrojnë përballë si dy shpirta të lodhur. Dhe në fund mbeten të lidhur nga një kufi i brishtë që është njëkohësisht afërsi dhe ndarje: *"Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan/Si dy koka të bëra copë e çikë."* Në këtë vijë të hollë rëre qëndron edhe magjia e gjithë poezisë: vendi ku realiteti i peizazhit dhe imagjinata e thellë njerëzore bashkohen në heshtje. Është një vijë e brishtë ku toka dhe shpirti prekin njëri-tjetrin për një çast dhe ku poezia fillon të marrë frymë. Dhe pikërisht në këtë kufi të brishtë mes tokës dhe shpirtit lind ajo dridhje e padukshme që e quajmë poezi.

III-Përveç leximeve që lidhen me peizazhin simbolik, me lodhjen ekzistencial dhe me figurën e kufirit apo realizmin magjik, kjo poezi e Natasha Lako lejon edhe disa shtigje të tjera meditimi. Ajo është nga ato krijime që nuk mbarojnë me një interpretim të vetëm. Sa herë që lexuesi kthehet tek vargjet e saj, duket sikur hapet një dritare tjetër



kuptimi. Peizazhi mbetet i njëjtë, por mendimi që kalon mbi të ndryshon si drita mbi sipërfaqen e ujit.

1. Një nga tiparet më të veçanta të kësaj poezie është mënyra se si ajo ndërtohet mbi heshtjen. Në të nuk ka dialog, nuk ka veprim, nuk ka rëfim të drejtpërdrejtë. Gjithçka qëndron në një qetësi të dendur, si ajri i një pasditeje të gjatë vere kur edhe natyra duket sikur ndalet për të dëgjuar veten. Përballë njëri-tjetrit qëndrojnë liqeni dhe fusha, dy prani që nuk flasin, por që duket sikur e ndiejnë njëra-tjetrën. Kur poetja shkruan: "Të shtrirë përballë në një përgjim të përjetshëm/një liqen dhe një fushë." ajo krijon ndjesinë se komunikimi nuk ndodh me fjalë, por me prani. Është një heshtje që dridhet si ajri para një stuhie të madhe, ku çdo gjë duket se pret diçka të paemëruar. Dy botë dëgjojnë njëra-tjetrën në heshtje, sikur mes tyre kalon një kujtesë e gjatë, një histori që nuk ka më zë, por që ende mbart jehonën e saj. Heshtja këtu nuk është boshllëk; ajo bëhet një gjuhë e padukshme, një mënyrë tjetër e të folurit të shpirtit.

2. Në të njëjtën kohë poezia krijon edhe ndjesinë e një ekuilibri shumë të brishtë mes këtyre dy hapësirave. Liqeni dhe fusha nuk janë në konflikt të hapur, por as në një harmoni të plotë. Ata qëndrojnë në një gjendje të ndërmjetme, si dy qenie që ruajnë një distancë të vogël mes tyre. Kjo ndjesi shprehet me një figurë shumë të thjeshtë dhe njëkohësisht shumë domethënëse: "Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan." Si një fije dritë që shtrihet mbi errësirën e natës, kjo vijë mban dy botë në një tension të heshtur. Kjo vijë rëre duket e vogël dhe e brishtë. Një erë e lehtë mund ta shpërndajë, një valë mund ta zhdukë. Megjithatë pikërisht ajo mban në ekuilibër dy hapësira të mëdha. Në këtë figurë poetja krijon një simbol të fuqishëm: edhe në jetën njerëzore marrëdhëniet shpesh mbahen nga kufij shumë të hollë. Një vijë e vogël mund të jetë njëkohësisht urë bashkimi dhe humerë ndarjeje.

3. Në këtë poezi nuk paraqitet një ngjarje konkrete. Nuk dimë çfarë ka ndodhur më parë, por lexuesi e ndien qartë se diçka ka ndodhur. Kjo ndjesi vjen nga vargjet: "E kanë të pamundur edhe urrejtjen edhe zemërimin/Nuk mund të piqen më as për luftë as për dashuri." Këto vargje japin ndjesinë e një lodhjeje të thellë. Është sikur përplasjet e mëdha kanë kaluar tashmë dhe në vend të tyre ka mbetur vetëm një qetësi e rëndë. Peizazhi i ngjan një toke pas stuhisë, kur retë janë larguar, por në ajër ende ndjehet lagështia e trazimit. Poetja nuk tregon historinë e kësaj përplasjeje; ajo na jep vetëm gjendjen që mbetet pas saj. Kjo mënyrë e të shprehur është një nga teknikat më moderne të poezisë: ngjarja zhduket, ndërsa mbetet atmosfera e saj.

4. Në fund të poezisë shfaqet një figurë që e trondit qetësinë e mëparshme dhe e ndryshon mënyrën si e lexojmë gjithë tekstin: "Si dy koka të bëra copë e çikë."

Ky krahasim e mbush menjëherë peizazhin me një ngarkesë dramatike. Liqeni dhe fusha nuk duken më vetëm si hapësira natyrore, por si dy qenie të plagosura rëndë. Është sikur gjithë qetësia e mëparshme mbante brenda një plagë të fshehur. Me këtë figurë përfundimtare poezia merr një dimension tragjik dhe filozofik, ku peizazhi bëhet metaforë e një ndarjeje të thellë njerëzore.

5. Një tjetër aspekt që bie në sy është përqendrimi i madh poetik i këtij krijimi. Poezia është e shkurtër, por çdo varg mban një peshë të madhe kuptimore. Nuk ka asnjë fjalë të tepërt dhe asnjë figurë të rastësishme. Çdo imazh duket i vendosur me kujdes, si një gur në një hark që mban gjithë strukturën e tij. Kjo është një nga cilësitë më të bukura të poezisë së Natasha Lakos: aftësia për të krijuar një hapësirë të gjerë mendimi me shumë pak fjalë.

Në fund mund të themi se kjo poezi mund të lexohet në shumë mënyra: si një peizazh, si një metaforë e marrëdhënieve njerëzore, si një refleksion mbi lodhjen e historisë, ose si një meditim mbi kufijtë e brishtë që ndajnë dhe bashkojnë botët. Gjithçka përmbledhet në atë vijë të hollë rëre që poetja vendos mes dy hapësirave: "Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan/Si dy koka të bëra copë e çikë." Dhe pikërisht mbi këtë vijë të brishtë qëndron i gjithë tensioni poetik i kësaj poezie, si një fije e hollë që lidh heshtjen e natyrës me plagët e padukshme të shpirtit njerëzor.

IV - Nëse deri tani kemi parë poezinë kryesisht në planin e kuptimit simbolik e filozofik, ajo mund të kuptohet edhe si një kontribut i veçantë në poetikën moderne shqiptare. Natasha Lako e sjell këtë risie jo përmes një deklarimi të zhurshëm, por përmes një heshtjeje që fluturon mbi çdo varg, ku peizazhi, gjuha dhe mendimi filozofik bashkohen në një strukturë të përqendruar dhe të ndjeshme, që flet për shpirtin njerëzor më shumë se për ngjarjet.

1. Në poezinë tradicionale shqiptare, peizazhi shpesh shërbeu si dekor ose skenë për ndjenjat e personazheve. Te kjo poezi ndodh diçka më e thellë: peizazhi vetë bëhet personazh. Liqeni dhe fusha nuk janë thjesht hapësira; ata frymojnë, ndjejnë dhe mbajnë mbi shpinë lodhjen e botës dhe të historisë së saj. "Të lodhur, të kapitur, kokëulur," shkruan poetja, duke i dhënë natyrës një shpirt

njerëzor, që dridhet nën peshën e kohës dhe e bën metaforë të fatit dhe vuajtjes së njeriut. Kjo është një nga risitë më të dukshme të poezisë moderne shqiptare, ku simboli dhe përqendrimi marrin vendin e rrëfimit të drejtpërdrejtë.

2. Poezia nuk përdor figura të shumta apo komplikua; ajo ndërtohet mbi dy elemente të zakonshëm të natyrës: *liqenin dhe fushën*. Por nga kjo thjeshtësi lind një botë e tërë. *Valët dhe lulëkuqet* nuk janë vetëm pamje; ato flasin një gjuhë të heshtur mes ujit dhe tokës, mes lëvizjes dhe qëndrueshmërisë, mes trazimit dhe kujtesës. Peizazhi bëhet dialog, ku uji shpërfaq trazimin e brendshëm si një shpërthim i heshtur, ndërsa lulëkuqet mbajnë historinë në heshtje, si kujtime të shpërndara mbi tokë. Kjo thjeshtësi e fuqishme krijon intensitet dhe bukuri poetike me mjete minimale.

3. Një nga risitë më të ndjeshme është shfaqja e lodhjes që shuan ndjenjat e mëdha. "E kanë të pamundur edhe urrejtjen edhe zemërimin / Nuk mund të piqen më as për luftë as për dashuri." Në këtë heshtje të rëndë, peizazhi duket si një trup që është ulur për të marrë frymë pas një beteje të gjatë, duke lënë gjithçka pas. Ky varg nuk është thjesht një përshkrim; ai zbulon një gjendje që rrallë shfaqet kaq qartë në poezinë shqipe- momentin kur përplasjet e mëdha janë konsumuar dhe mbetet vetëm një heshtje e rëndë, një lodhje që ka përmasat e jetës dhe kohës. Ky është një dimension filozofik që shpalosë një të vërtetë universale: pas stuhive të mëdha, shpirtit i mbetet vetëm qetësia dhe reflektimi.

4. Në fund të poezisë shfaqet figura e vijës së rërës, e cila është njëkohësisht lidhje dhe ndarje: "Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan." Kjo vijë e hollë është simboli i kufirit të brishtë që ndan botët dhe i mban ato pranë njëri-tjetrit; është kufi mes hapësirave, mes njerëzve, mes kujtesës dhe pranverës. Duket sikur era e parë e pranverës do ta shkundë atë, por ajo qëndron, si një kujtesë e brishtë që nuk mund të harrohet. Ajo shfaqet si një urë e hollë mbi heshtjen e peizazhit, që bashkon dhe ndahet në të njëjtën kohë, duke krijuar një tension të brendshëm të lexuesit dhe një meditim të heshtur mbi jetën dhe marrëdhëniet njerëzore.

5. Krahasimi përmblyllës: "Si dy koka të bëra copë e çikë" sjell një tronditje poetike të papritur. Lexuesi e ndjen këtë dhimbje si të ishte e tij, një plagë që ndan dhe bashkon, një heshtje që fluturon mbi çdo varg. Peizazhi që dukej i qetë, papritmas shndërrohet në një dramë të heshtur, ku natyra dhe njeriu bashkohen në të njëjtën plagë të përbashkët. Kjo figurë i jep poezisë një energji të brendshme të veçantë dhe e shndërron leximin në një përjetim të thellë. Lexuesi e ndjen këtë dhimbje si të ishte e tij, një plagë që ndan dhe bashkon, një heshtje që fluturon mbi çdo varg.

Risia e kësaj poezie nuk qëndron tek temat e reja, por tek mënyra e ndërtimit të figurës poetike: me pak vargje dhe gjuhë të përmbajtur, Natasha Lako krijon një metaforë të gjerë për ndarjen, lodhjen dhe bashkëjetesën e detyruar të botëve. Prandaj, figura e saj mbetet gjatë në mendjen e lexuesit, si një vijë e hollë rëre që i bashkon dhe i ndan: "Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan / Si dy koka të bëra copë e çikë."

Pra, poezia e Natasha Lakos nuk është thjesht një peizazh që lexuesi e sheh me sy; ajo është një peizazh që ndjehet me shpirt. Liqeni dhe fusha nuk janë thjesht hapësira natyrore, por dy qenie që mbajnë mbi supë historinë e tyre të heshtur, lodhjen e jetës dhe plagët që nuk shërohen lehtë. Heshtja, vijat e hollë të rërës, valët dhe lulëkuqet - të gjitha bëhen gjuhë për të thënë atë që nuk mund të thuhet me fjalë. Lexuesi nuk mbaron së lexuari vargjet; ai hyn në një përjetim, ku çdo frymëmarrje e natyrës lidhet me frymëmarrjen e tij, ku çdo plagë e peizazhit pasqyron një plagë të shpirtit njerëzor. Dhe pikërisht në këtë ndërthurje të brishtë mes natyrës dhe njeriut qëndron fuqia e poezisë: ajo na mëson se qetësia e dukshme nuk është gjithmonë pa dhimbje, dhe se çdo hapësirë qëndron e ndarë dhe e lidhur njëkohësisht, si dy koka të bëra copë e çikë, por të pandashme në kujtesën e heshtur të shpirtit.

Sarandë, mars 2026

Një liqen dhe një fushë

Përballë njëri-tjetrit qëndrojnë
Të lodhur, të kapitur, kokëulur
Një liqen që gufon valët mbi shpinë
Dhe një fushë që gufon në shpinë lulëkuqet.

E kanë të pamundur edhe urrejtjen edhe zemërimin
Nuk mund të piqen më as për luftë as për dashuri
Të shtrirë përballë në një përgjim të përjetshëm
një liqen dhe një fushë.

Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndan

Si dy koka të bëra copë e çikë.

Botim i ri nga Trishtil

KNUT HAMSUN Viktoria

Portretizimi poetik dhe psikologjikisht i thellë i gjendjes së vështirë të dashurisë në një shoqëri të ndarë prej klasave.

E vendosur në një fshat bregdetar të Norvegjisë së fund- shekullit të nëntëmbëdhjetë, romani "Viktoria" rrëfen për dy të dashuruar, dëshirat e të cilëve janë po aq të fuqishme sa edhe rrethanat që e pengojnë romancën e tyre. Johanesi, i biri i një mullixhiu që bëhet poet, gjen frymëzim për krijimet e tij te përkushtimi i zjarrit ndaj Viktorias, vajzës së zotërisë së rënë nga vakti të Kështjellës, e cila ndihet e detyruar të fejohej me të riun e pasur që i ati ka zgjedhur. Të ndarë nga barrierat klasore dhe trysnia shoqërore, kjo dyshe e dënuar nga fati, herë e lëndon, herë e magjeps njëri-tjetrin, ndërsa të dy lëvizin drejt një tragjedie që asnjëri nuk do ta kuptojë derisa të jetë tepër vonë.

Prestigji global që Çmimi Nobel i solli emrit të tij më mbushi me kënaqësi të vërtetë personale; sipas mendimit tim, askush nuk e meritonte kaq shumë këtë çmim.

Thomas Mann

Talenti i Knut Hamsun-it është magjepsës; fjalitë e tij rrezatojnë dhe ai për çfarëdo që të shkruante, e bënte të gjallë.

Karl Ove Knausgaard,


The New York Times Book Review

Knut Hamsun

Viktoria

Një histori dashurie

NOBEL
1920



Natyra shqiptare, me egërsinë e saj sublime dhe brishtësinë magjepsëse, do të mbetet një dëshmi e pazëshme, pothuajse e paeksploruar në përmasën e saj hyjnore, nëse nuk do të përthyeret përmes thjerrës së perceptimit shpirtëror të piktorit impresionist, Pashk Përvathi. Ajo që rrok syri dhe përpin adhurimi nuk është thjesht një hapësirë gjeografike, por një gjendje shpirti që pret të pagëzohet në telajo, nën shpimin e butë të penelatave dhe lëdhatinë e dritës.

Gjini të ndryshme të artit, me të njëjtën etje zbuluesish, janë përkulur para kësaj bukurie, duke e stolitur me adhurim dhe duke e burgosur "egërsinë" e saj në butësinë e penelit. Është një përpjekje titanike për ta përjetësuar natyrën në një ndalim kohe, siç bën Përvathi, aty ku rrahja e zemrës sinkronizohet me fëshfërimën e gjetheve dhe ku hapi i udhëtarit nuk rend më drejt destinacionit, por drejt përjetësisë, skajeve të tejme ku mund të mos mbërrij syri, por arrin të ndjej shpirtërorja.

Mjeshtri në kurthi e mrekullimit

Në këtë "kurth" magjik të mrekullimit ka rënë piktori Pashk Përvathi, i cili nuk mjaftohet me pasqyrimin e asaj që sheh syri, por kërkon atë që rrok instinkti, asaj që përbën përjetimin në çdo nivel të tij perceptues. Pashk Përvathi është një arkeolog i dritës, gërmon nën sipërfaqen e ngjyrës për të gjetur shkëlqimin e brendshëm të tokës sonë, njëjtë si koha dhe stina që ndërtojnë parmendën në thellësi për të zgjuar thirrjet e bresave që prehen nën këtë truall betejash të shpirtit.

Për Përvathin, peizazhi nuk është dekor, por një monument i gjallë. Ai e ka marrë hirin e kësaj natyre të bekuar dhe e ka ngjitur në altarin e veprës së tij me një përkushtim pothuajse klerikal.

Te vepra e tij, impasti i rëndë dhe dridhja impresioniste krijojnë një teksturë, ku drita duket se ka peshë dhe ajri ka aromë. Çdo tablo është një "trokitje" mbi portën e të bukurës universale që deh vështrimin duke u derdhur brenda nesh si një zgjim në një magjepsje përjetimi.

Përvathi shkon atje ku qielli takon tokën

Vepra e tij qëndron lart, në atë lartësi ku kufiri mes tokës dhe qiellit fshihet nga mjegulla e artë e agimeve. Aty, ku ngjiten altaret dhe dëgohen kambanat e qiellit, Përvathi ka ndërtuar një strehë për shpirtin shqiptar dhe ka shkruar një dhjatë për predikimin e asaj që për të është besim. Peneli i tij nuk pikturon thjesht pemë apo lumenj, male që futin kokën në re dhe maja që zbardhëdhijnë dimër-verë, det që valëzon si vello nuseje dhe panoramë që u mëkon hir largësive, por shkruan "këngën" që ata lëshojnë nën dritën e diellit tonë dritës.

Në këtë rrugëtim, ai mbetet jo vetëm një piktor, por një gardian i kujtesës estetike, duke na kujtuar se natyra është katedralja jonë e parë dhe vepra e tij, shënjimi që na lidh me të vërtetën e kësaj toke.

Arkitekt i dritës së ngjyrshme

Pashk Përvathi nuk është thjesht një piktor i peizazhit, ai shfaqet si arkitekt i dritës dhe një dëshmitar i shpirtit të tokës shqiptare. Peneli i tij nuk mjaftohet me pasqyrimin e një pamjeje, por kërkon me nxjerrë në pah "frymëmarrjen" e natyrës, ti japë zë një kodre e një mali, një lumi apo një shtëpi të vjetër, që duket sikur është shkruar me dheun dhe me kohën, me hapësirën dhe mahnitjen.

Në universin e tij piktorik, drita nuk është thjesht element ndriçues, por substancë që ndërton formën dhe emocionin. Ajo

Pashk Përvathi, poeti i peizazhit, virtuoz i ngjyrave të thella dhe dritës së vezullim të natyrës

Nga Albert Vataj

rrëshqet mbi sipërfaqe, depërton në thellësi dhe shndërrohet në gjuhë, në rrëfim të heshtun që flet për ciklet e natyrës dhe për përjetësinë e çasteve të vogla. Ngjyrat, të përzgjedhura me një ndjeshmëri të hollë, nuk përplasen, por bashkëjetojnë në harmoni, si një orkestër e qetë ku çdo ton gjen vendin e vet në një ekuilibër të menduem.

Peizazhet e tij nuk janë kurrë "zhurmuese", ato ftojnë në meditim, duke u bërë pasqyrim i një qetësie të thellë shpirtore. Janë hapësira ku koha duket sikur ka ndaluar, ku e tashmja dhe e kaluara treten në njëra-tjetrën, duke krijuar atë ndjesinë e kthimit, jo thjesht në një vend, por në një gjendje të brendshme, në një përjetim që pluskon në ngjyrje shpirti. Në to, shikuesi nuk është spektator, por pjesëmarrës në një përjetim që shtrihet mes kujtesës dhe ëndrrës.

Në këtë kuptim, arti i Përvathit është një formë e përkorë e kontemplimit. Ai nuk kërkon spektaklin, por thelbin, nuk ndërton për të impresionuar, por për të depërtuar butësisht në vetëdijen e atij që e sodit. Çdo tablo është një ftesë për të ndaluar hapin, për të dëgjuar heshtjen dhe për të kuptuar se bukuria shpesh qëndron në atë që nuk


thirret, por vetëm ndihet, thellësisht, thelbësisht.

Kështu, Pashk Përvathi mbetet një prej atyne zërave të rrallë të piktorës shqiptare që nuk e kërkojnë vëmendjen me forcë, por e fitojnë atë përmes një autenticiteti të qetë dhe një besnikërie të palëkundur ndaj natyrës dhe dritës, dy elemente që në duart e tij shndërrohen në poezi vizuale.

Poeti i dritës dhe magjisë së peizazhit

Nëse arti do të kishte një stinë të përjetshme, ajo do të ishte stina e Pashk Përvathi. Profili i tij krijues përfaqëson një përqendrim të rrallë të harmonisë mes akordit të ngjyrave dhe ndjeshmërisë lirike, ku çdo goditje peneli funksionon si një njësi ritmike në ndërtimin e një simfonie vizuale, është një varg dhe një metaforë, është një drithërimë shpirti që shndërrohet në shpërthim drite në bredësi të ndijimit.

Tek ai, peizazhi nuk është thjesht një gjini, por një sistem shprehës, ku drita organizon hapësirën dhe ngjyra artikulon emocionin. Çdo element piktorik është i reduktuar në thelb, pa teprime, duke i dhënë veprës një pastërti strukturore



dhe një qartësi ndijimore që komunikon drejtpërdrejt me shikuesin.

Në këtë përmasë të përkorë dhe të menduar, Pashk Përvathi shfaqet si një poet i dritës, ku magjia e peizazhit nuk qëndron në spektakël, por në aftësinë për të krijuar një gjendje, të qetë, të thellë dhe të qëndrueshme në kujtesë.

Estetika e dritës dhe atmosferës

Pashk Përvathi e trajton dritën jo si një faktor të jashtëm që ndriçon objektet, por si një substancë imanente që strukturon vetë pikturën, shtresëzim i ngjyrave dhe i gjëndjeve. Ajo nuk bie mbi formën, ajo lind prej saj, duke u bërë njëkohësisht burim dhe përmbajtje e përjetimit vizual.

Ai zotëron një ndjeshmëri të rafinuar për çastet kalimtare, për ato intervale të brishta ku drita transformon realitetin, arin e perëndimit që përkëdhel relievin, mjegullën e mëngjesit që zbut kufijtë e formave, apo transparencën e ajrit që e bën hapësirën të pulsojë. Këto nuk janë thjesht efekte atmosferike, por gjendje të artikuluara me një saktësi pothuajse meditative.

Në tablotë e tij, atmosfera nuk është sfond, por prani aktive. Ajri fiton densitet, freski dhe jetë, duke krijuar një ndjesi përfshirjeje ku shikuesi nuk e sodit thjesht peizazhin, por e përjeton atë si një realitet të brendshëm, të depërtueshëm dhe të gjallë.

Penelata dhe tekstura e "shpirtit impresionist"


Në gjuhën piktorike të Pashk Përvathi, penelata nuk është thjesht mjet ndërtimi, por akt shprehës që mbart ritmin e përjetimit. Stili i tij anon drejt një impresionizmi të përditësuar dhe të kudogjendur, ku forma nuk ngurtësohet në konture të prerë, por shpërndahet dhe ribashkohet me mjedisin përmes një lëvizjeje të lirë, të gjallë dhe të vetëdijshme, ku soditja shtanget dhe ngjyrat na tavolet jepen si një joshjeje.

Kjo liri nuk është spontane në kuptimin e rastësisë, por e disiplinuar nga një sens i mprehtë harmonie. Paleta e tij, e pasur dhe e nuancuar, ndërton marrëdhënie delikate mes të gjelbrave të thella, të kaltërave të tejdukshme dhe toneve tokësore, ku çdo ngjyrë nuk qëndron më vete, por hyn në dialog me tjetrën, duke krijuar një unitet organik të sipërfaqes.

Tekstura, ndërkohë, fiton një dimension taktit. Ajo nuk është vetëm për t'u parë, por për t'u ndier me sy: relievit i penelit sugjeron ashpërsinë e gurit, lagështinë e dheut, butësinë e gjetes. Kështu, piktura e Pashk Përvathi kapërcen kufirin e imazhit dhe bëhet një përvojë ndijore e plotë, ku "shpirti impresionist" nuk është stil, por gjendje që pulson në çdo fragment të sipërfaqes.

Profili i piktorit, dashnor i etnos dhe peizazhit

Pashk Përvathi shfaqet si një piktor që





e ka përshkuar Shqipërinë me kavalet në krah, duke e përkthyer peizazhin në një gjuhë identitare. Për të, natyra nuk është thjesht një objekt estetik, por një strukturë ku ndërthuren memoria, karakteri dhe fryma e vendit, si një kushtrim i brendshëm që dëgjohet nga thellësia.

Ai nuk pikturon “bukurinë” në kuptimin sipërfaqësor, por thelbin e saj, atë që e bën një hapësirë të njohshme dhe të papërsëritshme. Në këtë sens, ai duket se njih jo vetëm anatominë e pemës, por edhe psikologjinë e reve; jo vetëm formën, por edhe gjendjen që ajo mbart.

Kompozimet e tij mbështeten në një ekuilibër organik, ku çdo element gjen vendin e vet në një rend natyror dhe të paimponuar. Syri i shikuesit nuk drejtohet me forcë, por ftohet të lëvizë lirshëm brenda hapësirës piktorike, duke gjetur aty një ndalesë të qetë, një mundësi meditimi.

Tek Pashk Pervathi, horizonti nuk është kufi, por një vijë e hapur ku fillon kërkimi. Ai mbetet gjithmonë një ftesë për të parë përtej së dukshmes, për të depërtuar në atë dimension ku peizazhi shndërrohet në përvojë dhe në vetëdije.

Piktura si akt dashurie

Për Pashk Pervathi, akti i pikturimit merr trajtën e një raporti etik me natyrën, pothuajse një lutje e heshtur, ku subjekti nuk pushtohet, por respektohet dhe lartësohet. Ai nuk e imponon vizionin mbi peizazhin,

përkundrazi, i nënshtrohet ritmit dhe frymëmarrjes së tij, duke kërkuar të kapë një të vërtetë që nuk është thjesht optike, por thellësisht emocionale.

Qoftë në ashpërsinë e relievit verior apo në butësinë e hapësirave bregdetare të jugut, ai ruan një besnikëri të qëndrueshme ndaj kësaj të vërtete të brendshme, që nuk kufizohet nga korniza e tablosë. Piktura e tij nuk mbyllet, ajo vijon përtej, si një jehonë që mbetet në ndërgjegjen e shikuesit.

Në këtë kuptim, Pashk Pervathi na mëson një mënyrë të të parit, jo thjesht si akt perceptimi, por si ushtrim mirënjohjeje. Ngjyra, në duart e tij, nuk është vetëm element formal, por bëhet gjuhë shpirtërore, një medium përmes të cilit realiteti përjetohet dhe fisnikërohet.

Në pikturën shqiptare të dekadave të fundit, ai qëndron si një hapësirë e veçantë drite, ku peizazhi nuk është pamje, por përvojë, jo vetëm një fragment i natyrës, por një gjendje që lind nga bashkëjetesa mes syrit që sodit dhe botës që i shfaqet. Në këtë marrëdhënie të rrallë, ai mbetet një figurë e përmbajtur, por e qëndrueshme, një “gardian i dritës” që e ruan dhe e përcjell atë si një trashëgimi të ndjeshme në historinë e artit shqiptar.

Peizazhi si gjendje e përthithur, meditimi i dritës dhe heshtjes

Pervathi nuk e trajton natyrën si objekt për t’u riprodhuar, por si një gjendje për t’u

përthithur. Në tablotë e tij, drita nuk bie, ajo merr frymë. Ajo shpërndahet në sipërfaqe me një butësi që kujton një melodi, ku çdo ngjyrë është një notë e menduar, e matur dhe e vendosur me një vetëdije të lartë estetike. Peizazhet e tij, shpesh të zhveshura nga prania njerëzore, nuk janë bosh, por përkundrazi, të mbushura me një prani të padukshme, një qetësi që flet.

Në këtë kuptim, arti i Pervathit është një akt meditimi. Ai e ndërton hapësirën me një ekonomi të admirueshme formash, duke shmangur çdo teprim dhe duke kërkuar thelbin. Kjo e afron atë me një traditë të pikturës evropiane ku peizazhi është një mënyrë për të reflektuar mbi qenien, më shumë sesa për të dokumentuar një vend. Në disa prej punëve të tij ndihet një jehonë e largët e impresionizmit, jo si ndikim formal, por si një afri shpirtërore me idenë se drita dhe momenti janë thelbi i së dukshmes.

Profili i tij si piktor formësohet pikërisht në këtë tension mes disiplinës dhe ndjeshmërisë. Ai është një kërkues i heshtur i harmonisë, një ndërtesues i hapësirave që nuk imponohen, por që të ftojnë të hysh brenda tyre.

Pashk Pervathi shfaqet si një poet i dritës dhe i heshtjes, një piktor që nuk e përdor penelin për të treguar botën, por për ta dëgjuar atë. Dhe pikërisht në këtë dëgjim të thellë, arti i tij fiton atë dimension të rrallë, të qenit jo vetëm pamje, por përvojë.

E shkuara në sytë e përlotur të së tashmës

Gjithnjë më kanë magjepsur sytë që notojnë në lot, njësoj si brigjet që, përmes shkumëzimeve, përcaktojnë skajet e pafundme të horizontit. Por në sytë e Pashk Pervathit, emocioni nuk mbetet thjesht ndjesi: ai shpërthen, shndërrohet në përjetim dhe merr trajtë në një përpjekje të pandalur për të prekur kufijtë ku drita e shpirtit të tij është mburrur deri në tablo.

Ëndrrat e tij u mëkuan në atë eter të brishtë shpirtëror të Manatit të Lezhës, në atë fshat ku zëri poetik i jetës përzihet me përditshmërinë e njerëzve që e sfidojnë kohën me mund, me shumë mund dhe sakrificë.

Atje nisi rrugëtimi i mjeshtrit, një udhëtim që do ta çonte drejt emrit dhe veprës, drejt vlerësimit dhe vendit që ai zuri, me të drejtë, në traditën e ndritur të pikturës shqiptare. Ai erdhi si një prani e heshtur, por me një akt të pazëvendësueshëm shprehjeje, duke e kthyer gjendjen dhe përjetimin në gjuhë ngjyrash e peneli.

Çdo copëz e së shkuarës ku ai hodhi hapat e parë drejt pushtimit të botës së madhe të artit, çdo kujtim e mall, lexohet me një qartësi gati drithëruese në ata sy që përloten, si një zë i thellë që zhytet në qenien dhe në gjendjet ku ai është mburrur, e ku rikthehet herë pas here për të ruajtur të paprekur Betlehemin e tij shpirtëror.



Letërsia autobiografike që mbështetet në kujtesën personale shpesh shndërrohet në një palimpsest artistik ku ndërthuren përjetimi individual dhe memoria kolektive. Libri “Nëpër gjethe kujtimesh” i Daut Dautit përfaqëson pikërisht një formë të tillë shkrimi, ndërkohë që rrëfimi personal shndërrohet në një panoramë të jetës shoqërore, mitologjike dhe historike të Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit XX. Përmes një narrative të ndërtuar mbi perspektivën e fëmijërisë, të rinisë dhe të përvojës intelektuale në mërgim, autori krijon një univers letrar ku bashkëtojnë realiteti, kujtesa dhe simbolika kulturore.

Struktura e veprës është e ndarë në tri pjesë: *Fëmijëria*, *Tregimet e mëvonshme dhe Tregimet nga Londra*. Ky organizim nuk është thjesht kronologjik, por përfaqëson një zhvillim të teknikës narrative. Në pjesën e parë dominon vështrimi i fëmijës, i cili përmes një gjuhe të thjeshtë dhe plot gjallëri përshkruan jetën e fshatit, ritualet, bestytnitë, frikërat dhe gëzimet e hershme. Në pjesët pasuese rrëfimtari shndërrohet në një vëzhgues më të pjekur, i cili e sheh realitetin me një sy kritik dhe reflektues, sidomos kur përballet me botën perëndimore dhe përvojën e mërgimit.

Një nga elementet më të rëndësishme të librit është dimension i mitologjisë popullore. Në shumë tregime paraqiten zakone, rituale dhe besime që janë pjesë e traditës së fshatit shqiptar. Episodi i larjes së foshnjës në ujë me gjethe shelgu dhe hithë në prag të Shëngjergjit është një shembull i qartë i kësaj trashëgimie simbolike. Kjo skenë nuk është vetëm një kujtim personal, por një pasqyrë e botëkuptimit tradicional, ku natyra dhe ritet shihen si pjesë e harmonisë së jetës njerëzore. Po kështu, vendet si “Pusi i Kallakangjës”, “Kroi i Ftoftë” apo “Vorret e Plakave”, përpos si tope letrare, marrin dimension mitik dhe shndërrohen në hapësira fantazmagorike ku ndërthuren realiteti dhe imagjinata kolektive.

Shkrimtari Daut Dauti, me përvojën e hulumtuesit dhe të publicistit, librin e tij e ndërton sipas teknikës së narracionit imazherik dhe skalitjes së personazheve karakteristike. Ai krijon një galeri figurash që përfaqësojnë tipare të ndryshme të jetës rurale: mullinxhiu që frikësohet nga lepuri, gjuetari Taha që duket si një figurë e epokës parahistorike, aga Nezë që ndërton shkollën me përkushtim të jashtëzakonshëm, Dada Pestile, Timja e trent etj. Këto figura nuk janë vetëm individë konkretë, por edhe arketipe sociale, të cilët simbolizojnë mentalitete dhe mënyra jetese të një epoke të caktuar.

Librin e Daut Dautit duhet lexuar edhe si kronikë e një kohe që s’kthehet më, por që në kujtesën tonë prodhon ndjesinë e prekshmërisë së gjërave. Kjo arrihet në saje të një rrëfimi që ndërtohet mbi kontraste të forta: fshati dhe qyteti, tradita dhe moderniteti, izolimi dhe hapja ndaj botës. Përmes këtyre kontrasteve autori arrin të nxjerrë në pah edhe realitetin politik dhe social të kohës së socializmit në ish-Jugosllavi. Në sfond të tregimeve shfaqet një realitet i pabarazisë dhe i tensioneve historike, ku shqiptarët përjetojnë një margjinalizim politik, ekonomik dhe kulturor. Ky dimension historik shfaqet jo në formë të drejtpërdrejtë, por përmes kujtimeve, tregimeve të pleqve dhe episodeve të jetës së përditshme.

Stilistikisht, proza e Daut Dautit karakterizohet nga një gjuhë e qartë, e pasur me figuracion dhe me elemente të humorit të hollë. Humori shpesh shfaqet në përshkrimet e situatave të thjeshta të jetës së fshatit, duke krijuar një ekuilibër mes nostalgjisë dhe ironisë. Përmes këtij stili autori arrin të krijojë një atmosferë të gjallë narrative, ku lexuesi jo vetëm e ndjek rrëfimin, por edhe e përjeton emocionalisht atë.

Letërsia e kujtesës dhe e përvojës personale shpesh krijon një hapësirë

Letërsia e kujtimeve dhe narrativa e përvojave

Nga Emin Azemi

Arkitektura tekstore e librit “Nëpër gjethe kujtimesh” e ndërtuar nga tri “shtylla” fabulare “Fëmijëria”, “Tregime të mëvonshme” dhe “Tregime nga Londra”, dëshmon se krijimtaria e Daut Dautit përbën një mozaik të gjallë të kujtesës individuale e kolektive, ku ndërthuren autobiografia, mitologjia popullore, kronika shoqërore dhe reflektimi kritik. Nga bota e thjeshtë e fshatit dhe kujtesa e fëmijërisë, te transformimet kulturore e shoqërore të dekadave të fundit dhe deri te përvoja urbane e mërgimit në metropolin londinez, autori arrin të ndërtojë një narrative që e kthen përditshmërinë në dëshmi letrare dhe kulturologjike. Nëpërmjet humorit, ironisë dhe vëzhgimit të hollë të jetës, këto rrëfime shndërrohen në një kronikë të ndjeshme të kohës dhe të identitetit, duke ruajtur gjallërinë e tradicionales dhe duke i dhënë asaj një dimension modern letrar.

të veçantë ku ndërthuren përjetimet personale, historia sociale dhe refleksioni kritik mbi realitetin. Rrëfimet e përmbledhura në ciklin “Tregime të mëvonshme” përfaqësojnë një shembull domethënës të kësaj ndërthurje, duke shpalosur përmes episodit autobiografik një panoramë të botës shqiptare në periudha të ndryshme historike dhe kulturore. Në këto rrëfime, autori ndërton një diskurs narrativ që lëviz mes kujtesës së fëmijërisë, përvojës së mërgimit, ironisë sociale dhe refleksionit kulturor. Në këtë mënyrë, teksti merr një karakter të dyfishtë: here si dokument i përvojës personale dhe here si një formë e kritikës së nënkuptuar ndaj realiteteve historike e shoqërore.


Duke eksploruar botën shpirtërore e morale të njerëzve, autori na sjell një shembull të qartë të mënyrës se si mendësia tradicionale transmetohet përmes figurës së gjyshes (Lokës), e cila vazhdimisht mendon se: “Kjo botë shpejt do të bëhet hashërr-neshërr”. Bota e saj konceptohet në një dualitet të prerë: “Na” dhe “Ata”. Ky model binar i perceptimit të botës është tipik për kulturat tradicionale ku identiteti ndërtohet përmes dallimit dhe ruajtjes së kufijve simbolikë. Shprehja metaforike “hashërr-neshërr”, që nënkupton përzierjen dhe humbjen e dallimeve, përfaqëson një frikë të trashëguar kolektive për zhdukjen e identitetit kulturor. Në këtë kontekst, fjala popullore e Lokës funksionon si një proverb

folklorik që sintetizon një filozofi të tërë jetësore.

Nga ana tjetër, rrëfimet që lidhen me mërgimin dhe përvojën në Zvicër paraqesin një dimension tjetër të diskursit narrativ: përplasjen mes botës tradicionale dhe modernitetit global. Përshkrimet e protestave në Cyrih apo të jetës së emigrantëve krijojnë një kontrast të fortë mes imazhit të Zvicrës si “parajsë” dhe realiteteve sociale që autori has në të. Në këtë kontekst, episodet humoristike apo groteske, si ai i shqiptarit që pëson “plagë dashurie”, marrin funksionin e një satire sociale. Humori këtu nuk është vetëm element narrativ; ai është edhe mekanizëm kritik që zbut dhe njëkohësisht demaskon paradokset e jetës së emigrantit.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i këtyre tregimeve është përdorimi i ironisë dhe groteskut si mjete retorike. Episodet që përshkruajnë situata të çuditshme apo komike qoftë në marrëdhëniet mes njerëzve, qoftë në përshkrimin e zakoneve dhe sjelljeve krijojnë një efekt të dyfishtë: nga njëra anë argëtojnë lexuesin, ndërsa nga ana tjetër e shtynjë atë të reflektojë mbi absurditetin e disa realiteteve shoqërore. Kjo teknikë narrative është e njohur në traditën e rrëfimit ballkanik, ku anekdota dhe satira shpesh shërbejnë si forma të kritikës indirekte.

Në planin simbolik, disa nga episodet më të thjeshta marrin një dimension alegorik.



Për shembull, tregimi për dy gomarët në oborrin e spitalit në Tivar mund të lexohet si një metaforë e heshtur për realitetin institucional dhe për paradoksin e jetës në një hapësirë ku mungojnë shërbimet elementare për njerëzit. Në këtë kuptim, figura e gomarit e njohur në folklorin shqiptar si simbol i durimit dhe i përlësisë transformohet në një figurë satirike që vë në pah kontrastin mes natyrës dhe organizimit shoqëror.

Rrëfimet e këtij libri karakterizohen nga një stil i drejtpërdrejtë, narrativ dhe shpesh bisedor. Ky stil krijon një afërsi të veçantë me lexuesin dhe i jep tekstit një autenticitet të dukshëm. Përdorimi i dialogut, i shprehjeve popullore dhe i situatave të përditshme e afron tekstin me traditën e rrëfimit gojor. Në këtë mënyrë, autori e ndërton narrativën si një vazhdim të kulturës së tregimit tradicional shqiptar, ku kujtimi personal bëhet pjesë e kujtesës kolektive.


Londra, si një nga metropolet më të mëdha dhe më shumëkulturore të botës, ka qenë gjithmonë një hapësirë ku historitë personale ndërthuren me historinë e madhe. Në këtë kontekst, tregimet që lindin nga përvoja e jetës në këtë qytet marrin shpesh formën e një kronike të vogël njerëzore, ku përditshmëria, kujtesa dhe imagjinata krijojnë një lloj folklori urban modern. Kapitulli “Tregime nga Londra” përfaqëson pikërisht një ndërthurje të tillë: një mozaik rrëfimesh që bashkojnë figura historike, përvoja personale dhe legjenda urbane, duke krijuar një narrative që mund të lexohet njëkohësisht si dokument kulturor dhe si material për analizë letrare e retorike.

Në fillim të këtij rrëfimi shfaqet figura e Faik Konicës, e cila vendos një bosht historik dhe kulturor për gjithë tekstin. Londra nuk paraqitet vetëm si qytet, por si një hapësirë ku identiteti shqiptar merr dimension ndërkombëtar. Konicë paraqitet si një intelektual kompleks një figurë që përmbledh elegancën aristokratike, mendimin kritik dhe lidhjen me qendrat kryesore të kulturës evropiane.

Miqësia e tij me poetin francez Guillaume Apollinaire krijon një dimension të ri kulturor. Kjo marrëdhënie simbolizon takimin e dy traditave intelektuale dhe tregon se kultura shqiptare nuk ka qenë e izoluar, por pjesë e dialogut evropian të fillimshkullit XX. Poezitë e Apollinaire-it, të shkruara gjatë vizitave në shtëpinë e Konicës, e shndërrojnë hapësirën londineze në një vend krijimi artistik dhe në një pikë takimi të kulturave.

Në këtë kontekst, Annie Playden shfaqet si një figurë poetike dhe simbolike një muzë e paditur për ndikimin që kishte në imagjinatën e një gjeniu letrar. Ky episod përforcon idenë se jeta e përditshme shpesh bëhet burim i artit të madh, duke e lidhur përvojën intime me krijimin universal.

Në pjesët e tjera të tregimeve, autori kalon nga figura historike në përvoja të zakonshme të jetës në Londër. Këto episode si historia e çiftit irlandez-iranian apo rrëfimi për tifozët shqiptarë në Kardif



krijon një tablo të gjallë të diasporës dhe të ndërveprimit kulturor.

Tregimet e Daut Dautit funksionojnë si rrëfime moderne që bartin elemente të humorit, ironisë dhe reflektimit social. Për shembull, dialogu mes Brianit dhe Nurës përshkruan me një episod të thjeshtë tensionet dhe ndjeshmëritë në marrëdhëniet njerëzore. Ky lloj rrëfimi përmban strukturën klasike të fabulës tregimtare: një situatë e zakonshme, një moment kulmor dhe një reflektim i heshtur që mbetet tek dëgjuesi ose lexuesi.

Gjithashtu, përshkrimi i tifozeve shqiptarë në stadiumin e Kardifit krijon një skenë kolektive ku identiteti kombëtar shprehet përmes ritualit sportiv. Në këtë rast, stadiumi bëhet një skenë simbolike ku diaspora afirmon praninë dhe solidaritetin e saj.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i këtyre tregimeve është reflektimi mbi ndryshimet sociale dhe teknologjike. Rrëfimi për kabinat e kuqe të telefonit dhe për evoluimin e komunikimit përfaqëson një formë nostalgjie kulturore. Autori përshkruan një botë që po zhduket botën e pritjes në radhë për një telefonatë dhe të komunikimit të rrallë, por të çmuar. Për rrjedhojë, teksti mund të lexohet edhe si një kritikë e heshtur ndaj individualizmit modern.

Përshkrimi i marrëdhënieve të ftohta mes fqinjëve në Londër thekson kontrastin mes kulturës urbane perëndimore dhe traditës ballkanike të "kojshillëkut". Ky kontrast shërben si një reflektim sociologjik mbi ndryshimin e mënyrave të jetesës dhe të marrëdhënieve njerëzore.

Një nga elementet më interesante në teknikën narrative të tekstit është rrëfimi për "Njeriun Pëllumb". Ky episod përmban të gjitha elementet e një legjende urbane: një personazh misterioz, një histori të paqartë dhe një rrjet tregimesh që qarkullojnë në komunitet. Në kontekstin e sociologjisë urbane, figura të tilla shërbejnë si simbole të marginalitetit dhe të misterit të qytetit. Londra, në këtë rast, shfaqet si një hapësirë ku realiteti dhe imagjinata ndërthuren, duke krijuar mite të reja që zëvendësojnë legjendat tradicionale.

Në disa pjesë të tregimeve, rrëfimi kalon nga përvoja personale në histori më të gjera historike. Rasti i bombardimit të Mançesterit nga IRA dhe historia e ndihmës së Sulltan Abdyl Mexhidit gjatë urisë së patates në Irlandë përfaqësojnë momente ku historia globale ndërhyt në rrëfimin personal.

Këto episode e pasurojnë tekstin me dimension historik dhe tregojnë se tregimet e vogla të jetës shpesh zhvillohen në sfondin e proceseve të mëdha historike.

Arkitektura tekstore e librit "Nëpër gjethe kujtimesh" e ndërton nga tri "shtylla" fabulare "Fëmijëria", "Tregime të mëvonshme" dhe "Tregime nga Londra", dëshmon se krijimtaria e Daut Dautit përbën një mozaik të gjallë të kujtesës individuale e kolektive, ku ndërthuren **autobiografia, mitologjia popullore**, kronika shoqërore dhe reflektimi kritik. Nga bota e thjeshtë e fshatit dhe kujtesa e fëmijërisë, te transformimet kulturore e shoqërore të dekadave të fundit dhe deri te përvoja urbane e mërgimit në metropolin londinez, autori arrin të ndërtojë një narrativë që e kthen përditshmërinë në dëshmi letrar dhe kulturologjike. Nëpërmjet humorit, ironisë dhe vëzhgimit të hollë të jetës, këto rrëfime shndërrohen në një kronikë të ndjeshme të kohës dhe të identitetit, duke ruajtur gjallërinë e tradicionales dhe duke i dhënë asaj një dimension modern letrar. Për rrjedhojë, librin e Dautit nuk duhet kuptuar vetëm një përmbledhje tregimesh, por një thirrje për të ruajtur kujtesën kolektive dhe për të kuptuar rrugëtimin e njeriut shqiptar ndërmjet vendlindjes dhe botës, duke dëshmuar se letërsia mbetet një nga format më të fuqishme për ta mbajtur të gjallë historinë, kulturën dhe përvojën njerëzore.

(Fjalë e mbajtur në promovimin e librit
"Jam mysliman" në librarinë "Altera" në
Prizren, më 15 prill 2026)

Pse Ben Blushi është sot shkrimtari më i lexuar shqiptar

Nga Agim Vinca

Ben Blushi (1969) është sot shkrimtari më i lexuar shqiptar. Veprat e tij janë "bestsellerë".

Por, para se të flas për të si shkrimtar, më lejoni të evokoj një kujtim.

Jam i vetmi njeri në këtë sallë, në mos edhe në krejt Kosovën, që e kam takuar Ben Blushin kur ishte fëmijë. Kjo ka ndodhur në vitin 1974, kur unë pata shkuar për herë të parë në Shqipëri. Ishte një rastësi. Takimi ndodhi në bulevard, te godinat e ministrive. Ishte ditë e diel. Unë kthehesha nga Biblioteka Kombëtare në hotel (Biblioteka Kombëtare në atë kohë punonte edhe të dielave para dite, deri në orën 12), kurse Beni me të atin, Kiçon, kishin dalë për shëtitje në bulevard ose shkonin dikund. Beni duhet të ketë qenë atëherë pesë vjeç ose një çikë më shumë dhe i ati, Kiçoja, e mbante për dore. U takuam ballë për ballë dhe u përshëndetëm. Folëm pak prej në këmbë. Unë kisha shkruar diçka për Kiço Blushin si shkrimtar, më duket për një libër të tij me tregime¹ dhe ai më falënderoi. Çuni i tij tregohej i paduruar; e tërhiqte babain për t'u larguar. M'u duk paksa i egër. Por s'kishte faj, unë isha një njeri i panjohur dhe ai s'kishte dalë për të dëgjuar biseda mes dy të rriturve, që flisnin gjëra koti (për letërsinë), por ndoshta për të shkuar në vizitë te gjyshërit, për të parë ndonjë shfaqje në Teatrin e Kukullave ose për ndonjë akullorë në ëmbëltoret e Tiranës. Unë e mbaj mend mirë atë takim, për Benin nuk e di. Po e evokoj sonte këtu për të treguar se Ben Blushi, si të gjithë ne, ka qenë fëmijë, por ndryshe nga ne edhe personazh i një veprë letrare, i romanit të famshëm të babait të tij *Beni ecën vetë*, të cilit i referohet edhe në veprën që po promovohet sonte këtu në Prizren. ("... gjithmonë kam ecur vetë. Madje, kam bërë edhe më shumë. Kam ecur vetë dhe vetëm, f. 214).

Kur jemi këtu, të themi se fëmijët tanë e patën pëlqyer shumë romanin *Beni ecën vetë* (mund të duket e pabesueshme, por im bir, fjala vjen, e pati lexuar shtatë herë), kurse të gjithë ne e kemi parë edhe si film me skenar të autorit dhe regji të Xhanfize Kekos. (Një nga filmat më të mirë shqiptarë të kohës së komunizmit).

Kur flitet për Ben Blushin si shkrimtar nuk mund të mos përmendet edhe një fakt: tre breza shkrimtarësh në një familje: gjyshi, babai, biri (nipi). Gjyshi, Profesor Dhimitër Shuteriqi, studiues dhe shkrimtar; kryetar shumëvjeçar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë; babai, shkrimtari i ri Kiço Blushi, që bën për vete të bijën e "patriarkut të letrave" dhe biri, përkatësisht nipi, që doli në skenë relativisht vonë si shkrimtar (debutoi në vitin 2008, me romanin *Të jetosh në ishull*), por që po i kapërcen pararendësit e vet jo vetëm me tirazhin e veprave dhe numrin e lexuesve, por edhe me famën e tij si shkrimtar.

Pothuajse secila veprë e Ben Blushit,

¹ Fejesa, plaku, televizori (1971).




dhe francezit Mishel Uellbek (Michel Houellebecq). Nuk e di sa e njeh amerikanin David Foster Wallas (David Foster Wallace), që ëndërronte të shkruante veprën kapitale *Shakaja e pafund* (Infinite Jest) si histori letrare të njerëzimit, por që e mbylli jetën me vetëvrasje?

Apo mos vallë Ben Blushi është një Salman Ruzhdi shqiptar, që unë personalisht (besoj edhe ju) nuk do të doja ta pësonte fatin e tij, jo si shkrimtar, por si njeri, si qytetar?

Lajtmotivi i romanit *Jam mysliman* është raporti i shqiptarëve me islamizmin, si fe, si ideologji, si filozofi dhe si mënyrë e jetesës. Blushi bën dallim midis myslimanëve dhe islamikëve (f. 153), sikundër edhe mes islamit tradicional shqiptar, të butë e liberal dhe këtij të sotmit, radikal, që e vë fenë përmbi Kombin dhe Atdheun. Islamini mbi Shqipërinë (f. 152). Ata që mbulojnë bukurinë e grave me burka dhe që kërkojnë dëbimin e Skënderbeut nga kujtesa dhe historia kombëtare janë islamikë dhe si të tillë paraqesin rrezik për shqiptarët si komb. (Te romani para këtij, *Komploti*, Blushi tregon si do të duket Shqipëria pas njëzet vjetësh, në vitet 2043-2044, kur shqiptarët mund të jenë pakicë në vendin e tyre dhe kur ministër i mbrojtjes i Shqipërisë mund të jetë një afgan. Kjo është një veprë tipike distopike).

Thuhet se rregulli i parë i çdo romani të suksesshëm është të mos jetë i mërztshëm. Romanet e Ben Blushit mund të pëlqehen ose jo, por ato nuk e lënë në asnjë rast indiferent lexuesin, duke e bërë atë, siç thoshte Mopasani në kohën e tij, të qeshë ose të qajë, ose të dyja bashkë njëkohësisht. Blushi është shkrimtar që flet për problemet pikante me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare. Edhe shkrimtarë të tjerë të brezit të tij, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, i trajtojnë këto probleme, por jo me kaq forcë e elokuencë.

Në fund, duke përdorur një fjalë të proveniencës islame, që haset shpesh në librin në fjalë, do të thosha se Ben Blushi është "shkrimtar qafir", në kuptimin heretik, që prek tema tabu dhe që i trajton ato në mënyrë të lirë.



Poezia, si art i fjalës qartëson modelin për një shpirt që moderohet në relacion pas të bukurës. Si të thuash është e tejdukshme në formën e një vakumi lakonik me përmasat e një vallëzimi hyjnor, ku gjen alogjinë e poetit e kthjellon drejt një patosi me arsye racionale dhe një intonacioni shpirtëror. Sigurisht, poezia nuk ka fund dhe është e pashtershme, sepse ajo është e krijuar nërgut për të bukurën, ngaqë e bukura nuk ka nevojë për prova. Dhimitër Pojanaku, njeriu që ngadhënjën mbi njeriun, pozicioni i shpirtit të tij që vidhet nga valët e detit të pafund preferon të gëlltis shpirtin e tij prej poeti në poezi liriko filozofike të peizazhit, dashurisë, pezmatimit. Copëza shpirti me formën e një aventure, pastaj me ngushëllimet e vjeshtës mëshiron muzgun e përdimit të qiejve. Ah, deti është formula e kapërcimit të vetvetës në vetminë e realitetit të tij. Ai është poet bodlerian, skalit vargun me konkurrencën e mendimeve të thella, gjithnjë duke futur një kohë poetike vetëm për të ndërtuar një poezi. Ai ka shpresa dhe vizion të madh për lojën e të shkruarit, e cila rrotullon gjithë virtytin e tij shpirtëror si kullë ashensori. Krijon pa ekzistencën e pezmatimit, dhe e kthen në një ekzistencë ngushëllimi, që shpeshherë mund të ndryshojë dëshirat për të mirë, por koha mbetet e habitur nga sjellja, sepse ai bëhet i nxituar në lumturinë shpirtërore. Poezitë e tij aludojnë për një poet që endet mes llumit dhe virgjërisë...

Disa vështrime fikse për poezinë e Dhimitër Pojanakut:

*Fund deliresh
Sa herë më molepsin zërat e qiellit,
Shkoj te deti.
Sekush më mbathi në kthim,
Këpuçë plumbi.
Dhe ngeshëm numëroj kokrrizat e rërës.*

(nga libri me poezi:
Guret Zbardhin Natën)

Një vakum lakonik i mbinë në shpirt. Zërat e qiejve nisin pozicionin e tyre duke e stimuluar poetin të këndojë dhe të udhëhiqet drejt një relacioni pas të mirës supreme. Në syrin e poezisë, ai shfaq melankolinë për një përpjekje kundër përpjekjes së qiellit. Një sy që fshihet pasqyrën për vullnet drejt realitetit, dhe një shmangie me bojën e fosfortë të valëve kërkon moralin për qënien që ka humbur dhe që rrëfen heshtazi për ndonjë humbje të ardhshme. Vetmia dhe deti janë forca e shpirtit të tij për t'i mbuluar veset e një qielli. Ai troket me thembrat e tij të zathura në kokrrat e renditura me rërë, duke i rrëfyer qiellit me gjuhën e poetit se, tani është një moment tjetër për stabilitet shpirtëror dhe një mundësi më shume për poezinë kur nata hedh hënën kulace në skenë, që poeti ta grishë me vargje... Ai në vargjet e mësipërme kërkon nga qielli hyjnor që t'i rikthehet paqja dhe stabiliteti i vetvetës, dhe se intuita e një poeti lirik nuk duron të skllaverohet nga zërat misterioze të qiejve. Poezia e tij me formën e një lirie kapitaliste sundon krizën e zërave mister që ngërcojnë një qenie komplet intuitive. Frymëzimi i poezisë së tij del nga një tendencë e shkujdesur e Zotit, nga një rol i jetës se tij, i lindur për një triumf në luajtjen e roleve.

*Oda përballe times
Përnatë mban dritën ndezur.
Muret e saj asnjëherë s'kanë puthur
errësirën,
Errësira asnjëherë s'ka mbështetur faqet
mureve.
Netëve,
Vuaj të di,
Nat' dritë e mban ndezur dhimbja apo,
Dashuria.*

(nga libri me poezi: Guret Zbardhin Natën)

Një llambë prej poeti me dritën e hënës e mban aktiv pozicionin e shpirtit të tij. Brenda dhomëzës kubike ku janë orientuar rrezet e llambës kah tryeza e punës, ku imagjinata grafullon përnatë nga një poezi në letër-zbardh guret e natës. Pena, në kontrast me ngjyrën e murit nxjerr shllimin e poetit për një vizion drejt mendimit për arsye filozofike duke

Dhimitër Pojanaku, një poet bodlerian

Nga Bujar Plloshtani

premtuar gjithë kercellin prej të njëjtit motiv: Shpirt përmbi shpirtat. Pozicioni i penës së poetit është ideal i lirë thelbesisht i njëjtë me vetveten e tij, i tëri mes llumit dhe i formuar si një artikull i vjetër fasade për besim të thellë ndaj kapërcimeve të shthurura...

Llambën e përdor si një mjet për t'ia mbajtur aktiv muzën, brenda tij të krijohet një emocion që ia përkujton shllimet për një art origjinal të të menduarit. Edhe poezia kërkon përshatje me natyrën e shpirtit, kërkon një përjetim të gjallë të disa ndjenjave të huaja në ndjenja poetike. Sigurisht, dhe netët e tij me muzen janë një shmangie e lumturisë absurde, në një vizion për arsye. Ai di të vuajë, vetëm sepse muza dhe shpirti i tij i arrirë poetikisht, me një vlerë intuitive, e kapërcen vlerën e një urtësie njëzore. Poetët që kanë vizion për idealizem dhe trajtim filozofik, në radhe të parë zenë pozicionet e një gjeniu.

*Mbasdite vere
Shtrirë,
I pozon qetësisë.
Një xham shejtan,
I vetmi mëkatar,
Gëzon hiret e saj.
Të linjtat,
Guaskat bosh,
Kolovitën dyshemesë.*


(nga libri me poezi:
Guret Zbardhin Natën)

Pas përdimit të pezmatimit, lind boja e erosit. Brenda lëkurës së protagonistes ka gjetur vetminë e saj që bredh, pastaj pak më vonë vetëm poezia e tij e sheh ngado atë model femërushkeje. Syri i tij që endet dhe që rrëmben, arrin dhe këtë here të mbështjellë pamjen e një shpirti femëror në formën lakuriqe. Rërën që dikur poeti ka shkëlur me pez, sot trupi i saj lakuriqe e puth me vëllimin e një dashurie të mpreshtë entuziaste. Ku zhurma e rërës ia pëshpërit veshin lëkurës së saj për një botë dehëse përballe një jetë të shthurur prej bohemi. Femra si një akt skllaverie

shtrihet për t'i promovuar mashkullit gjithë nuancat e saja erotike. Dashuria është patosi mbi të vërtetën e jetës shpirtërore të poetit, dhe ndjenjat e përmiresojnë nga pushtimi i pezmatimit borëmbuluar. Nëse ajo femër e brishtë kaplohet nga ndjenja misterioze, atëherë këtë mistër mund ta zbërthejë një poet që jeton mes llumit dhe virgjërisë. E, ai poet është Dhimitër Pojanaku.

*Dimër në lokalet e plazhit
Vetmia dehet me kujtimet e verës.
Dy kotele,
Për inat të detit të ftohtë,
Lëpohen me gjuhë.
Një plak beqar dhe një trendafil vjeshtë,
Këmbejnë,
Dashurira të hershme.
(nga libri me poezi: Xhindet kercejnë polka)*

Poeti qartëson simpatinë sekrete për një qytet të tij të preferuar nga preferenca, kur momentet për dashurinë e triumfuat, sipërfaqja e tokës shtrohet me savan dëbore brenda me pjesët e paqes dhe dliresisë. Ky është vetëm një vend për një henë apo një satelit tjetër të shkëputur nga pezmatimi, këtu mbijeton dëshira e vetme, dashuria, dhe si rrjedhim ai mund të argëtojë vetveten gati se cdoherë, në mbrëmjen e vetmuar. Poeti që shpeton të bukurën me delikatsën e tij herë prej një demoni, e herë prej një engjelli, madje dhe kur disku i hënës nis të ngrihet nga i ftohti i njëanshëm, ai mbetet heroi i triumfuat i së mirës në dashuri. Po c'është dashuria për një poet si Dhimitër Pojanaku? Dashuria për të nuk është model për të zenë vakumin për vuajtje, por një qetësi me normë individuale drejt pushtetit për vullnet dhe pushtetit për jetë. Po dashuritë e hershme të një poeti, a nuk janë një tërmet i vazhdueshëm që zgjojnë ndjenjat e dlira të vetvetes dhe momente kujtimesh që paralizojnë vobektesinë e momentit jetësor. Dhimitër Pojanaku, përballë poezisë së tij është frymëzim drejt shpirtave të lire që dijnë të enden mes llumit dhe virgjërisë, dhe konceptit jetësor.



.... Edhe pse qielli e verbon shpeshherë, ai e adhuron atë, pastaj e shkruan nëpër poezi, duke e bërë më bindës ndaj tij. Nganjëherë, gjoja duket se është më kokëfortë se qiejt, ndofta poezia e krijon sipas llojit të vet, por fundja është poet i lindur, pra i talentuar për t'i përdorur tekat, që i ka si armë të fundit drejt kësaj ekzistence shoqërore. Poezia e tij është frymëzimi i natyrës, që e reciton kaq mahnitshëm me vlerën ngadhënjyese të vrullit krijimtari. Realitetin e kësaj ekzistence, ai pretendon ta ndryshojë me ironinë e tij poetike, ndryshe, turma i kupton si përherë poetët larg realitetit, ai përpigjet t'ua thotë të tjerëve, se poeti ndodhet kudo, thuajse dhe brenda çdo realiteti, pavarësisht lëkundjeve dhe lëvizjeve shpirtërore. Ai është poet fin dhe kapriçoz. Unë shpeshherë them, që, poezia është perëndi! Sepse lind prej një shpirti krijues, si krijim gjenial, dhe vjen nga ndriçimi absolut i shpirtit. Sa e ndërlikuar, po aq dhe e thjeshtë! Ndërkaq, poezia e Pojanakut është natyrë e gjallë që mishëron një qiell që shkoqit terrin verbues ndaj çdo trupi të humbur. Ai nuk mund të të shpëtojë nga e keqja, nga misteri, por mund të përshkruajë të keqen se si luan me fatin e njeriut të shkretë. Parulla e recitimit të tij, dhe e keqja sikur të mos përsëritet më! Këtu ka lindur dhe një pjesë e ironisë së tij ndaj vetvetes, turmës, qiellit. Prandaj, dhe e bukura kërkon nevojë shpirtërore të lindur, e cila dëshmon se nuk është bosh, andaj ka lindur nga nevoja. Poezia e tij është tepër njëzore, pavarësisht ironisë therëse, tekave, naivitetit, këto të fundit kanë lindur te shpirti i tij si pasojë e fatit të hidhur shoqëror, por, megjithatë, në thelb poezia e tij përmban meditim kontemplativ mbi të drejtën e shoqërisë njëzore, mbi të vërtetën humane njëzore, mbi qiellin mistik, mbi shpirtin krijues, është si verë e kuqe, që noton drejt gjakut të tij si anija pa vela. Gati e vetmuar. Edhe shpirti i tij është i vetmuar, por jo dhe poezia e tij... Poezia e poetit Pojanaku është një gur i çmuar, i fshehur në brendësinë e tij si të jetë me vakum, duke rrezatuar natën, ndritjen e arsyes së fjalës. Poezi e thellë, bindëse, kurajoze, e ngjashme me vetveten... Pojanaku është poet i asaj gjenerate që arrin të imponohet pranë lexuesit me një poezi të kulluar, të pastruar nga foljet e tepërta gati të bezdisshme që hasen shpesh në poezinë tonë bashkëkohore.

Me kujtohet përsëri poezia "Dimër në lokalet e plazhit". Në më pak se dy folje, Pojanaku krijon varg "horizontesh" shpirtërore tek lexuesi... Me anë të fjalës emocionale, poeti dëshmon kundrejt humbjes, trishtimit shpirtëror, ç' humanizmit njerëzor; mbase kjo është një veti e tij e mirë që shquan botën e shpërfillur nëpërmjet të drejtës natyrore, që është arsyeja ndaj të vërtetës njëzore. Poezia e tij është një grusht i fuqishëm ndaj revoltës, ndaj turmës dhe ndaj trishtimit të verbër të shpirtave të lirë, dhe nëpërmjet fjalës, tekave të tij hënore, ai mund çdo lakuriqësi mendimesh që mundohen ta zhveshin autenticitetin njerëzor.

Një traktat intelektit prej poeti filozof mund të vihet përballë çdo të metë që e ndikon botën dhe ligjet e saja fizike.



Në një artikull të botuar kohë më parë në këtë gazetë, kam propozuar që të hapet një rubrikë e posaçme për kulturë gjuhe, si dikur në disa gazeta, pavarësisht nga revistat shkencore të specializuara, si “Gjuha jonë” (ASHSh, Tiranë) dhe “Gjuha shqipe” (IAP, Prishtinë), e domosdoshme për ta bërë çështjen e kulturës së gjuhës më masive, më të përditësuar e më ndikuese në gjendjen kur gjuha, e folur dhe e shkruar, në shumë raste, “masakrohet” aq sa ulet në shkallën e përdoruesve gjysmanalfabetë, sa forma e shprehjes, si e themi diçka, ndikon ndjeshëm në përmbajtjen e komunikimit gjuhësor, çfarë themi. Madje, si e themi diçka disa herë ka më shumë peshë, sepse ose e qartëson, e përforcon dhe e bën të lehtë rrokjen e asaj që themi, kur është si duhet, ose, në të kundërt, e errëson, e dobëson dhe vështirëson kapjen e saj.

Të metat nisin që nga drejtshkrimi tingullor (f.v. për të dalluar *vënd* për *vend*, *qendror* < *qendër* nga *qëndroj* (në shkrimin e shqiptimit me *e* a me *ë*...), deri te ndotja gjuhësore me *huazime të panevojshme*, me keqpërdorime fjalësh, ndërtime të gabuara frazash etj., duke na dhënë një shëmti të ligjërit. Ja si shkruhet jo rrallë në rrjetet sociale e në disa emisione televizive: ≠ “Un, shoko, mendoj që pun ka plotë ktu, sa me e dijt tan dyrrnjaja, veç kush don me punu...” – fb. Dhe ja si i jep lajmet një folëse televizioni: ≠ “Për shkak të çmimeve ekstreme shqiptarët po limitohen aktualisht në ushqime bazike” – tv. Kujt po i flet kështu?!

Por këtë herë dua të sjell ca shembuj të moskuptimit a të keqkuptimit e për rrjedhojë të keqpërdorimit të disa fjalëve me ngjashmëri të madhe fonetike, “gatihomonime”. E kjo ndodh edhe në ligjërimin e ndonjë personaliteti politik a shtetëror, që mbahet për i kulturuar, por që sjell dëm edhe më të madh në gjuhë, sepse siç dihet, guri, sa më i rëndë e sa më lart të jetë, aq më të madh e bën dëmin kur bie poshtë.

Në tipin e fjalëve që përmenda, “gatihomonime”, ka ngatërresa të tilla që tregojnë padituri ose viktimizim nga një “snobizëm gjuhësor” dhe që e bëjnë ligjërimin jo vetëm të gabuar, por shpesh edhe qesharak.

Po sjellim si shembuj disa përdorime të gabuara fjalësh “gatihomonime” njëra për tjetrën:

at “kalë, sh. atllarë” < trq. për **atë** “baba, sh. etër” < ie. (≠ “At Gjergj Fishta”; Çmimi letrar AT ZEF PLLUMI”...);

cesurë “lënie, lejim...”; si term në letërsi **cezurë** “pushim brenda një vargu poetik pas një rrokjeje të theksuar”, për **censurë** “kontroll i veprave, i letrave etj. nga një organ i posaçëm para se të shfaqen a të lexohen për t’i ndaluar ose për t’u hequr pjesët e padëshirueshme...” (≠ “Cesura e veprave letrare e artistike veçan ka qenë e fortë sa mund ta pësonte edhe autori...” – gaz.);

histori “përshkrim i një ngjarjeje që ka ndodhur...” për **histeri** “sëmundje nervore që shfaqet me të qeshura e shfrenime...” (≠ *Atë çast e kapi një histori, me të dridhura e të qeshura si i çmendur...* – gaz.);

hurdhë “pellg me ujë të ndenjurr...” për **hudhër** “perime si qepa, por me zhardhok të ndarë në thelpinj djegës...” (≠ “...vargje me **hurdhë** të varura poshtë ballkonit...” – gaz.; edhe si *kahin*.);

masazh “ndryse e fërkim i butë i trupit për qetësim të dhembjeve, për forcim të muskujve etj. ...” për **mesazh** “tekst a shënim në letër që dikush ia bën dikujt për një njoftim...” (≠ “... i kishte nisur tri **masazhe** radhazi e s’mori përgjigje...” – gaz.);

Kulturë gjuhe

KEQPËRDORIME FJALËSH

Nga Jani Thomai

mostër “copë a pjesë e vogël e shkëputur nga diçka për ta paraqitur si duhet bërë më tej...” për **monstër** “përbindësh...” (≠ “E po kur më doli përpara ky **mostër**, veç ta dëndje në dru...” – tv.);

ndjej “i fal me dashmirësi dikujt një faj a gabim...” për **ndiej** “kap me shqisa ngacmimet e ndryshme...” (≠ “... nuk të **ndiej** asnjëherë kur vjen aq vonë” – tv.);

përshkruaj “paraqit me gojë ose me shkrim pamjen e dikujt a të diçkaje...” për **përshkoj** “kaloj një rrugë brenda një kohe të caktuar...” (≠ “...ka **përshkruar** një rrugë të gjatë më këmbë e s’u lodh...” – gaz.; ≠ “Flaka **përshkroi** 32 dhoma dhe la prapa hi e qymyr...” – tv.);

prefekt “kryetari i një prefekturë...” për **perfekt** “i përkryer, i përsosur...” (≠ “... e ka kryer **prefekt** detyrën që iu ngarkua...” – tv.);

u preftë (~ në paqe!) nga **pritem** “ndaj një copë nga diçka a e ndaj në copa me thikë ose me mjet tjetër të mprehtë...” për **u prehtë** (~ në paqe!) nga **prehem** “pushoj (për të vdekurit) (≠ “U **preftë** në paqe! Të rroni e ta kujtoni!” – lf.);

recension “vlerësim kritik me shkrim për një vepër artistike a shkencore...” për **recesion** “shkuarje prapa, tërheqje; heqje dorë, prapsje; rënie ekonomike, amulli...” (≠ “... kuptohet **recension** i kemi përfunduar prej kaq vjetësh dhe spo dalim dot...” – gaz.);

stimulim (< **stimuloj** “nxit...”) për **simulim** (< **simuloj** “shtirem, bëj diçka të rreme për të mashtruar dikë...”) (≠ “...mbrojtësi ... u shtri për tokë dhe arbitri e dënoi me karton të verdhë për **stimulim**...” – gaz.);

tablet “kompjuter i vogël dore...” për **tabulat** “pjesë e një aparature qendrore ku regjistrohen bisedat telefonike të zhvilluara...” (≠ “...u bë edhe kontrolli i **tableteve** në qendër e nuk u gjet ndonjë gjurmë regjistrimi bisede...” – tv.) etj.

Keqpërdorime ka edhe për shkak të sinonimisë ose të ngjashmërisë a të afrisë kuptimore të fjalëve, të “gatisinonimeve” – që dallohen nga nuanca të holla kuptimore a të mbishtresuara ose, sidomos, nga lidhje të ndryshme sintagmatike, si:

gjakderdhje “derdhje gjaku në luftë a përleshje” për **gjakrrjedhje** “hemorragji” (≠ “...nga plaga e thellë **pacienti** pati mjaft **gjakderdhje** dhe u desh t’i jepej gjak...” – tv.);

vendos “e çoj dikë a diçka në një vend të caktuar...” për **vë** “vesh a e çoj diçka diku ku duhet të qëndrojë...” (≠ “Mbi këmbë **vendosi** një triko të hollë, sa për bukuri...” – lf.; ≠ “...unazën e **vendosnin** te gisht i unazë, i katërti, prandaj quhet ashtu...” – tv.; ≠ “Akoma s’ia **keni vendosur** emrin foshnjës...” – lf.) etj.



Po shtojmë këtu edhe disa trajta të shtrembëruara për shkak të ndikimit nga “gatihomonimia”:

afrimitet për **afrim** ose për **afinitet** (një përzjerje e këtyre dy fjalëve të fundit: (≠ “...kanë **afrimitet** të madh, si vëllezër...” – tv.);

garazhd (siç shkruhet në disa qepene garazhesh, nën ndikimin e *grazhd*: *grazhd* + *garazh* > *garazhd*) për **garazh**;

kompromentoj për **komprometoj**, nga it. *compromettere* “rrezikoj; prek...” (≠ “Kjo e **kompromenton** çështjen...” – gaz.);

premtoj “jap fjalën për diçka...”, që lidhet me it. *promettere* me të njëjtin kuptim, për një fjalë tjetër të mundshme ***permetoj** “lejoj, lë...”, që lidhet me it. *permettere* po ashtu me të njëjtin kuptim (≠ “Duhej të **nxitonim**, se nuk na **premtonte** koha për të arritur atëherë kur na prisnin shokët...” – gaz.);

prespektivë (duket nën ndikimin e fjalëve me parashtesën *pre-*: *preferencë*, *prehistori*, *prepotent*...) për **perspektivë** (≠ *Një prespektivë e madhe i hapet shkollës sonë në të ardhmen...* – lf.); por edhe pa ndonjë gjedhe të tillë: **rekurtim** për **rekrutim** (≠ “Ne bëjmë regjistrimin e kërkesave, kurse **rekurtimin** e personave konkretë e bëjnë organet përkatëse...”) etj.

S’është fjala për “gabime shtypi”, dalin shpesh. Disa nga këto janë aq të çuditshme, sa duken si të pabesueshme, të shpifura. Keqpërdorues, mbroni gjuhën nga shtrembërimet, veten nga padituria dhe të tjerët nga mundimi për t’ju kuptuar çfarë doni të thoni

[tv. – televizion; fb. – facebook; gaz. – gazetë; lf. – ligjërim i folur; krahin. – krahinore it. – italishte; trq. – turqishte; ie. – indoevropian; * – i supozuar; < – vjen nga...; ≠ – keqpërdorim]

RESTROSPEKTIVË KOMBËTARE

Besoj se fjala është shkaku kryesor që Atdheu im i vogël, Shqipëria, ka mundur t'u mbijetojë rreziqeve shekullore dhe sot është gjallë, teksa shqiptarët kanë vuajtur më shumë prej fjalës së tyre dhe janë dënuar prej saj po në shekuj.

Dhe jemi një popull i lashtë, kështu besojmë, që kemi patur një Kanun të famshëm, bashkëkohës me "Iliadën" e Homerit, ku fjala nderohej si gjaku, mbrohej dhe ishte krijuar kulti i Fjalës së Dhënë, Besa -në shqip, që nënkupton më shumë se aq, fjalën - premtimin - dhe veprimin, që kanë vlerën e jetës dhe me fuqinë edhe përtej jetës, me mbrojtje Zotin.

Kur vendi im në shekullin XV u pushtua nga perandoria otomane dhe kështjellat e Gjergj Kastrioti - Skënderbeut pas vdekjes së tij ranë një e nga një dhe shqiptarët merreshin me zor dhe dërgoheshin ushtarë shkretëtirave perandorake, shkollat shqipe u ndaluan, u mallkua alfabeti latin shqiptar, e folura u mbush plot me barbarizma si me gjarprin, siç thuhet dhe në një poezi, megjithatë kështjella e gjuhës shqipe nuk ra dhe ajo më shumë se me beteja, nga luftëtarët me shpata, pushkë dhe topa, u mbrojt nga gratë që nuk dilnin nga shtëpia, nga nënat dhe gjyshet, plakat që dinin nina-nanat dhe përrallat, dhëmbët e tyre u bënë bedenat e pathyeshme të gjuhës.

Dhe pastaj dolën poetët e Rilindjes shqiptare, të parët ata që kishin mërguar në Itali, *arbëreshët e bukur*, që sëbashku besonin se shqipja është "Gjuhë Perëndie" dhe e himnizonin.

Në Europën e shekullit XX u ngrit një perandori më kohë skadence më të shkurtër, më pak se një shekullore, por mizore po aq, në mos më shumë, ajo komuniste, ku vendi im, më i vogli në këtë perandori, por me diktaturën më të egër, të vendosur pas Luftës II Botërore, e nisi me pushkatime, vrau njerëz të gjuhës, shkrimtarë dhe para se të ngrinte universitete, ngriti burgje, dënoi intelektualë dhe gjuha u trondit. Për paradoks ia arritën që ta standartizonin, ja ashtu si te kombet e kulturuar, por me dëme, njërin nga dy dialektet e shqipes e shmangën, hoqën *paskajoren*, gjuha po ngurtësohej si e statujave të heronjve, u bë shumë politike, orwelliane si te distopia e "84" së tij, që tek ne donin vazhdimisht të përsëritej veç ai vit.

Në 1984 unë vazhdoja të isha në burg me plot të tjerë të dënuar për fjalën, me pranga, me gjyq të rreptë, me heqje lirie e heqje të së drejtës elektorale, të së drejtës së botimit dhe me punë të detyruar si skllevër në miniera, më i rëndë se ferri dantaesk. Dhe akuza kundër meje ishin poezitë e mia.

CENSURË BARBARE
OSE SHTETI I DIKTATURËS OSE BURG U IM

Censura në vendin tim nuk ishte institucion më vete, Cnuk kishte ngrëhinë me shefa dhe roje, por ishte shteti, institucionet e tij të gjitha, veçanërisht Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë bashkë me Shtëpinë Botuese Shtetërore, një e vetme ishte dhe në kulturë sundonte Metoda e Realizmit Socialist.

Janë dënuar libra ashtu si autorët e tyre duke i burgosur dhe ato në fondin e zi të bibliotekave, bodrumeve, por edhe duke i asgjësuar, duke i çuar në fabrikat e letrës dhe bashkë me kashtën i kanë hedhur në gojë të përbashkët të makinerive për të ricikluar sërish në letër të bardhë si harresa. Ndërkaq janë pushkatuar dhe shkrimtarë ose kanë vdekur burgjeve.

Krahas shkrimtarëve dhe librave, në rrezik permanent ishin dhe lexuesit.

Sot e kuptoj mirë se për një që do të shkruajë e të mos lejohet të shkruajë siç do, të mos botojë dot, të mos flasë i lirë, do të thotë në fund të fundit të jetojë i ndarë nga vetvetja, pa fjalën e tij, i përjashtuar nga gjuha, edhe nga jeta.

Historia e letërsisë është edhe histori e ndëshkimit të fjalës, që nga Greqia e lashtë kur Eskili zgjodhi të mërgojë në Sicili për të mbrojtur vizionin e tragjedisë si çështje universale, kam shkuar andej në gjurmët e teatrit të tij, më pas nga Ovidi i dëbuar në skajet e Perandorisë Romake, në Kostanca në Rumani, ku unë kam çuar lule te shtatorja e tij, te Dante i përjashtuar nga qyteti i vet, në Firenze, ku kam ledhatuar mermerin e tij, nga librat e djegur në sheshe, poeti Heinrich Heine paralajmëronte: "Aty ku digjen librat, në fund do të digjen edhe njerëzit" e deri te diktaturat moderne, në burgjet pa mure sot, me propagandën dhe antireklamën dhe heshtjet e qëllimshme, etj, etj, apo me nostalgjinë për të kaluarën socrealiste.

Shteti, kur unë, student, nisa të shkruaj, i kishte ndarë shkrimtarët si gjithë shoqërinë me luftën e klasave: në shkrimtarë të vetët që me fjalën e tyre mbështesnin shtetin, bënë propagandë duke marrë privilegje, lavdi dhe përkthime në gjuhë të tjera, ndërsa të tjerë, ata, që shteti s'i pëlqente dhe as ata shtetit, lireshin pa përkrahje, në heshtje, pa mundësi botimi dhe kur guxonin të bënin ndonjë vepër me dy kuptime, me aludime si kundër, apo të flisnin të pakënaqur, dënoheshin.

Dhe dënoheshin jo vetëm nga organet e policisë politike të shtetit, por dhe nga shkrimtarë të tjerë, madje më parë nga ata, kështu u kalua dhe pragut më i errët etik, shkrimtari u vu në shërbim të ndëshkimit të shkrimtarit, fjala e njërit kundër

FJALA E
MOHUAR
ose fjalë për
fjalën time

Nga Visar Zhiti

FJALA E VISAR ZHITIT NË REVISTËN VENECIANE

Revizta e madhe italiane, "La Biennale di Venezia" Rme nëntitull "Alfabeti/Alphabete", tresimestrale, e Artit, Arkitekturës, Kinemasë, Dansit, Muzikës, Teatrit, Modës, numrin e parë të këtij viti, të porsa dalë, ia kushton "Parola" - Fjalës në letërsi, në kimema, në muzikë, fjalës së Inteligjencës Artificiale, etj.

Drejtori i revistës, Dr. Luigi Mascheroni, çështjen e "Fjalës së Mohuar" ia kërkoi shkrimtarit tonë Visar Zhiti. Shkrimi u mirëprit dhe u botua në revistë jo vetëm në gjuhët italiane dhe angleze, por dhe në origjinalin në shqip. 8 fletë të shoqëruara me fotografitë artistike nga Shqipëria të fotografes gjermane Jutta Benzenberg.

E botojmë shkrimin me lejen e Revistës "La Biennale di Venezia - Alfabeti/Alphabete".

fjalës së tjetrit.

Dhe pati shumë që heshtën para kohe. Ndoshta ishte ajo heshtje si formë e përmbysur pushteti. Michel Foucault na kujton se pushteti nuk vepron vetëm duke ndaluar, por duke prodhuar heshtje, duke vendosur se kush ka të drejtë të flasë dhe kush jo.

Akuza kundër meje pati si objekt poezitë e mia, "të trishtat, hermetike, kundër Realizmit Socialist" dhe u formulua nga antarë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Realizmit Socialist. Ata, më parë se gjyqi, më cilësuan "armik". Sigurimi i Shtetit më vuri prangat ndër duar. Pra, nuk duhej të shkruaja më.

Në qelitë e hetuesisë, më hermetike se poezitë e mia, nuk lejoheshin as letra dhe as pena. Qenia ime ishte e mbyllur, koha e pakohë kishte ngrirë. Që të mos zhbëhesha i gjithë, të mbijetoja sado pak shpirtërisht dhe mendërisht, nisa të bëj poezi. Si? E pamundur... Me mend, varg pas vargu. Fjala njerëzore e poezisë ekzistonte vetëm për aq kohë sa unë i mbaja mend ato. I kam treguar në librat e mi që i kam quajtur *burgologji*. Te fjala ime isha ende njeri. Madje përçudnueshëm i lirë. Nuk ishte më estetikë; ishte mbijetesë. Qendresë për të mos u shndërruar në numër, në dosje, në fajtor abstrakt. Dhe e kuptova, në jemi të përbërë nga lënda e fjalës.

Dhe më çuan në burg me të tjerët, mbaroi vetmia e fjalës së heshtur, fjala u bë turmë e dënuar, që s'mund të thoshte dot asgjë, veç zhurmë e britma e dhunë e madhe.

Aty mësova se më parë shteti im i kishte dënuar mjeshtrit e fjalës time, në burg kishin vdekur romancierit i parë shqiptar, ai



që botoi në fund të shekullit XIX romanin "Marcia", Dom Ndoc Nikaj, plak 86 vjeçar, në burg kishte vdekur dhe tragjediani i parë, Ethem Haxhiademi, pas burgut në internim do të vdiste shkrimtarja e parë grua në letrat moderne shqipe, Musine Kokalari, e lauruar në Universitetin "La Sapienza" në Romë. Do të pushkatoheshin poetët e rinj Trifon Xhagjika, dy miqtë Vilson Blloshmi dhe Genc Leka dhe do të ndodhte që një bashkëvuajtësin tim, me të cilin kisha shtyrë vagonat në burg, që shkruante edhe poezi, Havzi Nelajn, do ta varnin në mes të qytetit të tij, në Kukës. Dhe do të ishte varja e fundit në të gjithë Europën Lindore.

Ndërsa në muret e burgut kishte shumë parrulla, të shkruara me të kuqe, fjala "armik" me të zezë. Njëra nga ato më acaronte së tepërmi: "Në dënojmë ata që veprojnë keq, që flasin keq, që mendojnë keq". Pra mendon ti se unë mendoj keq, - bërtisja brenda vetes

Dhe guxoja të shkruaja poezi fshehurazi. Në kamp lejohej një fletore dhe një stilolaps, mund t'i bëje letër familjes një herë në muaj, e kontrolluar patjetër, zarfi dorëzohej i hapur dhe mund të shkruaje denoncime sa të dojë në komandë, pra shtetit. Këtë mundësi e përdorëm për të shkruar poezinë tonë, madje edhe romane. Denoncim ishte dhe ajo, mbase për të ardhmen, nëse do të kishte. - Ti, s'dihet, mund të vritesh në minierë, je i ri kët e s'di të punosh por duhet të shpëtojë poezitë e tua, - më tha shoku im më i ngushtë në burg. Duhej shpëtuat fjala. Është më e rëndësishme se ne. Një tjetër më tha se dikush duhet t'i dëshmojë këto, je zgjedhur ti... U trondita edhe duke u ndërgjegjësuar rrezikshëm.

Ia jepja fletoret e poezive me cenatit tim shpirtëror, H. B. Shokë më të besuar do t'i mësonin përmendësh. Ne krijuam kështu dhe lexuesin klandestin. Ata dinin dhe si t'i fshihnin dhe ku, në kashtën e dyshekut, në thasë, në këpucë, nëntokë deri sa dhe unë, më pas u specializova, u bëra kontrabandist i poezive të mia, arrita t'i nxjerr jashtë telave me gjemba. Në fakt kjo është dhe një pjesë e historisë së fjalës tonë të mohuar.

Dhe zbulova se shkaku i vërtetë që po shkruaja, nuk ishte thjeshtë lënia e dëshmisë apo shpikje të lirisë time, por krijimi i emocionit të gjallë dhe të bukur me fjalën e ndaluar, në ato çaste nuk isha i burgosur, por së brendshmi si të gjithë ata që shkruanin kudo, në Tiranë a Romë a Venecia, në Paris, Moskë a Tokio a New York, isha ai për të cilën isha dënuar, poeti.

GJUHA DHE THIKA
- intermexo -

Unë nuk e gjeta në burg Dom Mark Hasin, por historinë e tij. Është metafora që i zbërthen të gjitha. Priftin e torturonin në qeli. Folë, i ulërinte shefi i lartë i hetuesisë. S'do të flasësh? Ai kërkonte me doemos t'ia nxirrte fjalën, jo si një lutje, por që ta thyente, ta përdhoste. Prifti heshtëte. Mbronte fjalën. Liturgjinë e saj. Dhe s'donte të gënjente se gënjeshtër është forma e ulët e bashkëpunimit.

Nxirrjani jashtë gjuhën, me zor, - bërtiste hetuesi. Dhe policët ia nxorën gjuhën nga goja, ia shtrinë, aq sa mundej mbi tryezën e torturave. Shefi mori thikën dhe ia nguli mbi gjuhë. Ka ndodhur vërtet. Thika dridhej. Edhe unë që dëgjoja. Ishte dora e shtetit që ushtronte torturën mbi verbën. Pushteti donte të ishte sovran mbi kuptimin, vendoste ai dhe se çfarë të kuptonim e çfarë nuk lejohej të nënkuptohej. Ishte shtetëzuar fjala. Goditej kështu mundësia për të thënë të vërtetën.

Gjaku i gjuhës kishte përgjakur gjithë letrat shqipe.

Vetëcensura që vjen më pas, është më e keqe se censura. Mbase më e rëndë se të mos flasësh. George Steiner thoshte se barbaria fillon kur gjuha degradohet ose ndalohet. Heshtja e imponuar është shndërrimi i poetit në objekt, - në statujë mbi varrin e tij, - dua të bëj krahasime si formë e kundërshtisë. Shoqëria kështu humbet një ndërgjegje. Vdekja e fjalëve, - do ta quaja.

Megjithatë fjala e mohuar ka një paradoks, ajo mbijeton. E ndaluar fiton intensitet. Heshtja e detyruar e bën fjalën më të rëndë si copa toke, më të ngarkuar me kuptim si rrënjët. Fjala nuk mund të vritet, pa u vrrarë njeriu, mendoja në burg. Po edhe atëherë, fjala mbetet.

Diktatura ka frikë nga fjala, sepse fjala krijon botë. Dhe pushteti totalitar nuk duron botë paralele, por një gjuhë të vetme, një kuptim të vetëm, një të vërtetë të vetme, ato të tijat.

Kështu thika mbi gjuhë nuk e mbylli gojën e kohës. Përkundrazi. Buzët e përgjakura të fjalës kanë më forcë ardhmërie.

Kur kërkohet të ndalohet fjala ende, poeti, dhe jo vetëm ai, përjeton një lloj mërgimi të brendshëm. Hannah Arendt e quante këtë "privim nga hapësira publike e kuptimit", një gjendje ku ti ekziston, por nuk lejohet të jesh.

Fjala është kujtesë, paralajmërim, kur është dhe poetikë, shpesh është dhe lutje, arrin qiejt. Fjala është mënyrë e shenjtë të ekzistuarit në botë.

FJALA NË TRANZICION DHE DËNIMI ME LIRI.

Pas rënies së perandorisë komuniste, në vendin tim erdhi një letërsi tjetër, jo që të zëvendësonte letërsinë e mëparshme siç u trembën, por që të sillte vetveten, atë që mungonte, fjalët e të vërtetave dhe të moralit.

Primo Levi shkruante se ai që ka parë fundin e njeriut, ka detyrë të flasë me saktësi, jo me urrejtje. Fjala pas traumës ka rëndësi dhe detyra të tjera.

Edhe unë desha të flas pa tranzicion dhe me romanet e mia. Poetët janë ligjvënësit më të mirë, është një thënie dhe unë desha të mos e tradhtoj fjalën as në parlament, kur më zgjodhën deputet. Dhe si ministër kulture një nga gjërat e parë që bëra ishte nderimi i fjalës së mohur, një pllakë mermeri në shtëpinë e shkrimtares disidente "Musine Kokalari - Shkrimtare" se ia kishin mohuar si dhe një pllakë tjetër në burgun e Tiranës, ku më kishin mbyllur dhe mua dikur, "Të kujtojmë fjalën e lirë të atyre që u burgosën dhe u vranë për atë..."

A ndryshoi fjala jonë në liri?

Trauma e burgut na mësoi se fjala nuk është kurrë neutrale. Ajo edhe plagos, edhe shëron plagë. Dhe kur fjala ka kaluar përmes ndëshkimit, s'mund të jetë më e pamatur. Ajo e di që kushton dhe një metaforë e lirë, një mendim i pavarur, një "jo" e thënë në kohë.

E mirëpritën fjalën tonë? Lexuesi i shumtë po, dhe me mall. Shkrimtarë të Realizmit Socialist jo dhe aq. Kritikë të tyre edhe sot e sulmojnë fjalën e dalë nga burgjet, sidomos kur ajo është poezi e bukur, roman, të cilat dhe po udhëtojnë nëpër botë si kurrë më parë.

Giuseppe Ungaretti e quante poezinë "akt dashurie ndaj jetës, edhe kur ajo është e rrënuar". Sipas meje, thosha, poezia e bën të gjitha fjalët sinonim të fjalës "të dua", si sentiment dhe si etikë. Të duash do të thotë të mos mashtrosh me fjalën, të mos dhunosh me fjalën, të mos heshtës para asgjëje.

Apeli im për brezat e rinj, nëse do të më kërkohet, është i thjeshtë: Duajeni fjalën dhe ruajeni!

Nëse mohimi dhe ndalimet janë më shumë rreziqe të së kaluarës, rrezik i të tanishmes është dhe fjala e shpërdoruar, një lloj dënim i rafinuar në një botë ku askush nuk të ndalon të flasësh, por askush nuk të dëgjon më.

Ta ruajmë fjalën aty ku lind, në tallazet e shpirtit, në dashuri e tragjedi.

Fjala që i mbijetoi mijëvjeçarëve, luftërave, shfarosjes së popujve, diegies së bibliotekave, censurave të diktaturave, dënimeve, burgjeve, nuk duhet të humbasë nga pakujdesia jonë, nga komforti, teprica e algoritmit dhe teknologjia mahnitëse. Zhvillim jo zëvendësim. Asgjë tjetër s'e krijon fjalën dhe as e shpëton atë përveçse njeriut, besoj, me teknologjinë në ndihmë të tij dhe jo në dëm të tij.

T'ia besojmë fjalën Inteligjencës Artificiale për ta mbajtur gjallë bashkë ashtu si në burimin e saj ontologjik, në shpirt dhe në përvojën njerëzore. AI kursesi nuk duhet përdorur si mekanizëm i humbjes emocionale, si errësim i kuptimit, në shërbim të harresës njerëzore. Integritetin semantik dhe etik i fjalës është dhe shprehje e vetëdijës dhe e përvojës së mendjes së gjallë dhe ashtu të mbetet, e pacënuar dhe le ta çojmë të përpunohet në teknologjitë e sotme marramendëse, ku dhe trajtohet thjeshtë si e dhënë (data), të shërbejë si librat në bibliotekë, edhe si guidë, etj, por gjithsesi të mbetet si komunikim i gjallë, histori dhe frymë dhe puthje e së ardhmes.

Fjala krijon realitet. Dhe realiteti pa etikën njerëzore mund të kthehet sërisht në forma dhune nga më modernet. Fjala nuk kërkon hakmarrje. Ajo kërkon dritë, atë dritë ku njeriu mbetet njeri. Në vendin tim edhe sot njerëzit përshëndesin njëri tjetrin ose urojnë: *Ta dëgjofsha fjalën e mirë!*

E para ishte fjala. Ajo do të jetë dhe e fundit pas nesh, e kthyer në vepër, me etikën e dritës.

P.S.

Gjersa burgun e bëra unë dhe jo ndonjë robot për mua, edhe këto fjalë për fjalën time i shkruajta vetë, pa ndihmën e AI dhe poezitë e mia do vazhdoj t'i shkruaj po vetë ashtu si dhe plagët e mia që dhëmbin jo mbi kompjuter, por në trupin tim dhe shpirtin tim. Këtë do të thosha dhe për dashurinë...

Anatomia e Intuitës: Leximi si një Aftësi e të Menduarit Kritik

Nga Artan Nati



Në një bisedë me një pedagog, njeri me diploma, eksperiencë akademike dhe biografi që kalon nga auditorët e komunizmit te universitetet amerikane, doli në pah një fenomen shumë më interesant se vetë politika: fakti se njeriu mund të ndryshojë kontinentin, sistemin dhe pasaportën intelektuale, por jo domosdoshmërisht mënyrën e të menduarit.

Ai tregonte se në kohën e komunizmit e kishte përjetuar vdekjen e Enver Hoxhës dhe më pas rënien e regjimit si "fundin e botës". Ishte bindur plotësisht se sistemi ishte i përjetshëm, i drejtë dhe i pazëvendësueshëm. Madje fajësonte edhe shkrimtarë si Ismail Kadare, sikur letërsia t'i kishte bërë "lavazh truri", ndërsa propaganda shtetërore paska qenë thjesht dekor urban.

Më pas jeta e çoi në Shtetet e Bashkuara, vendin e pluralizmit, universiteteve, debatit publik dhe konkurrencës së ideve. Mund të mendohej se aty do të lindte skepticizmi, nuanca, kultura e pyetjes. Por jo domosdoshmërisht. Sot ai ishte po aq absolut në bindjet e reja: 100% për Trumpin, 100% republikan, pa asnjë gram dyshim, sikur kishte ndërruar vetëm flamurin mbi ndërtesë, jo mekanizmin brenda kokës.

Kjo ngre një pyetje të pakëndshme: a është e mundur që një njeri me shumë dituri të mos ketë mendim kritik? Përgjigjja e shkurtër është: "po, krejtësisht e mundur".

Sepse dituria dhe mendimi kritik nuk janë e njëjta gjë. Një njeri mund të ketë lexuar shumë libra, të ketë marrë diploma, të njohë teori komplekse dhe prapë të mendojë në mënyrë dogmatike. Mund të jetë ekspert në një fushë dhe njëkohësisht besimtar i verbër në politikë.

Universiteti të jep njohuri, nuk të garanton liri të brendshme. Diploma të mëson metodë, nuk të shpëton gjithmonë nga nevoja psikologjike për idhuj.

Studimet jashtë vendit të ndryshojnë adresën, jo automatikisht strukturën mendore.

Në shumë raste, njerëzit që janë rritur në sisteme autoritare nuk kërkojnë domosdoshmërisht të vërtetën kur dalin prej tyre, kërkojnë "një autoritet të ri". Nga udhëheqësi i djeshëm te lideri i sotëm, nga ideologjia e vjetër te narrativa e re, por me të njëjtin refleks: bindje totale, kamp i qartë, armik i përcaktuar.

Pra nuk ndryshon gjithmonë përmbajtja, por forma e besimit.

Kjo ndodh sepse mendimi kritik është i lodhshëm. Kërkon të pranosh pasigurinë, të dyshosh edhe tek ata që pëlqen, të pranosh se "ana jote" gabon, të jetosh pa profet. Ndërsa fanatizmi është komod: të jep identitet, ekip dhe përgjigje të gatshme.

Në këtë kuptim, rasti i pedagogut nuk është paradoks personal, por simptomë shoqërore. Shqipëria dhe diaspora jonë kanë plot njerëz të arsimuar që ndryshuan sistemin, por jo refleksin e nënshtrimit ndaj narrativës së fortë.

Ata dikur besonin verbërisht se Enveri ishte shpëtimtar. Sot mund të besojnë verbërisht se një figurë tjetër është shpëtimtare. Dje brohorisin parullën e radhës, sot shpërndajnë memen e radhës.

Me pak fjalë: njeriu mund të largohet nga diktatura, por diktatura jo gjithmonë largohet nga mënyra si ai mendon. Dhe kjo është arsyeja pse arsimit i vërtetë nuk matet me diplomë në mur, por me aftësinë për të dyshuar edhe kur je i sigurt.

"Përvoja nuk është ajo që të ndodh, përvoja është ajo që bën

me atë që të ndodh." Kjo fjali duket e thjeshtë, por për shoqëri si e jona është pothuajse revolucionare. Sepse ne kemi pasur talent historik për të kthyer ngjarjen në mit dhe vuajtjen në identitet, ndërsa më pak talent për ta kthyer përvojën në urtësi.

Rasti i pedagogut të përmendur më herët është ilustrues. Atij i ndodhi komunizmi, rënia e tij, emigrimi, universiteti amerikan, pluralizmi, liria akademike. Një biografi që në teori duhet të prodhonte nuancë, skepticizëm dhe mendim kritik. Por në praktikë, ai doli nga një besim absolut për të hyrë në një tjetër. Nga bindja totale te sistemi i djeshëm, në bindjen totale te kampi i sotëm.

Pra, përvoja ndodhi. Por çfarë bëri ai me të?

Mesa duket, e përdori si garderojë ideologjike: ndërroi kostumin, por jo qëndrimin e trupit. Nga "Partia ka gjithmonë të drejtë" te "kampi im ka gjithmonë të drejtë". Nga udhëheqësi i vjetër te lideri i ri. Nga parulla e murit te slogani i rrjeteve sociale.

Kjo nuk është përvojë e përpunuar, por është biografi e pa metabolizuar.

E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me një të persekutuar të sistemit që mbetet stoikisht i djathtë, jo si zgjedhje e arsytuar konservatore, por si reagim identitar i ngrirë. Ai nuk thotë: "Kam analizuar parimet, programet dhe institucionet." Ai thotë në heshtje: "Më kanë bërë keq ata, prandaj unë do të jem përgjithmonë kundër gjithçkaje që më kujton ata."

Është njerëzore, por jo domosdoshmërisht e mençur.

Sepse vuajtja nuk të jep automatikisht urtësi. As burgjet, as internimi, as emigrimi, as universiteti prestigjioz. Të gjitha këto të japin material. Çështja është nëse prej atij materiali ndërton karakter, apo thjesht monument ndaj vetes.

Shqipëria ka plot raste të tilla: njerëz që kaluan ferrin dhe dolën prej tij me dinjitet, por edhe njerëz që dolën me një urrejtje të konservuar në kavanoz. Të parët e kthen dhimbjen në matur. Të dytët e kthen në flamur.

Një shoqëri e pjekur i respekton viktimat, por nuk i shpall automatikisht filozofë. Sepse të jesh i persekutuar nuk të bën domosdoshmërisht të drejtë për çdo gjë. Të jesh profesor nuk të bën imun ndaj dogmës. Të jetosh në Amerikë nuk të jep mendim kritik dhe iluminim.

Mendimi kritik lind kur njeriu pyet veten:

A po zgjedh unë, apo po reagoj ende ndaj së shkuarës?

A jam besnik ndaj parimeve, apo ndaj plagës sime?

A kam bindje, apo thjesht kam kundërshtar?

Kjo është diferenca mes njeriut që përdor përvojën dhe njeriut që përdoret prej saj.

Në fund, jeta na ndodh të gjithëve. Disa e kthejnë në mençuri. Disa në fanatizëm me CV të pasur. Dhe ne, si komb, rrezikojmë ta kthejmë në talk-show të pafundshëm si "Big brother".

Demokracia jeton pikërisht nga kjo diferencë. Një regjim autoritar ka nevojë për njerëz që përsërisin. Një demokraci ka nevojë për njerëz që pyesin. Diktatura e adhuron klasën e heshtur; republika ka nevojë për klasën që ngre dorën dhe thotë: "Po pse?"

Si të mendosh, jo çfarë të mendosh. Pyetja është e thjeshtë: a duam qytetarë që mendojnë, apo tifozë që brohorasin? Në varësi të përgjigjes, do të kemi ose demokraci funksionale, ose sezonin e radhës të teatrit politik shqiptar.

Dashuria heshtje

Nuk dihet mirë ku mund të çojë
një histori dashurie,
qoftë ajo e vërtetë
apo brumë për të gatuar
histori të pafundme,
histori vrasjesh,
xhelezie,
larje hesapësh,
çmenduri me rrahje dhe plagë
madje dhe një dënim me burg
për dhunë

Historitë e dashurisë mund të jenë të hidhta
medet
dhe të mbyllen keq
Por do besuar te mrekullia
e rrallë
do ngritur lart e më lart
ideali i dashurisë së marrë
- e marrë sa të mos e mbërrijë kurrë
një ideal që pa dyshim nuk ekziston
sepse kështu shkon jeta
mbi varkën e vet të lëkundshme
- urë lundruese zhytur në Loire
nën vështrimin përqeshës të një geri
(ama pa teprime humori të zi)

Dashuria
është thesari i librave
Ana Kaernina e Tolstoit
Ema Bovari e Floberit
por dhe *Fragmentet* e Roland Bartit

Poezia nuk matet dot me vepra të tilla
po u kënaq me nishane pëlqimi
për të cilat trupi sajón maska lojcake
Poezia nuk do katandisë vetëm te brengë e dashurisë
as te humbja e saj e paepur që lyp heshtje të madhe
as te yçklat e "shtërzimeve të zisë"
ku stërhollimi i fillit bëhet urtësi për thurje
me vargun e vajtojcave nga pas

Heshtje
po heshtje
se harku i dashurisë
shpesh kthehet në bumerang

Heshtje
po heshtje
se qelqet e përshkuara nga liria
thërmohen
kur dëgjojnë vaj
të rremë


Po dashuria është shkenca e heshtjes
dhe shkëlqimi i valles
para qeshjes me shpirt
që mbytet
nga pahijeshia e lëkundshme
dhe nga dukja e vrazhdë

Dashuria në pikturë

Maria Desmée

Në monotipin e copëtuar
të Maria Desmée ne dallojmë
diellin e vijëzuar me anë gërmimesh të errëta
në një garë të shumëfishtë
ku dashuria nisat në shumë pista
njëherash

Në qendër të hapësirës është një zjarr
ku piktorja
fshehtas
detyron botën të pranojë
bojën blu të jetës së vërtetë
që shpërthen
për t'i dhënë mbijetesë
një lumi të dorëzuar
te kallamat e pritjes
dhe te bishtat e ditës
ku përndritet nata.



Daniel Leuwers

Përktheu nga origjinali:
Besnik Mustafaj

Daniel Leuwers (1940) është një emër i veçantë në letërsinë e sotme franceze. I njohur kryesisht si poet, ai është po ashtu autori i konceptit të "librit të varfër", që kupton shtypjen e poezisë në libra të vegjël e të lirë, me qëllim përhapjen e saj me lehtësi. Deri edhe botuesi kryesor francez, Gallimard, e mori këtë koncept të suksesshëm për ta përfshirë në katalogun e tij.

Por vepra e Daniel Leuwers është e gjerë dhe shkon shumë përtej poezisë, duke përfshirë prozë, udhëpërshkrime, eseistike. Ai është po ashtu President i AICL (Association Internationale de la Critique Littéraire) Shoqata Nderkombëtare e Kritikës Letrare.

Dhe ja xixëllonjat
frymojnë emocionin tonë
dhe zgjasin dëshirën tonë për vazhdim
me një forcë
plot shkëlqim
plot ngazëllim
ku imazhet humbin
në padallueshmërinë e gjirisë së tyre të fshehtë
dhe për hirin e flatruar
të një hovi shumëfish

Merret vesh atëherë
se piktura është një mbështetje
që shpreh më tepër nga ç'mund të shprehë
në plogësthinë e vet figurative,
për të shpaluar pasigurinë e dashurisë së pagojë
ku e thëna dhe e pathëna
bartin ngushticat e dëshirës

Harresat dhe parajsat

1. Romantizmi i vjetruar

Gjithë çfarë kërkon
është brenda teje
dhe vjen veç përmes fjalësh
të rrëmbyera
të copëtua
herë – herë me shkëlqime qartësish të befta
O në gji ngjyrash që veniten
që treten
tek hera – herës lëshojnë xixa.

Dhe befaz dielli na verbon
na mirëpret i vogli port italian
në shtëpinë e lartë terruar nga krimi
pse lindur si njëri dhe tjetri në skaj të një vije
na thonë të pakalueshme
po ne s'i dëgjojmë dhe ecim mbi det
deri në frymën e fundit
deri në zgjim në krahë të njëri – tjetrit

Dhe kështu gjallojmë ne
gurë më gurë
në molin ku dynden gaforret
drejt butësisë së pafund të dy mindilave tanë blu
nderur mbi rërë

2. Kopsht

Kopshti bën gjumin e pasdrekës
zogjtë sajónjë orkestrën

Rosakët coptojnë zambakët
dhe i shkulin kohës pezullinë

Mbyllin sytë
për të parë si përhapet lumturia

3. Dashuria dhe harrimi

A gabojnë
dashnorët
kur ëndërrojnë për veten
një varrezë të përbashkët?

Kokat e tyre u prenë
dhe buzët e tyre u shqyen
mbi cumër

Mbeten
veç ca guralecë bojë hiri
në kuadratin e dashnorëve të mallkuar
ku as emrat nuk u janë gdhendur

Ata besonin gjithsesi te parajsja

4. Paul Celan në Tours

Ai doli nga Bukovina
për të kryer në Tours
Studime për mjekësi
dhe për të kundruar
për fare pak kohë
përgjatë Luarës
para se me bujtë në Paris
pastaj në Senë
që e mban në lesat e saj
me qëllim të gërryesh në qiell
"një varr që nuk i rri ngusht"

*Varg i Paul Celan në poezinë "Lointains".

...dashuria brenda së cilës
të gjitha dashuritë tjera gjejnë të folmen.
Kjo dashuri hesht.
-T.S. Eliot

I shoqi po flinte ende kur doli, në maje të gishtërinjve, për të mos e zgjuar. Kishin kaluar një natë të trazuar. Do të zgjohej pas gjysëm ore, kur të cingërronte zilja, e do të lante sytë në banjo me një "bëhet mirë", si çdo mëngjes. Do të hante vezën e zier që ia kish lënë në pjatën mbi tavolinë, do të kthente prapë në banjo për të larë protezën e dhëmbëve. Pastaj do të vishte çorapet, pantallonat, këmbishën e hekurosur, setrën që ia kish lënë mbi stol. Do të vinte mbi sy kapelën me strehë, do të mbathte këpuçet që ia kish lënë të lyera te dera, e do të dilte në punë si përditë, edhe këtë javë të fundit para pensionit. E kishin bërë këtë ritual bashkë me vite të tëra, pa menduar, ashtu si s'mendon njeriu tek merr frymë. Kishin vazhduar njësoj edhe kur kish dalë vetë në pension, veçse tash, në vend se të shkonin bashkë në punë, ndaheshin te fundi i rrugës dhe ajo shkonte në radhë të bukës. Por sivjet radhët e bukës po nisnin më herët. E ai bënte ende tetë orë punë. Fli ti edhe pak se dal vetë, i kish thënë një mëngjes. Neve grave s'na ngajnë. Kishin rënë në ujdi si rëndom me një shikim të zgjatur, pa shumë fjalë. Aty e tutje radhën do ta mbante ajo.


Fresku i nadjes së hershme të marsit e bënte përditë të mërdhijë në fillim. Po ta shpejtonte pak hapin, trupi do t'i ngrohej shpejt. Mirëpo, e vërteta është se i pëlqente ky fresk. E bënte të ndihej gjallë. Ia largonte pak mendimet e errëta, e kthjellonte. E i duhej në fakt të kishte mendjen, tek çapiste mbi gurnajën e çrregullt të rrugës, një herë i kish shkarë këmba dhe përpak s'e kish thyer qafën. Sa i mirë ky fresk, i bekuar qoftë. U përshëndet me dy fqinje nga rruga, pensioniste edhe ato që ishin nisur për bukë, dhe vazhduan rrugën bashkë. Shitorja e ushqimeve ndodhej atje tej në shesh. Radha e pritjes niste rëndom në këtë orë. Agu i mëngjesit kish nisur të përdrinte malet larg në lindje.

I panë burrat nga larg, sa pa dalur nga rruga tek udhëkryqi i parë, por vazhduan të trija pa ngurrur, pa e ndalur bisedën. Me ta, ishte më rëndësi që të mos dërgoje sinjale që mund të keqkuptoheshin. Si ta zëmë, të mos e ngadalësoje taktin, të mos nxitoje, ose, ruana zot, të mos bëje kthesë të beftë, a të mos zbytheshe në mes të rrugës. Se të qepeshin menjëherë, si rriqra. U kaluan pranë pa u vërejtur prej tyre. Një syresh po fliste në radiolidhje, të tjerët ishin mbledhur rreth tij sikur po prisnin një kumt a një lajm. Edhe burri mbas mitralozit mbi autoblindë ish kërrusur, si për të dëgjuar nga radiolidhja. Gratë bënë tutje pa e ndalur bisedën. Po flisnin për fëmijët e vet, si gjithmonë. Gara e pashpallur dhe krekosja ishin të vetëkuptueshme, asnjëra syresh s'ish kujtuar ndonjëherë që ta moderojë a ta kufizojë veten a shoqet e veta. Vetë fliste shpesh për vajzën, e cila studionte mjekësinë në kryeqytet. Me nota të shkëlqyera. E para ndër kursantë, profesori e kish lavdëruar para të gjithëve. Shoqet s'e vinin në dyshim. Edhe fëmijët e tyre ishin shumë të suksesshëm. Për djalin s'bëzante. As shoqet s'bëzante për të.

Radha s'që e gjatë si herave të tjera. Njëfarë stabiliteti, që s'dihej se sa do të mbante, sikur ish kthyer përkohësisht në treg. Arriti që të blinte jo vetëm bukë, por edhe vaj, kos e vezë, të gjitha në të njëjtën shitore. Sot s'do të priste më radhë. Por kafe s'pati, as sheqer. Në vend të tyre bleu çaj mali. E kishte shijen sapun, po hajt. Kur u kthyen prapë bashkë në shtëpi, autoblinda ishte ende aty në udhëkryq, por burrat me armë s'dukeshin kund. Dielli kish dalë lart mbi malet e lindjes, nga rruga e madhe përposh ndiheshin zhurmat e trafikut, e njerëzia po dilnin në punët e veta si çdo ditë.

Në shtëpi, vuri përparësinë në kuzhinë, ndezi radion, nxori bombolën e vajgurit, e nisi fërgesën. Djersiti qepët në zjarr të ulët, durueshëm, gjersa u praruan, pastaj u shtoi e specat e grirë. Sekretin ishte te temperatura e ulët. Sa ish e re, e kish shpirtin në fyt. Nxitonte gjithmonë, e shtonte zjarrin. Për drejt, qepët i digjeshin, ndërsa specat i ngelnin kërc. Gjithçka ishte më vështirë sa ish e re. I shoqi kthehej nga puna vonë dhe shikonte televizorin, ndërsa ajo duhej të gatuate darkën, të shtronte tavolinën, të mblidhte enët, t'i lante. Se pastaj prisnin detyrat e shtëpisë. Vajza ishte më ambicioze qysh fëmijë, por djali kërkonte mamin t'i rrinte mbi krye e ta mbante mendjen te librat. Ku ishin pastaj rutinat para gjumit. Furça e dhëmbëve. Pizhamet. Përralla para gjumit. Djali që ikte nga shtrati e i ulej të jatit në prehër, e ai që e llastonte dhe priste gruan që ta bindë. Gjithçka ishte më vështirë sa ish e re. Tash mund t'i djersinte qepët në zjarr të ulët, durueshëm, sa të praroheshin, e të priste sa të zbuteshin specat e grirë. Në radio nisën lajmet. Ora policore i kish ndalur trazirat. Elementet armiqësore ishin zbrapsur, por nga populli kërkoheshin syçeltësi e shtuar. Ajo shtoi në fërtere domate të grira, hudhra, rignonë, magdanoz. Aromat mbushën kuzhinën. Kur nisën flluskat e para, shtoi pak gjizë dhe pak djathë të bardhë, duke i pëzier me kujdes. Pastaj shtoi tri vezë, e i vuri fërteres kapakun sipër.

Kur doli për herë të dytë nga shtëpia, ishte mesditë. Kësaj radhe kishte me vete një shportë të vjetër, me bukë dhe me fërgesën në një kuti të vjetër plastike. Burrat me armë ishin kthyer te autoblinda e udhëkryqit. E mori autobusin që ndalej aty me kismet, në orare të çrregullta, pagoi për një



kahje, e u ul në ulëset e mesme. S'donte të ulej afër shoferit e fatorinos, të duronte shikimet e tyre kureshtare. T'i shihte tek i pëshpërisin njëri-tjetrit me vështrimin gjatë, sikur s'flisnin për të. Por s'e donte as fundin e autobusit, atje ku të shurdhonte zhaurima e motorit. Dy herë në javë e bënte këtë rrugë. Dy herë në javë kalonte në ferr por s'jipej, e mbante veten. Rruga i mirrte rreth një orë, se autobusi ndalej vend e pa vend për të marrë pasagjerë, sa herë që ia bënin shoferit me dorë, radhë burrash të parruar, matronash të djersitura, fshatarësh skaj rrugë që prisnin me thasë specash e pula të gjalla nën sqetull. Edhe kontrollet e policisë po bëheshin gjithnjë e më të shpeshta.

Gjithçka që më vështirë sa ish e re, por këso problemesh s'kishin. Problemet u nisën kur kalamajtë po mbaronin gjimnazin. Kishin ndryshuar kohët, ekonomia e kish marrë tatëpjetën. Edhe rinia kish marrë krye. Kishin nisur të dëgjojnë radiostacione të huaja, të lexojnë libra të ndaluar. Se ku i gjenin, athua. U plasi shamata edhe në shtëpi. Të shoqit iu kish bërë shprehi të komentonte lajmet, të shante haramët, hiçat, rrugaçët, degjenerikët e shturrur që prishnin dynjanë. Lajmet ishin bërë torturë. Dhe një natë, ndodhi ajo që do të ndodhte patjetër. Ajo që do të mund ta kishin parashikuar krejt lehtë, veç po të kishin qenë vetëm pak më të vëmendshëm, po të kishin interpretuar vetëm pak më saktë heshtjen e ndrydhur të fëmijëve. Djali ia kish kthyer fjalën të jatit. S'do ta harronte kurrë çehren e të shoqit tek dëgjonte fjalët e të birit. Na nxorët në dritë ju, ja mu kështu i tha. S'kemi liri. S'kemi punë. Presim në radhë për bukë. E ju, as na lini të ndreqim, as të ikim. Ti këndej "bëhet mirë", e andej punon për kriminelë. Ç'mut jete qenka kjo. Mirë që doli djali sa pa kaluar stepja, se dro që i shoqi do ta mbyste aty në vend, me duart e veta. Atë natë e tutje, u plasi sherri në shtëpi. Vajza u tregua e mençur, ulte kryet dhe shmangte të jatit gjersa iku për fakultet; ndonëse vërehej qartë se ku qëndronte edhe ajo, e shihte edhe qorri nga larg. Por ai dhe djali, uf. Shamata përrnatë. Shamata me zëra të ngulfatur, nga frika se mos i dëgjojnë fqinjët. Jo se kjo ndihmonte gjë. Kur grindjet bëhen më zë të ulët, fjalët bëhen më vrastare, të çjerrin e të shqyejnë më fort.

Zbriti në stacionin e fundit, në lagjen e evgjitëve, e përcjellë nga shikimet keqardhëse dhe pëshpërimat e shoferit dhe të fatorinos. Prej aty e gjer te ndërtesa e burgut ishin dy kilometra të tjera, të cilat i kapërceu kredhur në kujtime. Një ditë prej ditësh, i shoqi kish ardhur çehreprishur nga puna, për t'i treguar se ua kishin marrë djalin. E kishin pritur në zyrë mbas drekës dy veta në veshje civile, për ta njoftuar se djali po hetohej për veprimtari armiqësore. Natyrisht, atë e kishin flakur që të nesërmen nga bashkia, ku kish punuar për mëse dy dekada. Mezi kish gjetur një punë tjetër, si pastrues në uzinë të tekstilit. Kjo ishte java e tij e fundit para pensionit. Si do t'u dilnin paratë për ushqim të djalit?

Kur arriti te ndërtesa e burgut, iu desh të priste në një tjetër radhë të gjatë. Familjarët duhej të identifikoheshin secili me letërnjoftim. Ushqimet që kishin sjellë duhej kontrolluar një nga një. Emrat e tyre duhej të kërkoheshin në listën e vizitorëve të miratuar nga lart, pastaj të shënoheshin në një listë të dytë, me emër, mbiemër, numrin e letërnjoftimit dhe datën e lëshimit. Kjo procedurë strikte ishte detyrë e rojës së hyrjes, një burri që kish kryer vetëm katër klasë të fillores. Dora e tij e pastërvitur vuante nga ballafaqimi i

mundimshëm me tridhjetegjashtë germa të shqipes, e me radhët pa fund të numrave të letërnjoftimeve në gjithfarë kombinacionesh, secili më i vështirë se tjetri. Dhe për kë se? Për kë gjithë ky mund? Për radhë armiqsh të popullit, që kishin rritur e edukuar degjenerikët prapa grilave. Bah! Ajo mund t'ia shihte urrejtjen, si gungë në sy.

Djali kish pritur edhe ai sa ish lodhur në radhë për sallë të vizitave. U plandos si i prerë në stolin përballë. Asaj iu duk më i hajthëm se herave të tjera. Sytë i ishin enjtur. Në faqe kish shenja prerjesh, sikur kur gabon tek rruhesh. Një roje u rrinte si orl mbi krye. Si je bir, e pyeti. Mirë jam, tha ai me zë të ulët, si këtu më. Ti si je. Ajo s'ia doli dot të përgjigjej, nuk nginjej duke e parë të birin. Ai si është. Mirë është bir, të bën të fala. Sigurisht, ia ktheu i biri, e rrudhi buzët. T'i bësh të fala edhe ti. Të fala edhe nga jot motër, këtë javë e ka provimin final. Të ketë fat, i tha ai. Ta kryejë edhe atë provim që i ka mbetur, e pastaj të ketë durim a, se e pret radha për punë. Ajo mori frymë thellë. Pastaj e lëshoi frymën me një si fsharje të ndrydhur, pa zë. Ti si je nënë. Si mbaresh. Por nëna s'fliste dot. E shikonte të birin, kaq të ri, e kaq të pafat. Kaq të pashpresë. Fol nënë, si je. Nënë. Gruaja s'foli, por dora i shkau vetvetiu për t'ia hequr kaçurrelat të birit nga fytyra. Mos me dorë, thirri orli, nuk lejohet. Ajo u trand. Për një moment, për një çast të vogël e të bekuar mëshire, kish harruar se ku ndodheshin. Në atë palë të vocërr amshimi, ajo sa ish kthyer në shtëpi nga spitali me djalin e posalindur, e po e shtrëngonte fort në krahë, e po zgjaste dorën për t'ia prekur ballin. Orli e kish hedhur hijen e vet të errët deri atje. Në vend se ta përkëdhelte të birin, ia zgjati shportën me ushqime. Të kam sjellë pak fërgesë bir, të bëftë mirë. Duart e tyre u prekën rrëshqimthi rreth shportës dhe të dy ngelën pa frymë nga frika e orlit. Por ai u bë sikur s'i pa.

Më vonë, tek po prisnin në radhë për të dalë nga burgu, të gjithë familjarët ngjanin më fort në fatshkretë që po i shpënin në burg. Rojes së hyrjes i duhej ta përsëriste edhe një herë tërë procedurën. Familjarët duhej të identifikoheshin sërish me letërnjoftim. Emrat e tyre kërkoheshin përsëri në listën e vizitorëve të miratuar, pastaj shënoheshin prapë në një listë të tretë, atë të daljes, me emër, mbiemër, numrin e letërnjoftimit, datën e lëshimit. Të tridhjetegjashtë germat e lodhshme të shqipes, e radhët pa fund të shifrave në letërnjoftime, secili më e vështirë se tjetra, bëheshin mundësisht edhe më të mundimshme në fund të një dite vizitash. Dhe për kë se? Për kë gjithë kjo torturë? Bah! Për një radhë banditësh! Urrejtja, gungë në sy.

Ndërsa priste në radhë të autobusit, dielli po jipte shpirt në përdim dhe nata kish hapur tashmë kindet e errëta të pelerinës atje tej mbi malet e lindjes. Kish qenë ndër të fundit për të dalë, pra në fund të radhës së pritjes. Kaloi shoferin dhe fatorinon, që e përshëndetën me një gjest të heshtur, e vajti për t'u ulur tek ulëset e vetme të lira atje në fund të autobusit, ku të shurdhonte zhaurima e motorit. Autoblinda ishte ende tek udhëkryqi, burrat me armë po pinin kafe te një kafe përballë. Mitralozi i rëndë ish kthyer me grykën teposhtë, sikur i vinte turp se në ç'kohë i kish rënë hise të bëjë hije. Në të hyrë të rrugës, i hasi prapë dy fqinjët me të cilat kish ndenjur në radhë të bukës. Ndenji pak me to, s'kishte nxitim që të kthehej në shtëpinë bosh, i shoqi ishte ende në punë. Folën prapë për fëmijët e vet, si ngahera. Gara e pashpallur dhe krekosja ishin ende aty, pa moderim e pa kufizim, veçse në vëllim më të paktë, si të rralluara nga një ditë e gjatë. Po, ish dëgjuar me vajzën, po saktë ajo që studionte mjekësinë në kryeqytet. Me nota të shkëlqyera. E para ndër kursantë, profesori e lavdëronte rregullisht. Shoqet s'ia vinin në dyshim. Edhe fëmijët e tyre ishin shumë të suksesshëm. Për djalin s'bëzau. As shoqet s'bëzante për të. Dikur u lodh së prituri, e u përshëndet me to. Bleva sot çaj të malit, u tha, po shkoj ta provoj. Ato e shikuan një copë herë të mirë nën heshtje tek largohej, me hapa të vëmendshëm mbi gurnajë të rrugës. Pastaj u afruan kokë më kokë, e nisën të flasin për nën zë.

Kur i shoqi u kthye në shtëpi, hyri në maje të gishtërinjve, për të mos e zgjuar. Kishin lënë pas një ditë të trazuar. U pastrua në banjo dhe mbas pak u shtri, me një "bëhet mirë", si çdo natë. Pantallonat, këmbishën, setrën i kish varur mbi stol. E kishin bërë këtë ritual bashkë me vite të tëra, pa menduar, ashtu si s'mendon njeriu tek merr frymë, e tash befash kishin ngelur pa frymë. Vajza s'kthehet më, mendoi ai, e ka jetën e vet tash atje në kryeqytet. Iu kujtuan ato herë kur ajo kish heshtur e ish hequr mënjane, ndërsa ai e i vëllai grindeshin kot. E kishte shprehi një herë e një kohë që të komentonte lajmet me zë të lartë, që të shante haramët, hiçat, rrugaçët. Degjenerikët. Dhe një natë, ndodhi çfarë do të ndodhte patjetër. Djali ia kish kthyer fjalën. Ti këndej thua "bëhet mirë", e andej punon për kriminelë, ç'mut jete kjo. Saktë kështu kish thënë, ia kish plasur mutin në fytyrë. Vajza u tregua e mençur, mendoi. Heshti sa heshti dhe iku. Por djali, jo. Ai nuk diti të heshtë. E unë s'dita si ta mësoj që të heshtë. Dhe tash ai është atje ku është, e ne jemi këtu ku jemi. Pa frymë.

U ktheve, e pyeti ajo me zë të përgjumur nga krahu tjetër. Po, i tha ky, si e gjete. Ç'të them, ia ktheu ajo pa laujtur. M'u duk sikur kish rënë në peshë edhe më. Ai fshau. E ndali me zor radhën e fjalëve që i mëshonin me grushta në krahëror. Jo se kjo ndihmonte gjë. Kur fjalët heshtën, bëhen më vrastare. Të çjerrin e të shqyejnë më fort.

Pas kaq kohe, këto më kishin mbetur në mëndje, qesëndisjet e saj.

Fytyra e njerkes nuk ishte e vrazhdë dhe, sado të përipiej s' bëhej dot armiqtësore. Por mbi të gjitha dukej se zotëronte një shikim të regjur. Eh, belà, je te *njerka* dhe të përplasesh me të për këto që kemi nëpër këmbë, të del papritmas një tip që s't'i shqit sytë. Eri kaloi ndanë meje, pa më prekur por me një aromë mjaft ngacmuese - të lehtë dhe tërheqëse, ngurova pak, por vendosa t'ia jepja mirëmëngjesin atyre që sapo erdhën. Ajo më pa me bisht të syrit dhe kur vuri re që po afrohesha ndërroi pamjen, që do të thotë se vuri maskën e duhur. Hapat e mi tregonin vendosmëri. Sikur ta dija, më vinte së brendshmi zëri i saj, fundja-fundit nipi s'ka ardhur për sytë tanë të bukur, jo. Po kaq shumë isha mësuar me këto përplasje me njerken, sa që më fort më bëhej të luaja të kundërtën, ua kisha pirë lëngun, sikur s'ishin të vërteta ato thagma dhe mundoheshim gjithnjë të bënim jetën tonë, të dilnim në qafën ku donim. Ndërkohë njerka me kashtore të madhe u ngrit në këmbë, fërkoj ballin me një ndjenjë përcmimi që i dallohej menjëherë, po s' bëri përpara, sikur u gozhdua në vend. Unë më fort e shtova vrullin sa që edhe vetë u çudita, i thashë të na priste pak sa të merrja vesh diçka të paqëlluar. Ajo e shkarkoi tërë barrën nga sytë e saj, që doemos më pyesnin për gjërat e ujditura për mrekulli e që në dukje po ecnin vaj, por që ia ndjeva hakërrimën pas shpine.

Ishte ajo që prisnim. Nipi i njerkes u afrua gati ngjitur dhe më vështronte nga lart poshtë me një fodullëk fytes. Gjithë ai djalë! Kështu jeni ju, që kërkoni të bëni diçka të madhe, thoshin sytë e tij, sado t'i mbante fshehur, unë e zotëroja çelësin sol dhe zbrisja në fushëbetëje menjëherë... dhe kapërceva shkallët, pa e kthyer kokën pas. Ai u ul, pa marrë leje, tërhoqi me forcë karrigen dhe mbështeti bërlyat mbi tryezë. I ngriti syzet e diellit mbi kokë e më zbuloi fytyrën, sytë e ndezur, hundën me kurriz dhe vetullat e ngjitura hollë në mes, por me qime të gjata. Sërish u përpoqa të gjeja në fytyrën e tij ndonjë fshehje, sekret, brenda-shkrim të largët, po nuk munda. Për pak mbeta si në udhëkryq.

- Nesër më pret sekretari i përgjithshëm i infrastrukturës. Ora tetë. Ndërkaq ne sot do shqyrtojmë dy pika të errëta. Pa i hapur letrat, pa mbajtur shënime, pa tërhequr vëmendje...

Zërin e kishte të trashë, të njëtrajtshëm, pa emocione, të ulët dhe më tepër ngjante se pëshpëriste me një trishtim të dukshëm. Burrat erdhën menjëherë. Pse qesh? Ke ardhur për atë që duhet bërë dhe për këtë je i mirëpritur. Kemi për të zgjidhur dy pika dhe të jemi ballëhapur nesër.

«Për të zgjidhur dy pika delikate e të errëta, apo për të na njohur kush jemi. Se edhe kjo mund të jetë pikë e errët. Domethënë, a ta mbushim mendjen apo jo. Jam i qartë?»

«Jini shumë i qartë... Kupton?»

«Kuptoj. Më mirë s'ka si bëhet!...»

Gjëja përbrenda më erdhi me një gulç, sikur do t'më merrej fryma, po fytyra atij i kish ndryshuar shumë, sikur mbi të, fati, si të thuash, të kish shkrehur armën. E vlarë, e ligë, me një ngashënjim për zënkë e potere. Mirëpo në sekondë, u flashk, mbeti bosh; diçka e pakuptueshme, madje edhe e lodhshme. Por ne shpejt do ishim me *njerken* dhe ajo dinte t'i vinte stivë drutë, ashtu si duhet, si nuk kishin qenë ndonjëherë.

Projekti juaj është i kualifikuar, djem. Kjo nuk është përgjigje përfundimtare, por është portë e hapur. Dhe kjo, me gjuhën tonë ka rëndësi të madhe. Unë vetë jam shenjë pozitive. E nesërmja do të jetë formalitet. Siguria e pushtetit lokal gjithashtu. Prandaj dhe jam këtu: t'i shoh me qetësi dhe, edhe pse raportimi dihet, jam gati ta bëj këtë në syrin tuaj. Edhe pronari i parë, edhe siguria që jep prona e patundshme, edhe fisnikëria e treguar, mosha e re, prania e brezit tjetër, e kështu me radhë të gjitha! Jo, nuk bëj ndonjë punë konkrete, as zotëroj ndonjë profesion delikat apo edhe të molitur. *Unë vetëm verifikoj*. Ndoshta kjo punë që bëj më ka ndryshuar ca. Më kupton, e ndjen ku dua të dalë? Jo? Mos! Njerëzia, s'kanë bukë të hanë, s'kanë punë, mbulohen me turp. Ikin, nga sytë këmbët, duan të dalin andej. Kurse ne, qeveria, duam të jetë populli në vendin e vet. Se çdo bëjmë ne pa popullin?

«Pika e errët është droga...»

«Sikur ta dija! Përse duhet ngatërruar e gjithë kjo punë me drogën?»

«Askush nuk e ngatërron. Të mos keqkuptohemi. Por duhej nuhatur që këtu nuk bëhet fjalë as për hashash, as për kokainë, po për shtigjet që sigurisht kalojnë këtej. Për zgjatimin e banuar gjeografikisht, për lidhje të nëndheshme, ndonjë mini-port e të tjera si këto. Kaq. Asgjë tjetër, as e nënkuptuar. Prandaj erdha unë. Sepse e thashë, *unë verifikoj*.»

«Faleminderit që fole hapur. Unë dhe shokët e mi të mirëkuptojmë.»

E kuptova. Ai donte t'i kapte dhëmbi: a ishte e nënkuptuar droga? Fundja, ç't'i zinin duart e në kthim për në Tiranë, t'i vinte kokë muhabetit, të gjente ndonjë pikë të dobët, që ndoshta-ndoshta do të qe ndonjë pikë lidhëse për vete, të kërkonte të çara, të fuste spicat, që mund të qenë edhe «kontributi» i tij. Secila prej atyre hamendjeve mund të ishte problem, po edhe sikur të qenë në mendjen tonë, mos vallë do ta ndanim mendimin me të? Foshnjëri. Dhe një mendim të tillë foshnjarak ai do ta verifikonte. Mos kërkon një shuk të mirë me parà?... Ku? Si?...

«Më ka dalë nami për burrë bese. Po nga kjo ç'fiton? Asgjë! Pare gjaku e nderi. Po ç'të bëja? Të vjedh? Të vras? Moskurrë!



As ndër mend nuk e çon njeri. Vetëm faqja e bardhë dhe pare me nder...»

«Ke ndonjë mendim konkret? Folë hapur me ne! Ne jemi të tillë sepse jemi nisur të bëjmë punë të ndershme! Dhe sidomos në rregull me të gjitha ligjet e shtetit.»

«Unë kam parë skena të llahtarshme, sa e sa janë çmendur para syve të mi, po për fat askush s'ka vdekur, madje edhe lebetitje s'ka pasur ndonjëherë. Këto sigurisht bëjnë pjesë tek *verifikimet*. Ç'është e vërteta, kam fituar emër të mirë, po u more me mua, s'të gjen gjë...»

«Pa vazhduar më tej, ne kërkujmë me vendosmëri që supervizorin ta gjejë shteti, të vendit ose të huaj. Garanci për këtë japim ne, parashikuar në kontratë...» Fjalët u gdhendën bukur dhe erdhën në pikën e vlimit. Zëri qe i sigurt dhe bindës. Asnjë fjalë më tepër. Jo më kot Eri e ka zakon të të gjendet pranë atëherë kur duhet!

«Kontrata nuk është punë imja. Edhe supervizioni. Çështje eksperience.»

«Mirëpo kujt i duhej ajo paraqitje ndershmërie...?»

«Punë njohjeje.»

Nipi i njerkes, me zë të trashë e të brendshëm, sikur gëlltitej në grykën e tij, u duk se po mbyllej në guaskë. Për një çast mendova se mos ktheheshin punët së prapthi! Po, kjo më jepte një lloj vuajtjeje, se nuk i thonë shaka, të vjen me një qerre mend, thotë ca gjëra gjoja si kot dhe kërcet e ikën. Asgjë nuk thuhet kot! As përmendjet më të thjeshta nuk janë kot, kurrë! Kjo dihet! Njohjet fillestare këtë ballafaqim kanë, vendosen piketat e nënkuptuara për më tej. Ata e duan çdo gjë për klanin e tyre, për vete, për të qenë të sigurt ç'mund të garantojnë. Edhe të dua t'i lë këto mendime, s'më lë njerëzia që përditë ikën e ikën sikur i ndjek djalli. Ja ky jam unë. Ky është nipi i njerkes sime. Dhe në fund kjo është nëna njerke.

Ajo ngriti breroren e madhe dhe e vuri mbi kokë me dorën tërë nje, përmbi ballin e djersitur e tërë rrudha.

Më në fund u ngritëm nga kafja dhe u sheshuam në drekën e *njerkes*. Një dritë e çuditshme thellohej gjer dhe në rrobat e trupit. Diellin sikur e kishte secili prej nesh në xhep. I pëlqeu nipit kjo më ngë e perëndisë dhe u shtrua njësh me ne me zell të madh, ku me sa kuptova po sillte ndërmend sesi të fuste në vathë grigjen, pastaj të merrte pjesë në meshë dhe bënte gjithçka duhej, duke parë me vëmendje se e kish futur si duhet ujin nën rrogog apo jo. E pa mirë «guvën» ku u fut, e gjeti me vend të priste sesi do të vijonin punët, por e vetë-ndjera plot kënaqësi i teptiste në çdo kënd të fytyrës. Kujtoi se dreka po shtrohej për të, kur dihej se ajo ishte thjesht mbrothësia jonë. Askush ndër ne nuk i bënte kujt shenjë që ta ndiqte pas.

«Kam parë, s'kam parë, - tha, - po si ty, kaq të ri e kaq të dhënë pas lutjes s'më kanë zënë sytë! Kaq vjet që jam, kam kaluar nëpër duar lloj-lloj njeriu, ndaj dhe bëj çudi me ty, or nip.»

«Nuk është në hall, - i thashë. - Por, s'do që të shikoj!»

Nipit i erdhi keq dhe mbajti një fjalë të hollë për *njerken* time. Ajo po e shihte e çuditur dhe nuk e la ta çonte deri në fund ligjërimin.

- E ke mëmën, or bir?

- Jo nuk e kam, *emtë!*

- Duket.

- Si ta kuptoj këtë?

- Në sytë e tu ka shumë brengë!

Ai u turr. Një, në dorë, numërova dhe e mblodha dorën grusht. *Njerka* filloi ta shihte me kërshtëri tjetër.

- Këta këtej, biro, e numërojnë bagëtinë kur e nxjerrim nga vatha dhe po atë bëjnë kur e futin sërish në vathë.

Nipit në dukje iu bë qejfi. Por shpejt ranë kambanat e alarmit dhe ujët gurkali të shatërvanit në oborr filloi t'i krijonte larushi mbi fytyrë. Lojë drite kjo. Tjetër gjë. Dërrasat e dyshemesë kërcisnin sikur po u vinte fundi dhe herë-herë dëgjohej një gërvimë e mbytur. *Njerka* dukej si e gremisur, ndërsa më bëhej se rënkonte, aq sa dikujt mund t'i këpuste shpirtin.

- Ja, or bir, këto janë punët tona. Për drekë kemi vetëm këtë lakror. Ndryshe nga gjithë dynjaja. Ha, ngopu. Kështu është: dhëntë e dhitë e Zeres, nami i Kapllan Qeres, apo jo?- pyeti ajo.

- Po pse rënkon *emtë*, ç'të dhëmb?

- Atij që s'e ka edhe i dhemb, edhe e dëgjon dhimbjen...

- Ke ardhur duarthatë, bir! Nuk të vjen keq për ne pleqtë?

Ai mbylli sytë, u nxi i tëri. U mbush balli me djersë. Ndoshta i duhej një peshqir. I tregova me sy kartë-pecetat e mëdha. Vendi iu bë i përvëlur.

- Biro, të shtunave në mëngjes këndon qyqja. Atëherë prit.

Edhe po të vinte e shtuna ai nuk do ta kuptonte. Vura re se sikleti i tij s'kish të sosur. *Njerka* rrinte e përgjonte. Të gjithë e prisnin me ngulm çdo të nxirrte nga goja. Ajo dukej e frymëzuar, aq sa edhe unë, thjeshtri, e ndieja që kjo pamje s'ngjante me asgjë të mëparshme. Edhe ishte, po aq edhe mungonte pamja e zakonshme e mëndafshhtë si puhë që ngrihet lart, pastaj shumë lart mbi qiellin jashtë, në atë qiellin tonë, i përndritur prej të kaltrës së zakonshme. Atë çast nëpunësi i shtetit mori krahë, i vetëtiu gjetja ndoshta dhe nxori një zarf të fryrë.

- Atë fute nga e nxore, - tha *njerka*. Dhuratën e jep shpirti dhe jo kujtesa! Mbaje mend se po bëhesh burrë në moshë. Sigurisht je edhe djali im!

Ai u zverdh. Nuk e priste që ta qëndisnin me qesëndi të tilla. As parë e as dëgjuar. Pa nga unë dhe gjeti strehë.

- Pjesë e punës, - shtoi me ngut. - Apo jo?

Unë lëvizta kokën me mirëkuptim, por e hante atë *njerka*? Sido ajo bëri si bëri dhe e përtypi mendimin e egër që i buroi së brendshmi. Ndenji. Priti. Heshti.

- Dua të falem, - tha nipi.

- E kemi guvën këtu, - tha *njerka*.

Menaxheri, një mesoburrë i shkathët dhe një njeri i mbushur me batuta si fishekë gjahu, ndarë sipas llojit të gjahut, e çoi në guvë dhe aty mbeti vetëm për t'iu rrëfyer mureve. Ato pa dhe atë bëri. Vetëm belbëzoi. Zëri i thellë i dëgjohej si ofshamë. Muret e dëgjonin pa pipëtitë. Bishti i mjegullës mbeti aty dhe burri lëvizti, më pa mua, më shkeli syrin si diçka e zgjuar, duket për të dalë nga gjendja.

- Të jep bukë puna jote, or bir? - pyeti *njerka*.

- Më jep, *emtë!*

- Po ujë?

- Po. Nganjëherë edhe ndonjë sapllakë hirre, *emtë?*

- Asgjë më?

- Asgjë më.

- Kjo që bën ti, bir, ti qofsh, është në kundërshtim me urdhrin e shenjtë. Mos e bëj më!

- Pse?

- Se s'duhet të vuajnë urie pleqtë! Është mallkim! Sytë e qeverisë duhet të shohin pleqtë. A ka ngritur ndonjë shtëpi pleqsh qeveria? Kur kjo s'është puna e saj, as edhe e Zotit, e kujt qenka? Këtë e kanë ngritur djemtë, me djersë e me dhimbje të madhe. I di kush janë djemtë, ja këta që sheh zotrote? U dhembin pleqtë djemve tani. Avash-avash ne do mbetemi këtu se gjithë të tjerët po ikin. Ndaj dhe u kujtuan djemtë të marrin gjëra të mëdha përsipër, që t'i tregojnë qeverisë se ky vend e ka zotin dhe këta zota janë djemtë. Ata do të kthehen se e shohin që timonin e mbajnë plot siguri. Kjo pikë kthese, biro, kjo na duhet!...

Kurrë, kurrë ndonjëherë nuk e kisha dëgjuar njerken time (siç e shihni, kam shumë dëshirë t'i them ashtu siç e kam, domethënë *njerke!*). Fytyra i kishte marrë një ndriçim të bukur.

- E di, sigurisht që e di dhe ajo, qeveria, do ta gjejë zgjidhjen. S'ka ç'pret më!

- Ka ç'pret, or djalë, ka! E zeza dhe e keqja ka thellësi të pafund dhe nuk ka sy... A mund ta gjejë zgjidhjen me vdekjen që sjell mosha?

- Gjërat e bukura nuk bëhen vetë!

M'u duk se tani ai po e kruante.

Kjo do të ishte gjithnjë punë e tij. «Unë të them të mos vjedhësh mallin e tjetrit se Zoti shikon dhe ndëshkon, biri im. E ke të shkruar. Ti je vënë në provë, bir. Mos mëkato, dëgjoje fjalën e perëndisë...»

Muret nuk flisnin. Më në fund dreka u shkreh. «Nuk do të mëkatoj», tha nipi.


Po mbillej fara. Nuk merrnim dot frymë nga ankthi. Por, sekret, ankthi është pjesë e shërimit tim. Plumbi del me plumb...

- Qeni që leh nuk të ha, por qeni leh atje ku ha! - tha *njerka* dhe salla u mbyt nga të qeshurat që s'reshnin.

Edhe sot më jehojnë veshët. S'më shqitet nga mendja.

Tiranë, më 7 Nëntor 2025

Karikaturë nga Arben Mexsi



PËRPARIM HYSI

Krejt, rastësisht...

tregim

Malo Koçiu është miku im. Ka një dyqan ku tregëton vegla për mekanikë, hidraulikë apo elektrik dhe, kur ka një zëvendësues aty, në dyqan, vjen e shkëmbejmë ndonjë kafe. Ai e di klubin ku pi unë dhe sot, pas kaq kohësh, u takuam.

U takuam dhe unë e sulmova me një "batutë" që, sado nuk është imja, e zbraza: - E mik, çfarë trimnie ke ba sot?

Ai, duke qeshur, u mundua t'i bëjë bisht pyetjes sime, por nuk ndahem lehtë unë.

- Lëre, - më tha, - po ndodhi fare rastësisht.

- Rastësisht, - përsërita unë, - por kot nuk thonë që rasti është mbreti i botës.

E lashë sa gjerbi gllënjken e parë dhe...

Qe aty nga ora 10.00 e mëngjesit, nja dy ditë pas Pashkëve Ortodokse. Tek dyqani u rrëfye KATJA.

- U rrëfye KATJA, - ndërhyra unë, - sikur unë e njoh.

- Dale, më tha. A e do "trimninë"? Mos më ndërpriri! KATJA ka qenë komshia ime, u martua dhe kishte vite në emigrim. Ka qenë vajzë e bukur, pothuaj e një moshe me mua dhe unë, ngaqë jam përmetar, sa e shihja, ia thosha asaj këngës:

"Rrumbullakja si karpuzi/ matan lumit-o..., por ia ndryshoja pak si "matan Lanës-o". Ajo nuk qe matan Lanës, po një 500 - metro nga pallati ku jetoja unë. Qe e kolme sikur harlisej nga shëndeti dhe buçiste kur të kalonte rrugës. Kur e shihja kështu, doja t'i thosha: - KATE, e ke lexuar atë tregimin e NAUM PRIFTIT për atë KATEN që shkante tek pasqyra dhe i thosh vetes: - Sa e bukur je, moj KATE!!! Doja t'i thosha, por ndruesha dhe shkoi e vajti. Shtëpinë, kur u martua, e ka larg nga dyqani im, nja dy pallate më tej. Qemë rritur e kishim



krijuar familjet tona dhe, sado rrallë, edhe shkëmbejmë ndonjë "batutë" nga ato me shpoti, si: "shihemi e me gojë nuk flasim, si durojmë që nuk pëlçasim". Rini hesapi (dukesh se na haheshin hudhurat, por kishim frikë se na mbante erë goja). Ja, kjo është KATJA, në "vija të trasha", kur thuaj ti.

- Pse kaq është "trimnia"?

- Nuk kam parë njeri më të ngucur e të paduruar si ti. Se çka qenë një shenjti që ka thënë: "Nxitimi është i djallit". Emri i shenjtit nuk më kujtohet, por "djalli" je ti, - tha duke qeshur.

Erdhi KATJA, u përqaftuam si miq të vjetër dhe, pasi më tregoi që kish ardhur për Pashkë dhe do ikte pas dy ditësh, më tha: - Më ka gjetur një hall. Nuk di ku humba çelësin dhe çelësin rezervë e kam brenda në shtëpi. Mirë që kam

lënë dritaren hapur dhe dua të më ndihmosh që të hyj nga dritarja.

- Mos u shqetëso, - i thashë.

Mora shkallët portative dhe së bashku me KATEN mbërritëm tek pallati. Hipi tek shkallët dhe unë sy e vesh, se për një çast mund të binte dhe, për siguri, me të dy duart mbi prapanicën e saj, e ndihmova të hynte brenda. Hyri, po KATJA duket qe ajo e "harlisura e dikurshme", se, kur doli në dritare dhe, ndërsa prisja falënderimin, më tha: - Hë, si e ndjeve veten me duart tek bythët e mia? Ndjeve ndopak rahat?

- Aq mirë, sa më mirë prishet, - iu përgjigja flakë për flakë.

- Por ti aty i ke pasur, por nuk ke patur sy t'i shikoje !!!

Janë ca gjëra që duan guxim, - tha duke qeshur.

Aha, tani nuk mbante më ujë pilafi. Provokimi qe i hapur dhe nuk kisha çfarë prisja më. Se unë, vërtet i kam kaluar 50-vjetët, por "bukën akoma nuk e ha thatë".

Ngjita shkallët dhe sa, kërcëva brenda, zgjata duart e tërhoqa shkallët se më dukeshin sikur "flisnin".

Nisëm të qeshnim të dy.

- Hë, - më tha, - përse u mundove?

- Të paguaj "doganën" e vjetër.

- Mos je kujtuar vonë?

- Ende nuk mbaj borxhe mbi kurriz.

Zgjata dorën drejt saj dhe ajo më drejtoi nga dhoma tjetër. Mbi krevat e shtriva dhe, ndërsa putheshim, filluam ta zhveshim njëri tjetrin.

- Kollopan, - tha ajo, - se ashtu do ta shijojmë më shumë.

Tani u bëmë banorë të një planeti tjetër. U dehëm të dy prej kënaqësisë dhe ajo më tha:

- Ti je i çmendur!

- Më çmende ti dhe, ndërsa mendoja se po mbaronte, kjo "betejë", vura re buzët e saj të tendosura që kërkonin me etë buzët e mia. Një aromë e mirë prej shampoje më fryjti flegat e hundës dhe përsëri...

Ja, kjo qe "trimnia" për të cilën kishe aq merak dhe ndodhi krejt, rastësisht.

* I ndjeri miku im, POETI MUSA VYSHKA, kur më takonte, më thoshte: - Hë, çfarë trimnie ke ba sot? E kam "vjedhur" nga Ai dhe, sa herë e përdor me miq të afërt, sikur e kam pranë. E kujtoj me mall.

Personazhi kryesor i veprës – një poet i quajtur Dante – hyn në territore të ndaluara, rrëmon më të mirën e më të keqen e njeriut dhe përpiqet të depërtojë në mendjen e Zotit.

Në kohën kur Primo Levi ka punuar si skllav në Auschwitz për thujse tre muaj, gjatë një pushimi fshehurazi, në pranverën e vitit 1944, atij i kërkoi një i burgosur francez t'i mësonte pak italisht. Levi, një kimist i ri nga Torinoja, u bë kronikani më i rëndësishëm i jetës në kampe, por atëkohë nuk besonte se kishte zotësinë për të mbijetuar. Mendonte shumë. Po e gërryente uria dhe ishte tejet i vetëdijshëm se duart i ishin bërë plagë dhe mbante erë. Më e keqja e gjithë kësaj, e ndiente se gjërat që kishte parë do ta tresnin nga brenda edhe nëse mbijetonte. Do të kishte qenë normale të dorëzohej. Fillimisht, nuk e kuptoi pse i erdhi në mendje një pjesë e *Komedisë hyjnore* në atë orë fsheharake mësimi – zor të quhej italisht e folur për fillestarë – por tek ai filloi të shpalosej rrëfimi i Dantes për luftëtarin grek, Uliksin. Nuk po i vinin në mend shumë vargje, por, i vendosur ta bënte shokun e tij të burgut të kuptonte, ndonjëherë duke përkthyer në frëngjisht, ngulmoi veçanërisht të fjalimi me të cilin Uliksi nxit grupin e rraskapitur të ushtarëve, më në fund të sigurt në breg, të kthehen në det:

*Kijeni parasysh farën që ju sollë në jetë:
Nuk jeni krijuar për të jetuar si shtazë,
Por për të ndjekur vlerën dhe dijen.*

Levi pandehte se ngjante sikur po i dëgjonte vargjet për herë të parë dhe tingëllonin si zëri i Zotit. Për një çast, harroi ku ishte.

Uliksi i Dantes është e njëjta figurë mitologjike si Odiseu i Homerit dhe përshkrimi i Dantes pasqyron shumë nga e kaluara e njohur e personazhit: një hero i Luftës së Trojës, i njohur për dinakërinë e tij, e shfaqur më mrekullisht në idenë se trojanët mund të binin në kurthin e një dhurate të një kali gjigant druri mbushur tinëzish me ushtarë. Pasi grekët kanë fituar luftën, mbi të gjitha falë kësaj dredhie brilante, Homeri dhe Dantja divergojnë rrënjësisht. Tek *Odiseja*, Homeri tregon historinë e kthimit të zvargur të Odiseut në shtëpi. Lundrimi është i mbushur me ndalesa dhe mëdyshje, por ai u reziston ndjellave më të mëdha në mënyrë që të kthehet te gruaja dhe djali, babai dhe atdheu. Kthimi në shtëpi: kjo është arsyeja e gjithë lundrimit të stërzgjatur.

Por ka të ngjarë që Dantja të njihje një variant tjetër të historisë. Ai nuk dinte të lexonte greqisht dhe në kohën që po shkruante, në fillim të shekullit të katërmëdhjetë, Homeri ende nuk ishte përkthyer mirëfilli në latinisht, jo më në italisht. Për më tepër, shihet qartazi se çdo variant me një kthim të lumtur në shtëpi nuk ishte historia që Dantja kishte nevojë të tregonte. Uliksi i tij ishte një aventurier me një etje të pangopur për dije dhe aventurë. Edhe pse familja e tij po pret në shtëpi, ai zgjedh të qëndrojë në det dhe të lundrojë përtej limitit të pranuar të lundrimit njerëzor, Ngushticës së Gjibraltarit – mos harroni, kjo ishte shkruar thujse dyqind vjet para Kolombit – në një oqean të shkretë dhe me të panjohura të rrezikshme. Fjalimi që mban përpara pjesës që kishte mbetur nga njerëzit e tij të rreckosur, një fragment i të cilit shfaqet më lart te përkthimi i Allen Mandelbaum-it, është i mbushur me krenari dhe aspiratë. Levi, si shumë të tjerë, e shihte fjalimin e Uliksit si një shembull që i jep forcë shpirtit të shprangosur njerëzor. Megjithatë, Uliksi shkaktoi vdekjen e të gjithë njerëzve të tij të cilët, pasi janë kandisur, ndjekin liderin e tyre dhe mbyten në një stuhi të tërbuar. Për më tepër, shakullina që i përfshin ata nuk është thjesht një aksident, por akti i një Zoti të zemëruar. Fjalimi është një arsye qendrore pse Uliksi i Dantes është i dënuar në një ferr edhe më keq se ai i Levit, sepse është i përhershëm.

Komedia hyjnore, e konceptuar si një udhëtim i prirë në jetën e përtejme të krishterë, është shkruar në tri vëllime që korrespondojnë me tri mbretëritë që presin të gjithë shpirtat njerëzorë pas trupëzimit të shkurtër të tyre në tokë: Ferri, Purgatori dhe Parajsa. Autori, Dante Aligieri, lindur në Firencë më 1265, është po ashtu personazh kryesor i saj – jo një luftëtar si në epikat homerike ose në pasardhësen e tyre latine, *Eneida* e Virgjilit,

“Komedia hyjnore”, udhëtimi i poetit në jetën e krishterë të përtejvarrit, është e mbushur me përkthje të theksuara moderne – dhe një energji poetike të rrënjësuar në papërsosurinë njerëzore.

Ku na udhëheq Dantja

Nga Claudia Roth Pierpont

Përktheu nga anglishtja Kadia Dedja

por, krejt ndryshe, një poet, një njeri me cene dhe vetëshqyrtes, rënia në dëshpërim e të cilit e vë dramën në lëvizje. A po përjeton Dantja një krizë besimi? Ose, në termat e sotëm, një krizë mesmoshe orientimi? (Ai na tregon se është në gjysmën e rrugës së jetës.) A po has vështirësi duke imagjinuar poemën epike që po synon të shkruajë? Të gjitha këto probleme, të ndërlydhura, fillojnë zgjidhen kur shfaqet Virgjili në pyllin e errët ku Dantja e gjen veten, duke e prirë përtej rreziqeve që i kanë zënë rrugën. Ose, më qartë, shfaqet hija e Virgjilit, duke qenë se ai jetoi në epokën e perandorit August dhe ka vdekur rreth një mijë e treqind vjet më parë.

Poeti i madh romak ishte muza e Dantes në shumë mënyra – tek *Eneida*, Enea vizitoi Botën e Nëndheshme për t'u këshilluar me të atin – dhe Virgjili te *Komedia hyjnore* është i ditur, i dashur, mbrojtës. Ai bëhet si një baba për poetin e ri shpesh të çoroditur, duke e udhëhequr atë nga qermi i Ferrit deri në qendër të tij dhe pastaj përsëri lart, mespërmas Purgatorit dhe në prag të Parajsës. Atje, Virgjili duhet t'ia kalojë detyrën e tij një tjetri. Si një pagan që vdiq përpara Krishtit dhe për këtë arsye ishte i pazoti për besimin e vërtetë, ai nuk mund të shkelë në Parajsë dhe duhet të kthehet në vendin e tij të përcaktuar në skemën hyjnore. Ai po ashtu shihet – figura më e dashur në botën pafundësisht gumëzhitëse të Dantes, një lloj Poloniusi ose Dumbledori antik – se është i dënuar të kalojë përjetësinë në një rreth të Ferrit. Nuk ka tortura fizike në këtë vend të quajtur Limbo dhe me sa duket, ku vendimi është i rrallë. (Homeri, Horaci dhe Ovidi janë mes paganëve të tjerë të virtytshëm që i takojmë përkthimit atje.) Por kjo nuk do të thotë që Virgjili nuk vuan ngaqë i është mohuar shpëtimi. Për të Limboja mbetet një “burg i errët”, sepse ngelet jashtë dritës së Zotit, përgjithmonë dhe pa shpresë.

Edhe për Danten rregullat duken çuditërisht të padrejta. Ferri, qartazi mbretëria më e dhunshme nga të gjitha, shndërrohet në librin më të gjallë dhe më argëtues, i mbushur me veprim, përbindësia fantastikë dhe me raste, farsë. (Një djall me emër të qëlluar, Malacoda – Bishti i Keq – thërret bandën e tij me pordhë të fuqishme që “i kthejnë prapanicën në një trumbetë.”) Mbi të gjitha, është i mbushur me histori njerëzore. Dantja – personazhi i quajtur Dante – lëviz nëpër nëntë rrethet që përkeqësohen gjithnjë e më shumë si një reporter, teksa mbledhur rrefime nga shpirtat e mjerë duke u premtuar të ruajë emrat dhe historitë e tyre në tokë. Ai është krijesa më e rrallë, një vizitor i gjallë dhe po mban shënime me mendje. Virgjili, me një përkthje të theksuar moderne, bind një gjigant të frikshëm që funksionon si një lloj ashensori mes rrethëve të Ferrit që t'i zbresë poshtë ngadalë, duke i thënë që Dantja – Dante shkrimtari – mund ta bëjë atë të famshëm.

Sidoqoftë, Ferri është i mbushur me tortura të përgjakshme dhe të lahtarshme. Nga këndvështrimi i Dantes, disa mëkatarë e meritojnë plotësisht dënimin që kanë marrë: klerikë të korruptuar, për shembull – përfshirë një papë – janë ngjeshur kokëposhtë në vrimat e tokës shkëmbore, me këmbët që u frushkullojnë dhe shputat që u lëpihen nga zarri. (Ka një numër të konsiderueshëm priftërinjsh në Ferr; firentinë po ashtu.) Në raste të tjera, ai i mëshiron shpirtat që takon dhe për këtë qortohet nga Virgjili. Të ndiesh mëshirë nënkupton të vësh në dyshim gjykimin e Zotit. Se Djalli nuk ka pushtet këtu;



ai vetë vuan në rrethet më të ulët të Ferrit, i bllokuar në akull. Vetë Zoti i ka dënuar mëkatarët e papenduar në këtë vend dhe ka projektuar tortura mendjeholla për t'u bërë jehonë krimeve të tyre. Kështu, dashnorët kurorëshkelës goditen nga erërat e furishme që i sjellin vërdallë në krahët e njërës, duke imituar pasionin e stuhishëm që nuk arrihen ta kontrollonin. Fallxhorët – ata që mëtonin të dinin atë që mund ta dijë vetëm Zoti – i kanë kokat e përdredhura prapa, si pasojë nuk mund të shohin asgjë veç asaj që është pas tyre. Dhe Uliksi, bindësi gjuhëshpatë i njerëzve, është i ngulmuar në një gjuhë flake. Megjithatë, sado pa anësi të dënohen këta mëkatarë, ata ngjallin jo vetëm keqardhjen e Dantes, por edhe tonën, duke na joshur në një pozitë të pasigurt të vënies në dyshim të drejtësisë hyjnore.

Duke kapërcyer kufijtë, duke sfiduar gjithçka për dije, Uliksi i Dantes ka shumë ndajafërsi me prototipin me cen të njerëzimit, Adamin, të cilin e merr padurimisht në pyetje në Parajsë. (Pyetje: Sa kohë jetove në Kopsht para se të kafshoje mollën? Përgjigje: Rreth shtatë orë.) Ai gjithashtu kishte shumë ndajafërsi me vetë Danten, në vullin e skajshëm të poetit për të marrë përsipër këtë vepër: duke hyrë në territore të ndaluara, duke eksploruar më të mirën dhe më të keqen e njeriut, duke u përpjekur të depërtojë në mendjen e Zotit. Dhe, megjithëse nuk mund të çlirohet nga shqetësimet e vazhdueshme dhe pyetjet e rrezikshme, ai u jep një paralajmërim të drejtë lexuesve që janë të bindur nga gjuha e tij e mprehtë. “Kthehuni pas nëse doni të shihni sërish brigjet tuaja”, - na paralajmëron Dantja. - “Detet që lundrojnë nuk janë lundruar kurrë më parë”.

Tanimë bihet gjerësisht dakord se Homeri nuk ishte një individ, por një traditë orale e mbledhur ngadalë, që i është dhënë një emër. *Eneida* e Virgjilit ndërpritet befasisht, me çdukjet e pambaruara dhe thuhet që poeti ka kërkuar në prag të vdekjes që të digjet dorëshkrimi. (Ndërhyri Cezar Augusti.) Dante Aligieri, pasardhësi i këtyre forcave letrare përcaktuese të civilizimit, lindi në një familje me të ardhura mesatare në një qytet italian të gramshaleshur nga dhuna politike dhe në një epokë ku sapo kishte filluar rilindja e dijës klasike. Ai ishte një bashkëkohës dhe me gjasë mik i Giotto-s, piktorit të madh firentin, të cilin e përmend te *Komedia* për faktin se ia kishte marrë vëmendjen Cimabue-s – ish-mësues i Giotto-s, i cili krijonte imazhe me ngurtësi ikonike – ashtu si vetë Dantja do t'i kapërcejë shkrimtarët e rinisë së tij. Ja, është çasti kur rreptësia mesjetare, në dy arte të ndryshme, i lë vend ngjyrimin fizik dhe psikologjik, kur trupat njerëzorë shtriqin gjymtyrët dhe marrin frymë. Në të njëjtën gjeneratë, Bokacio do të shkruante që Dantja ka hapur rrugë që të rikthehen në Itali Muzat e munguara prej kohësh.

Ai kishte ambicie që në fillim. Prue

Shaw, në librin e saj të ri *Dantja: Komedia thelbësore* (Liveright) thekson rëndësinë dhe shpirtmadhësinë e rrallë që Dantja ia akordon zanatit të poetit dhe se si, që në fillim, ai besoi se aftësitë e tij mund të ishin të njëjta me ato të poetëve të mëdhenj të antikitetit klasik. Shkrimet e tij të hershme pasqyronin stilin e njohur të trubadurëve francezë, poetët-muzikantë të oborrit që kënduan për përgjërën e tyre për një zonjë të bukur. Në rastin e tij, e shtrenjta ishte e paarrishmja Beatrice Portinari, vajza e një bankieri të pasur, të cilën Dantja mëton ta ketë dashur që kur u takuan për herë të parë, kur të dy ishin fëmijë – një grimë mitizimi magjepsës i historisë personale – dhe që vazhdoi deri në vdekjen e saj të parakohshme, në moshën 24-vjeçare. Duke sikur nuk kishte rëndësi që shiheshin rrallë dhe që të dy, për arsye financiare dhe politike, ishin martuar me njerëz të tjerë. Në *Komedinë hyjnore* nuk përmendet askund gruaja e Dantes apo katër fëmijët e tyre. Beatriceja ishte dashuria që ushqeu poemat e tij, e cila pas vdekjes së saj veçse mori një karakter më shpirtëror, kur vetë emri i saj – që do të thotë lumni – bëhet për të një formë lutjeje.

Nëse poezia e formësoi jetën e Dantes, politika e batoi atë. Në vitin 1300, në mes të të tridhjetave, ai shërbeu në një komitet qeveritar firentin që syrgjynosi disa liderë të dy taraveve politike në konflikt, për një lloj paqeje. Vitin e ardhshëm, ndërkohë që Dantja ishte në një mision diplomatik në Romë, kishte rënë tarafi i tij në atdhe dhe ai ishte akuzuar pabesisht për korrupsion. U syrgjynos në mungesë nga Firencja dhe në vitin 1302 ishte marrë vendimi të digjej në turrën e druve nëse kthehej ndonjëherë. Për pjesën e mbetur të jetës – rreth njëzet vjet – ai kërkoi strehë në qytete të ndryshme italiane, me dialektat dhe kulturat e panjohura vendase, që i ushqyen si një hidhëti ashtu edhe një përgjërë, të cilat ndihen në veprën epike që mori përsipër. Ai mbase filloi ta shkruante veprën rreth vitit 1307, por u vendosi datën e fillimit të poemës, krejt qëllimshëm, para syrgjynosjes – në pashkët e vitit 1300. Ai e quajti thjesht *Komedia*, duke pasur parasysh një vepër që fillon në errëti, por, ndryshe nga tragjedia, përfundon në dritë. Mbiemri “hyjnore” është shtuar nga një tipograf më shumë se dyqind vjet më vonë, duke pasqyruar si temën e veprës ashtu edhe statusin e saj.

Mitologjia klasike, historia e antikitetit dhe e mesjetës, teologjia kristiane, astronomia, moraliteti, filozofia aristoteliane, murgjit e murgeshat, lavret, falsifikatorët, blasfemuesit dhe poetët (Purgatori është plot me poetë): të gjitha përfshihen në një skemë rimash të trilluar nga Dantja dhe të shkruar në dialektin toskan, e vetmja gjë e mbetur nga vendlindja. Tre libra që përfshijnë njëqind këngë në formë kapitujsh, fjala me prejardhje latine si një homazh ndaj origjinës së thellë muzikore të poezisë.

Katërmëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e tri vargje. Duhet theksuar patjetër, jo në latinisht, gjuha e erudicionit dhe prestigjit – zgjedhja e kuptueshme për një vepër epike – por në një gjuhë që flisnin njerëzit e zakonshëm dhe që (siç thotë ai) mund ta lexonin edhe gratë. Analfabetët do ta kenë dëgjuar të recitohet; ka rrëfenja të shekullit të katërmëdhjetë që hekurpunuesit ose mbledhësit e mbeturinave i recitonin përmendsh vargjet gjatë kalimeve të tyre. Por sa njerëz, edhe atëherë, ishin në gjendje t'i kuptonin këto referime? Nevoja për shënime plotësuese – fusnota – u dallua nga njëri prej studiuesve më të hershëm të Dantes, djali i tij Jacopo, menjëherë pas vdekjes së poetit, kur boja te Parajsa nuk ishte tharë ende. Lista e shënimeve ishte e gjatë në fund të shekullit të katërmëdhjetë. Tanimë do të nevojitej e gjithë karriera për të lexuar gjithë sa është mbledhur.

Kështu, si mund t'i qaset dikush kësaj vepre të jashtëzakonshme? Nuk ka asnjë përkthim të përsosur në anglisht, ose të paktën të pranuar gjerësisht, edhe pse ekzistojnë dhjetëra të tilla. Është përshtatur në prozë, në varg të bardhë dhe në imitime të përafërta të tercinës, skema karakteristike trevargëshe e Dantes, në të cilën vargu i parë dhe i tretë i çdo strofe rimojnë me njëri-tjetrin, ndërkohë që vargu i dytë lakohet përpara si një gilpërë me fill për të qepur në vend rimën e strofës tjetër. Dhe kështu vijon në pafundësi, krijohet një

ritëm gëlues që duket i natyrshëm në italisht, me atë mbushulli fjalësh që rimojnë në rrokjen e fundit, por është e pamundur të arrihet pa sforco në anglisht, një gjuhë që përkthyesit e rraskapitur e cilësojnë si “të varfër në rima”. Duhet përhuruar përkthyesit që vazhdojnë t’i kushtojnë copëza të jetës së tyre kësaj poeme shtatëqindvjeçare, duke u zotuar për një udhëtim çmendurak, të vendosur t’i bëjnë lexuesit të kuptojnë dashurinë që i nxit. Dhe nuk duhet fajësuar nëse, në një epokë ku spektri i vëmendjes është tkurrur, ata dëshpërohen paksa.

Libri i Shaw-t ndjek një qasje të re. *Komedia thelbësore* nuk është një përkthim i zakonshëm, por një variant rrënjësishit i shkurtuar i tekstit, me copa të poemës (në italisht dhe nga përkthimi i Shaw-t) të vendosura si gurë të çmuar në shënime të vazhdueshme që krijojnë ura narrative, kontekst historik, interpretim dhe me raste digresione të mprehta. E gjithë vepra ngjshet në një vëllim dhe meqë ritmi i origjinalit ka rënë, Shaw – një studiuese britanike e Dantes e klasit të parë – na sjell ritmin e saj. Nëse është një shmangie, është po ashtu edhe një ftesë e hapur për lexues të rinj. Dhe përmirësohet me kalimin e kohës, duke qenë se nevojitet shumë më pak përkrahje në rrëfimin e ngrydhët të Ferrit sesa në trillet teologjike të Parajsës, të cilat i bëjnë disa lexues të mos e vazhdojnë leximin. Shaw sqaron pambarimisht shqyrtimet me “të ngjeshura” dhe me “të lodhshme” parajsore, duke nisur nga një sqarim i njollave të zeza në Hënë te një rrëfim i çastit të krijimit. Megjithatë, Shaw vetë është thuasë e sinqertë. Provo të flasësh për çfarë ka bërë ajo dhe do të flasësh vetëm për Danten.

Komedia hyjnore e poetes Mary Jo Bang – e kopsitur rishitazi, pas afërsisht njëzet vjetësh, me botimin e Parajsës (Graywolf) – po ashtu nuk është një përkthim i zakonshëm. Është më afër një stisjeje, e mbushur me referenca filmash dhe albumesh roku (dhe xhazi) që devijojnë nga varianti italian dhe janë të destinuara të tërheqin lexues të rinj dhe e bërë Danten bashkëkohësin tonë. Led Zeppelin-i, Charles Mingus-i, Cyndi Lauper-i dhe “The Wizard of Oz”, për të përmendur vetëm disa, ndihmojnë me tekste e fraza dhe shfaqen në shënime shkencore (ndonëse ndonjëherë me fytyrë ironike prej torollaku). Bang-u e quan veprën e saj një variant “bisedor” dhe afërmendsh, mund të jetë shtingëlluese të dëgjosh Virgjilin të flasë me tonin e një dembeli. “Ç’ke kështu, - i thotë ai Dantes, i cili sapo ka parë vegimin e martirizimit të Shën Stefanit, - që s’po e mbledh dot veten?” Prapëseprapë, kjo mund të jetë në njëfarë mase rrjedhoja që Dantja synonte kur përdori gjuhën e zakonshme të cilën e donte edhe për natyrën e saj të ndryshueshme. Bang-u ua del mbanë groteskërive të zjarrit të ferrit, ku të ulurit e tonit mund të ketë një efekt të mprehtë, madje komik. Dhe ndonjëherë ia arrin të japë një varg me freski thumbuese. Në përkthimin e shkëlqyer tradicional që përdor zakonisht, nga Robert dhe Jean Hollander-i, trapari i djallëzuar Karon i paralajmëron “ju shpirta të ligj” ata që po i transporton për në Ferr “hiqni dorë nga shpresa për të parë ndonjëherë parajsën”. Dhe pastaj kemi Bang-un: “Dorëzohuni, ungjër llurbëtira”, - hungërin Karoni. - “Kurrë më nuk do ta shihni qiellin”.

Gjuha ka gjasa të ndryshojë, por jo njerëzit dhe pasqyra që ngre Dantja e ka bërë atë një bashkëkohor të përhershëm. Purgatori, mbretëria e mesit, është një vend ku dërgohen për t’u dëlirur mëkatat që janë penduar – qoftë në prag të vdekjes, qoftë edhe veçse në mendimet e tyre – para se të ngjiten në Parajsë. Nuk ka ndonjë zanafillë të drejtpërdrejtë biblike, por është kthyer në një doktrinë kishtarë në kohën e Dantes, duke i mbushur me shpresë ata që frikësohen se nuk janë të denjë për Parajsë. Dantja e vendos atë në një mal që lartohet mbi një det të thatë. Njerëzit në shtatë brezaret e tij përjetojnë tortura jo për t’u ndëshkuar, por për t’u shëruar nga animi i tyre ndaj cilitdo prej shtatë mëkateve mortare – Krenaria, Zilia, Epshi etj. – që ata kanë kryer. Varësisht nga temperamentit, mund të jesh në gjendje të shmangësh një ose dy brezare. (Askush nuk e shmang Krenarinë, kështu që mos u merakos të mëtos të jesh mbi të.) Mësimet janë të vrazhda; ziliqarët i kanë sytë të qepur me fije të hekurta. Prapëseprapë, në ndryshim nga Ferri, është zotimi për të dalë jashtë; koha


ecën. Lutjet nga shpirtat e qelibartë në tokë mund t’jua shkurtrojnë dënimin dhe Kisha po ashtu po angazhohej në zhvillimin e formave të tjera të faljes, për para. Një profesor që aktualisht po u bën një kurs për Danten të burgosurve thotë që Purgatori është pjesa e tyre e parapëlqyer.

Disa prej shkrimtarëve më përfaqësues të epokës moderne u ishte ngulitur ideja e të parit të Dantes si një bashkëkohor dhe vlerësimi i tyre në dukje heterodoksinë e poetit. Për shembull, rrathëve të Ferrit ai u bashkëngjiti një kategori mëkatarësh të sajuar prej tij – ata që nuk angazhohen kurrë realisht në një kauzë, që jetojnë “pa dalë nga hiri e, prapëseprapë, pa lavdi” dhe janë të izoluar (të flamuar nga arëzat dhe mizat pickuese) me engjëjt të cilët abstenojnë kur Luciferi i shpall luftë Zotit. Dantja afërmendsh që e ka urryer këtë lloj jete; shtangia qëndron në atë se sa nga këta shpirta mospërfillës janë këtu. “Nuk e kisha marrë mend se vdekja kishte zhbërë kaq shumë njerëz”, - shkroi T. S. Elioti në *Tokë e shkretë*, duke përdorur perceptimin e Dantes për të mbartur një skenë të Ferrit mesjetar në Londrën e shekullit të njëzetë, kur turma pajtimtarësh lëviznin ngathshëm mepërmes mjegullës së murrme të mëngjesit, me sytë ngulur pak para këmbëve, sikur edhe ata nuk do ta shihnin më qiellin.

Dhe pikërisht jashtë portave të Purgatorit, afër rrëzës së malit, Dantja has një mik të vjetër të quajtur Belacqua, i cili po zdërgjahet në hije të një curri. Një varakatës i mështë, shpjegon ai, i cili, duke qenë se priti të pendohej ndërkohë që jeta e tij ishte afër fundit, tani duhet të presë për aq vite sa jetoj përpara se të fillojë dëlirja e shpirtit. Pra, në fund fare, pse të lëvizë? Bang-u, duke nxjerrë në pah ndoca andralla me rregullat e Purgatorit dhe me matematikën, sheston se ai do të duhet të presë njëzet e një mijë vjet, një kohë që Samuel Beckett-it me shumë gjasa do t’i kishte pëlqyer. Beckett-i ishte një lexues i zellshëm i Dantes dhe e përfshin disa herë Belacqua-n në prozën e tij artistike, duke filluar – në tregimin e tij *Dante and the Lobster* – me Belacqua Shuah-n, një riosh dembel dublinas që po studioi Danten dhe po mëson direkt nga burimi rreth keqardhjes dhe trauajtjes. (“Pse jo edhe fetarisë dhe mëshirës, madje edhe në botën e nëndheshme?” - shqetësohet ai.) Belacqua për konditën tonë ishte një çelës për Beckett-in, njëllorji si Uliksi për Primo Levin. Ai duket sikur futet direkt në botën e mistershme të Beckett-it, bashkë me një shkurtore të vogël të Dantes për shpirtat e tjerë të keqardhur – të gjysmëvarrosurit në baltë, në jashtëqitje, në varre, të gjithë të prerë për të folur – të bërë spikatshëm modernë prej mungesës së shkakut dhe qëllimit në mjerinë e tyre.

Përdëllimi i Dantes për Virgjilin shtohet teksa ata i afrohen vendit ku poeti më i vjetër duhet të braktisë më të riun. Dantja ka parë në Purgator shpirta paganë që kanë shpëtuar – do të shohë më shumë në Parajsë – përjashtime që e bëjnë fatin e Virgjilit edhe më pashpjegueshmërisht të vrazhdë. Pasi ia dalin nëpër të shtatë brezaret, mësuesi dhe nxënësi shfaqen në majën e malit, i cili në gjeografinë e shenjtëruar të Dantes është vendndodhja e Kopshtit të Edenit, ndalesa e fundit e dëlirësimit të shpirtit para Parajsës. Të dy shohin një vargan të Kishës Triumfuese, të gjithë të veshur me kostum, me flamurë të shpalosur dhe aleluja korale – Dantja kthehet nga Virgjili, i cili e sheh i çmeritur – i cili kulmon me një qerre që bart të shumëkërkuarën Beatrice, mërtisur me të bardha. Komentuesit shpesh deklarojnë se Beatriceja përfaqëson besimin dhe Virgjili arsye; vetë Virgjili na ka paralajmëruar se arsyeja s’mund t’u qaset sferave të epërme. Atje Danten do ta udhëheqë Beatriceja. Prapëseprapë, Dantja është i papërgatitur. Teksa sheh Beatricen, ai ndien afshin në rritje të një dashurie thellësisht njerëzore. Kthehet edhe një herë t’i tregojë Virgjilit për këtë – ka gati një citat nga *Eneida* për të përçarur ndjesinë – por Virgjili është larguar. Dhe, në Kopshtin e Edenit, ku gruaja për të cilën po digjet qëndron para tij dhe ngulmon se çdokush në këtë vend është përherë i lumtur, s’mund të ndalojë së lotuari.

Siç na e bën të ditur më herët te Ferri, rrugëtimi i Dantes nisi sepse Virgjëresha Mari donte ta shpëtonte nga rreziqet e pyllit të errët. Nuk mund ta dimë me siguri pse u zgjodh ai, por mund të nënkuptohet (nga ajo



që ai vë në gojën e një shenjti për t’ia thënë Beatricës) që Virgjëresha admironte poemat e tij, veçanërisht poemat e fisnikëruara shpirtërisht të dashurisë që ia dedikon Beatricës. Ai prihet nëpër Ferr, Purgator dhe më në fund, Parajsë për shkak të artit të tij. Do të shohë universin e Zotit dhe do të shkruajë një libër që do t’i bëjë edhe të tjerët ta shohin. Shfaqja që i paraqitet në mbretërinë e epërme është spektakolare: drita brilante, vallëzime në ajër, muzikë, gjithçka e shpërhapur rreth Hënës dhe planetëve, ku udhëtojnë ai dhe Beatriceja, duke kaluar përtej yjeve për në shtëpinë e Zotit në parajsën qiellore. Dantja është i lëbyrur, por, siç e kanë vënë re prej kohësh lexuesit, nuk duket tërësisht i patrazuar. Është e vështirë që spektaktli të paraqitet bindshëm në shkrim; njëllorji si fjalimet e gjata rreth fesë dhe astronomisë. Ai i lutet Apolonit për muzë, gjë që duket teologjikisht e mangët dhe i ka futur studiuesit nëpër qorrsoakë për shekuj të tërë. Por gabimet dhe përpjekjet e Dantes mbushin këtë sferë të mbramë prerazi triumfuese me vetëdije dhe tension gjallëruar. Ai bën shumë pyetje: Pse Zoti nuk mund ta falë njerëzimin pa e kryqëzuar? Pse është zgjedhur një shenjtor i posaçëm për një detyrë të caktuar? Një shenjtor i pezmatuar shpjegon se përgjigjet shkojnë përtej të kuptuarit njerëzor, duke shtuar – i cili kulmon me një qerre që bart do të duhet të shkëshillojë njerëzit për këtë lloj marrjeje në pyetje. Kjo është një nga këshillat qiellore që ai nuk e ndjek.

Beatriceja na sjell paksa nga përzemërsia qetësuese e Virgjilit. Sado e bukur, shfaqet papritmas e vendosur, e përkorë, e udhëhequr nga doktrina; ajo është përshkruar si Thoma Akuini në trajtë femërore. Kur përdor shprehje të tipit “sipas opinionit tim të pagabueshëm”, ajo i sjell në mendje Dantes një lider ushtarak. Fillimisht tregohet e vrazhdë me të, pasi rregullat kërkohen që ai të tregojë mëkatet e tij – para së gjithash, siç duket, sa i përket interesit të tij për një grua tjetër pas vdekjes së Beatricës (ose me gjasë për gra të tjera, pasi nuk na paraqitet qartë në italisht). Por misioni i saj ka qenë që ta bëjë atë të jetë përherë i sinqertë përgjatë shtegut më të lartë. Nëse kjo devotshmëri nuk i vjen vetvetiu atij – kjo është kleçka – bartet me humor të papritur dhe forcë të akumuluar. Sipas një ligji dantesk,

bukuria fizike e Beatricës shtohet teksa ata i afrohen më shumë Zotit dhe ai s’mund të shohë gjë tjetër veç saj. “Kthehu dhe dëgjo/ sepse Parajsa nuk është vetëm në sytë e mi”, - e udhëzon ajo. Por, për Danten trupi është shndërruar në rrugën drejt shpirtit. Shikimi i parë i Zotit për të është si një grimcë drite që reflektohet në ata sy.

Kur Dantja nisi të shkruajë Parajsën, rreth vitit 1317, ishte në fillim të të pesëdhjetave dhe ishte syrgjynosur nga Firencja para thuasë pesëmbëdhjetë vjetësh. (Ai kishte jetuar nën një mbrojtje të vazhdueshme në Verona për një periudhë mirëseardhjeje, por më vonë ishte shpërngulur në Ravena, me ftesë të sundimtarit të saj.) Është logjike të mendohet që do ta kishte përsosur më tepër vëllimin e tij të fundit nëse do të kishte më shumë kohë, por është po ashtu e vërtetë që energjitë e tij poetike ishin të rrënjosura në papërsosuritë njerëzore, në të jetuarit e jetës së përditshme. Në një pikë, ai është vënë në dijeni për syrgjynosjen që e priste. “Do të lësh pas gjithçka që ke më të shenjti”, - nis profecia (sipas përkthimit të Shaw-t):

Do ta përjetosh sa e kripur është shija e bukës të tjetërkujt, dhe sa e vështirë është të shkosh lart e poshtë shkallëve të një personi tjetër.

Fillimisht ai frikësohet se, pa një shtëpi dhe pa një mbrojtje qeveritare, nuk do të ketë kurajën të thotë të vërtetën rreth figurave të fuqishme dhe do të rrezikojë të bjerë pre e hakmarrjes së tyre. Por në Parajsë i thuhet që duhet domosdo të flasë: “Hape gojën.” Kjo është këshilla që merr. *Komedia hyjnore* është një vepër e kurajës politike, duke filluar që nga armiqësia e tij qëllimtare ndaj familjeve të të dënuarve që përmenden te Ferri, deri tek objektivat më të fisëm të Parajsës, ku duket sheshazi se Dantja nuk ka asgjë për të humbur. Në këtë vend, banorët e Parajsës, përfshirë Thoma Akuinin dhe Shën Benediktin, denoncojnë urdhrat domenikanë, françeskanë dhe benediktinë në mënyra të gjithfarshme. Shën Pjetri mallkon makutërinë

(Vijon në faqen 23)

Octavio Paz. Nëse flasim për poezinë, atëherë poezia merret me moralin.

Josif Brodski: Po, dhe vetëm me të. E megjithatë. E megjithatë...

Octavio Paz Me moralin shoqëror. Me atë politik. Pound ishte mik me Benito Mussolini dhe ndonjëherë shkruante poezi të marra, apo jo? Por nëse marrim Pablo Neruda dhe Louis Aragon, me ta puna ishte më e keqe. Pound kishte njëfarë drejtësie të drejtpërdrejtë, ai e dinte kur duhej të ndalonte. Ndërsa Neruda dhe Aragon besonin në dialektikë, ata i fshihnin poezitë e tyre që i ngjanin atyre të Pound-it. Dhe poezitë ishin shumë të dobëta.

Josif Brodski: Le të kujtojmë një tjetër njeri. Për shembull, Martial. E mbani mend, poeti romak?

Octavio Paz. A është ai poet? Përfytyrimet tona për poezinë kanë ndryshuar...

Josif Brodski: Octavio, për mendimin tim, ai është një poet i shkëlqyer. Shumë i mirë.

Octavio Paz. Një orator i shkëlqyer. Një satirik i shkëlqyer.

Josif Brodski: Një epigramist i shkëlqyer. Dhe në epigramet e tij ka mjaft poezi të mirë. Mund të citoj. Por le të biem dakord se, në një mënyrë apo në një tjetër, ai është një poet jo i keq. E megjithatë, ai shkonte mirë me të gjithë perandorët dhe me oborin, ose siç quhej atëherë tek ata. Një servil dhe lake i pabesueshëm... Dhe megjithatë mbetej poet. Sigurisht, ka dallim midis kohëve të krishtera dhe, si të thuash, atyre pagane. Ose çfarëdo që ishte në Romë. Ne me moral nënkuptojmë diçka tjetër, ai ka ndryshuar tek ne. Mendoj se në Romë qasja ndaj këtyre gjërave nuk ishte aq e rreptë.

Xhonatan Aaron. Politika ishte ndryshe.

Josif Brodski: Ndryshe.



Octavio Paz bisedon me Josif Brodskin

"Fillimisht më kërkuan të intervistoja Octavio Paz. Por unë, duke ditur sa shumë e pëlqente ai Josif Brodskin dhe sa e admironte, propozova që të takoheshim dhe të bisedonim të tre, në mënyrë që kjo të ishte më pak formale. Si Pazi ashtu edhe Brodski e miratuan këtë ide me kushtin, siç theksuan ata, që rezultati të mos ishte shumë "serioz". Më poshtë janë fragmente nga biseda. Ato janë përzgjedhur thjesht për të dhënë një ide mbi larinë e temave dhe kënaqësinë me të cilën bashkëbiseduesit e zhvilluan këtë bisedë.

Ky dialog lindi në mes të një diskutimi për Ezra Pound në veçanti dhe për poezinë dhe politikën në përgjithësi."

Jonathan Aaron

Jonathan Aaron është një poet, eseist dhe profesor amerikan i letërsisë. Ai ka lindur në vitin 1941 dhe ka qenë i lidhur për shumë vite me Emerson College, ku ka dhënë mësim për shkrim krijues dhe letërsi. Aaron njihet për poezinë e tij reflektuese dhe shpesh intelektuale, si dhe për kontributin e tij në kritikën letrare. Një nga aspektet më të rëndësishme të punës së tij është lidhja me figura të mëdha të letërsisë, si Josif Brodski, me të cilin kishte miqësi dhe bashkëpunim. Teksti që po botojmë është pikërisht një bisedë që ai ka ndërmjetësuar mes Brodskit dhe Octavio Paz.

Në thelb, ai është një figurë e rëndësishme në poezinë dhe studimet letrare amerikane të shekullit XX.



Octavio Paz. Më falni, nuk jam dakord. Shikoni: së pari, atje ekzistonte poezia politike. Pra, Martial shkruante në një periudhë korrupsioni kolosal. Për më tepër, cinizmi në ato kohë ishte një përgjigje ndaj një shoqërie të korruptuar dhe të degjeneruar. Në një shoqëri burokratike, cinizmi është vetëm një nga përgjigjet. Ka shumë përgjigje, dhe njëra prej tyre është të jesh cinik. Kur, për shembull, Charles Baudelaire thotë se poezia është amorale, ai ka parasysh se poezia ka një moral tjetër — më të lartë se morali i hipokritëve, i borgjezisë dhe se i ashtuquajturit morali i krishterë i shekullit të nëntëmbëdhjetë, e kuptoni?

Josif Brodski. Mirë, le ta supozojmë.

Megjithatë unë do të thosha (dhe jo vetëm sepse jam i prishur nga shekulli ynë): mënyra më e mirë për të dhënë një gjykim për një poet, të cilin, si të thuash, e konsiderojmë të poshtë, është të botojmë veprat e tij. Të gjitha poezitë, dhe nëse ai ka mbajtur fjalime, atëherë — edhe fjalimet.

Octavio Paz. Po. Një ide shumë e mirë. Atëherë publiku do të mund të gjykojë vetë.

Josif Brodski. Publiku. Jo elita.

Xhonatan Aaron. Por poeti dhe publiku, siç e quani ju, e përjashtojnë njëri-tjetrin. Dua të them që poezia në shekullin tonë nuk ka audiencë.

Josif Brodski. Xhonatan, poeti e ka atë.

Octavio Paz. Publiku është i fiksuar pas jetës private të të tjerëve, jetës seksuale, letrave të poetit. A nuk është kjo e trishtueshme?

Josif Brodski. Mirë, le të kufizohemi me atë që është hedhur në letër — frytet e krijimtarisë së shëndoshë, të mendjes së shëndoshë. Sa i përket asaj që ju mendoni se në këtë vend nuk ka publik, kjo nuk është e vërtetë. Ka. Një numër shumë i vogël, por ka. Ndoshta rreth pesë për qind e gjithë popullsisë...

Xhonatan Aaron. Nëse keni fat.
Josif Brodski. Nëse kemi fat.

Octavio Paz. Por edhe kjo është e mjaftueshme.

Josif Brodski. E mjaftueshme.

Octavio Paz. E dini, Juan Ramón Jiménez, poet spanjoll, ka shkruar një dedikim të bukur. Kur sapo kishte filluar të shkruante, ai ishte, në përgjithësi, simbolist dhe shkroi një dedikim shumë të marrë: "Pakicës". Qesharak dhe tepër i dobët. Por më pas ai ndryshoi, sepse kuptoi çfarë është poezia, dhe shkroi: "Pakicës së madhe". Kjo është shumë e goditur. Jo elitës. Por asaj pjese të

njerëzve që kanë mësuar të lexojnë dhe e duan poezinë. Dhe ata nuk i përkasin qarqeve akademike, universitare. Janë thjesht njerëz — njerëz të lumtur, dhe këto poezi janë si për shtresat e ulëta, ashtu edhe për të gjithë shoqërinë, për të gjithë njerëzit.

Josif Brodski. Pajtohem, por unë dua të them se audiencia e kufizuar, këtu në Shtetet e Bashkuara, ekziston kryesisht në kolegje, në universitete.

Octavio Paz. Epo mirë: në universitete ka shumë të rinj. Poezia është e gjallë në dy raste: aty ku janë të rinjtë, falë pasioneve të tyre, dhe aty ku janë të moshuarit, falë aftësisë së tyre për të soditur dhe për të jetuar me kujtesën. Dhe poezia u drejtohet pikërisht këtyre dy gjërave — mendjes soditëse dhe zemrës, pasioneve. Dhe edhe një gjë: për të lexuar poezi, duhet të kesh kohë të lirë.

Josif Brodski. Në shoqërinë tonë ka plot njerëz që s'kanë ç'të bëjnë.

Octavio Paz. Po, ju keni shumë të rinj. Ata nuk dinë ç'të bëjnë. Dhe lexojnë poezi.

Josif Brodski. Përveç kësaj, universiteti luan rolin e oborrit mesjetar ose të oborrit të kohës së Rilindjes.

Octavio Paz. Universiteti modern përfaqëson njëkohësisht edhe oborin edhe manastirin.

Josif Brodski. Të kthehem te poeti dhe publiku. Gabimi kryesor që mund të bëjë një poet është të mendojë se duhet të përpiqet të flasë me popullin. Në të vërtetë, ai duhet të flasë në emër të popullit.

Octavio Paz. Sipas mendimit tim, poeti duhet të flasë për veten e tij, dhe duke folur nga vetja, ai flet për të tjerët. Por kur përpiqet të luajë rolin e tribun-it, ai ka marrë fund. Dhe mendoj se pjesa më e madhe e poezisë së dobët në kohën tonë është pikërisht rezultat i këtij uzurpimi. E gjithë poezia shoqërore

e kohës sonë është e dobët. Kur Walt Whitman fliste për veten e tij, ishte thjesht zëri i një njeriu të vetmuar.

Josif Brodski. A ju ka ndodhur ndonjëherë të lexoni poezi të mira për luftën e Vietnamit?

Octavio Paz. Jo.

Josif Brodski. Nuk më kujtohet diçka e tillë. Nuk e di.

Octavio Paz. Me këtë rast, André Gide është shprehur mjaft saktë. Ai tha: arti i keq krijohet me qëllime të mira.

Josif Brodski. Me këtë është shtruar rruga për në ferr.

Octavio Paz. Do ta thosha kështu: ne jemi të detyruar të jemi kundër luftës në Vietnam. Ne jemi të detyruar të shkruajmë kundër saj. Por kjo është një çështje krejt tjetër. Nuk mund të shkruash poezi të mirë për luftën, nëse nuk ke qenë në të (nëse nuk ke marrë pjesë në të). Poezi të mira për luftën do të shkruajnë ata njerëz që kanë qenë vërtet në Vietnam, dhe jo si spektatorë. <...> Pablo Neruda ka shkruar disa poezi të mira për luftën civile në Spanjë. Atëherë ai ende nuk ishte prishur. Dhe, sigurisht, César Vallejo.

Josif Brodski. Do të thosha se me politikën dhe luftën në poezi ndodh e njëjta gjë si me dashurinë. Poezitë e mira të dashurisë lindin vetëm *post coitus* (pas aktit seksual).

Octavio Paz. Ose përpara.

Josif Brodski. Ose përpara, ose pas, por jo gjatë!

Octavio Paz. Edhe një gjë: poezia politike, që të jetë e mirë, nuk duhet të jetë ideologjike. Poezitë për luftën e Vietnamit ishin të ideologjizuara. Ndërsa lufta civile në Spanjë prodhoi disa poezi të mira, sepse njerëzit e jetonin atë. Për më tepër, ajo lidhej me një luftë të mundshme në Evropë. Por me luftën në Vietnam puna qëndron ndryshe.


Josif Brodski. E dini, poeti më i mirë politik ishte Constantine P. Cavafy... Mendja njerëzore funksionon në disa nivele. Ajo mund të funksionojë në nivelin e "bukës me gjalpë" dhe në nivelin e politikës, mund të funksionojë në nivelin e filozofisë, fesë, psikologjisë dhe në nivelin transcendent — në çdo nivel. Dhe çdo poezi, teorikisht, duhet të pasqyrojë gjithë këtë shkallë; çdo hallkë, çdo shkallë duhet të tregojë se është e mundur një hap lart dhe një hap poshtë. Por sa i përket poezisë politike amerikane — asaj për luftën e Vietnamit — ajo nuk ia doli. Erdhi shumë shpejt pas luftës.

Octavio Paz. Dhe ishte tepër me natyrë gazetarie. E dini, poeti nuk mund të thotë: kjo është e mirë dhe ajo është e keqe. Kjo do të ishte manikeizëm. Poeti — një poet i madh — gjithmonë gjendet në Anën Tjetër.

Josif Brodski. Pikërisht. Dhe kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Poezia, për ta saktësuar, është një dukuri antimanikeiste.

Octavio Paz. Po. E dini, gjëja më e habitshme te Dante Alighieri është se, kur lexon "Ferrin", ndien simpati për shumë prej atyre që ndodhen aty. Ashtu siç ndiente simpati edhe vetë Dante.

Josif Brodski. Ndërsa për mua, pjesa më e mirë e Komedia Hyjnore është "Purgatori". E mbani mend skenën



e mrekullueshme me poetin romak Statius? Asgjë më prekëse nuk kam lexuar. Virgil dhe Dante Alighieri i afrohen. Dhe i thonë: "Kush je ti?" Dhe ai përgjigjet diçka si: "Unë jam Staci, poet romak. Pata fatin të jetoj në Romë në të njëjtën kohë me Virgjin". Dante buzëqesh pa dashje. Dhe Staci thotë: "Pse po qesh me mua?" Virgjin i bën shenjë Dantes që të mos thotë asgjë për të. Por Dante gjithsesi e zbulon emrin e tij, dhe atëherë Staci bie në gjunjë dhe fillon t'i puthë sandalet Virgjin. "Çfarë po bën? — e pyet Virgjin. — Sepse të dy jemi hije". Dhe Staci përgjigjet: "Imagjino sa shumë të kanë dashur në botën e të gjallëve, nëse këtu, në botën e të vdekurve, unë e mora hijen tënde për trupin tënd të gjallë".

Octavio Paz. Atëherë Ezra Pound dhe T. S. Eliot kanë të drejtë në këtë kuptim. Dante është një model i madh.

Josif Brodski. Më pëlqejnë Ovid dhe Dante, dhe disa të tjerë gjithashtu. Por nga të lashtët do t'i zgjidhja ata.

Octavio Paz. Ju pëlqen Ovidi? "Metamorfozat"?

Josif Brodski. "Metamorfozat" dhe "Fastet".

Octavio Paz. Do të thotë që nuk ju pëlqejnë poetët grekë?

Josif Brodski. Më pëlqejnë disa, por jo aq shumë.

Octavio Paz. Antologjia greke është e mrekullueshme. Sappho për mua është një enigmë. Megjithatë unë preferoj Propertius. Dhe Catullus. Dhe edhe një poet tjetër, për të cilin askush nuk flet, por është i jashtëzakonshëm. Një poet popullor — Lucan. Ne e kemi atë falë një përkthimi të mrekullueshëm të shekullit të shtatëmbëdhjetë.

Josif Brodski. Pajtohem. E gjitha është e saktë. E pranoj plotësisht. Megjithatë, nuk e di. Tek Ovidi ka një hapësirë të tillë, një përmasë të tillë, ai ka, si të thuash, një masë më të madhe se kushdo tjetër. Megjithatë, unë e kam lexuar vetëm në rusisht. Ai të furnizon në mënyrë të mrekullueshme me ide shumë të thjeshta. Ja një shembull, megjithatë

kjo nuk është arsyeja kryesore pse e dua. Ajo që ne e quajmë surrealist — nuk është arritja jonë. Surrealistët kishin pararendës në antikitet. Unë do të propozoja që mitologjia greke të quhet një formë antike e surrealizmit.

Octavio Paz. Vërtet?! Ju me të vërtetë mendoni kështu?

Josif Brodski. Po, mendoj kështu. Sigurisht.

Octavio Paz. Ndërsa për mua surrealizmi do të thotë diçka e kundërt. Në kuptimin që surrealizmi zbuloi për qytetërimin perëndimor një lloj tjetër ndjeshmërie — jo-antike. Romantizmi hapi derën për ndjeshmëri dhe zakone jo-perëndimore, dhe më pas surrealizmi e bëri këtë edhe një herë...

Josif Brodski. Jo, nuk mendoj se kjo është thjesht çështje marrëdhëniesh midis Perëndimit dhe Lindjes...

Octavio Paz. Kjo sepse ju jeni rus, ndërsa unë meksikan. Në thelb, ne jemi në dy rrjedha të ndryshme. Ne nuk jemi vendas të Perëndimit.

Josif Brodski. Oh po. Po.

Octavio Paz. Ju jeni një barbar nga Veriu...

Josif Brodski. Më falni, unë tashmë kam hequr dorë nga kjo!

Octavio Paz. ...dhe kjo shfaqet në poezinë tuaj të mrekullueshme. Megjithatë, na bashkojnë dy arsye. Së pari, ne (meksikanët) jemi fëmijë të Spanjës. Dhe spanjollët, në njëfarë mënyre, ishin edhe rusë. Dhe së dyti, ne ekzistonim përpara Kristofor Kolombit. Ne jemi indianë.

Xhonatan Aaron. Dhe shikoni çfarë ju bëri Perëndimi!

Josif Brodski. Po. E uli Octavion në këtë karrige!

Octavio Paz. Po! Dhe për këtë arsye unë jam ulur këtu, në vend që të kryej flijime njerëzore!

Përkthimi © ExLibris

(Vijon nga faqja 21)

dhe intrigat politike të Papatit të kohës, që e kanë kthyer Kishën në një "shtonë gjaku dhe duhmë". Po ashtu edhe qyteti i Firences është dënuar: dikur një republikë modeste dhe me kulturë, tani është e korruptuar nga kamja dhe krekosja vulgare. Përrjashtuar Ferrin, duket se është vendi që Dantja e urren më shumë.

Dhe, duke lënë mënjanë Parajsën, është vendi ku do më së shumti të jetë. Në një digresion personal të papritur në fillim të një kënge të vonë, ai flet për vitet e errëta që ka shpenzuar duke shkruar poemën dhe shpresat për veprën e përfunduar. Nuk flet për shpalosje njohurish rreth universit madhështor dhe me moral të Zotit, edhe pse kjo ka qenë detyra e tij dhe mbetet një qëllim i rëndësishëm. Nuk flet për pavdekësinë librore, ndonëse edhe kjo është pa dyshim e rëndësishme (edhe pse tërthorazi, duke qenë një lloj i gabuar i pavdekësisë). Në vend të kësaj, flet për lavdinë e kohës, një triumf aq i bujshëm sa që florentinët do të pendohen publikisht për syrgjynosjen mizore që i bënë dhe do t'i kërkojnë të rikthehet, duke i vënë kurorën e dafnave në pagëzoren ku ai është pagëzuar. "Do të kthehem poet".

Ai vdiq në Ravenna në vitin 1321 dhe u vendos të prehet në një varr të zakonshëm guri. Por me kalimin e viteve u sendërtuan shpresa të tjera, bashkë me arritje dhe reperkursione që ai nuk mund t'i ndërmendte. Falë Dantes, gjuha standarde italiane u vendos mbi bazën e dialektit toskan në shekullin XIX. Papët filluan ta konsideronin si të tyrin. Në aspektin politik, mendimi i tij ishte mjaftueshëm i gjerë sa të përdorej në mbështetje të ideve kryekëput të kundërta. Abolicionisti amerikan Charles Sumner-i iu referua Dantes për truarjen e atyre që nuk kanë luftuar kurrë për një kauzë; Teddy Roosevelt-i përdori të njëjtat fragmente që të provonte të nxiste hyrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Luftën e Parë Botërore. Musolini shtrembëroi fraza nga poema që të justifikonte ligjet radikale fashiste. Për dikë të kohës së tij — përherë një përcaktim shqetësues — Dantja duket veçanërisht i lirë nga paragjykimet kundrejt hebrenjve dhe fesë së tyre, dhe në Parajsë ka një gamë figurash të Dhiatës së Vjetër. Ai ishte më i ashpër me fenë islame, të cilën e shihte si një ndarje përçarëse nga krishterimi, një pikëpamje mesjetare e përdorur nga politikanë mesjetarë italianë të krahit të djathtë për të përkrahur një shtet italian tërësisht të krishterë. Në hyrjen e saj te Parajsa, Bang-u thekson përkatësinë politike të Dantes në vendin tonë në një kohë kur konfliktet partiake janë aq rrënuese sa në kohën që ai përçmonte. Politikën mund të jenë një mënyrë po aq e mirë sa çdo gjë tjetër për të nisur një poemë. Eja për politikanët e korruptuar që valojnë në katran; qëndro për poezinë dhe tregimet magjepsëse.

Midis shpirttrave të ardhur rishtazi në brigjet e Purgatorit, Dantja takon një tjetër mik të vjetër, një muzikant, i cili mezi pret ta përshëndesë. Nuk është regjistruar numri i popullsisë, por duket se shpirtat e ndërmjetëm që janë dërguar të kalojnë përmes këtij vendi përbëjnë pjesën më të madhe të qenieve njerëzore — ne që pendohe mi për veset tona të këqija, por jo mjaftueshëm sa t'i ndryshojmë para se të kalojë koha. Dantja, i sapodalë nga Ferri dhe i pikëlluar, pyet nëse miku i tij do të ishte i aftë të këndonte një nga këngët e dashurisë me të cilat e qetësonte dikur. (Megjithatë, duket sikur askush nuk i di rregullat; çfarë lejohet, sa duhet të presë, sa dhembje i duket të kalojë.) Si përgjigje, burri nis të këndojë një poezi të Dantes, aq natyrshëm sikur ta kishte mësuar më parë. Zëri i tij është tepër i ëmbël. Dhe ndërkohë që vjen roja, duke britur dhe duke i ngredhur të gjithë, harrojmë ku jemi dhe nuk dëgjohet asgjë veç këngës.

Andreas Duši



Sa albanskog
prevela
Merima
Krijezi

Botohet në serbisht romani "Në besë të tatuazhit tënd" i shkrimtarit Andreas Dushit

"Do të ishte më mirë që ky tekst të quhej një roman hibrid dhe shumëkuptimësh ku shqyrtohen disa nga postulatet themelore të qenies sonë në këtë planet: nga dashuria, te marrëdhëniet familjare, veçanërisht marrëdhënia baba-bir, e cila është

përherë e tendosur në drejtim të kompleksit të Edipit, siç e vuri bukur në dukje Frojdi, e deri te kuptimi i ekzistencës, i cili kërkohet në krijimtarinë - një dhuratë e vërtetë, por edhe një mallkim i vërtetë - një hapësirë ku është e mundur të ndihesh edhe i madh si Pantokratori, edhe i vogël si një kokërr rëre në shkretëtirë."

Vladimir Arsenić